

5 kilometra  
vajtje-ardhje  
janë shumë



Instituti merr  
sponsorizimin  
e parë



Ligji për  
dëshmitarët, i  
domosdoshëm



Më shpesh  
në Viber  
dhe Fejsbuk



# Koha

www.koha.mk



## Ushtria e Kimit "gati" për luftë

FAQE 12

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3210 • E mërkurë 1 nëntor 2017 15 DEN

## Rruga Shkup-Bllacë nuk do bëhet autostradë!



Shkup, 31 tetor - Tetëdhjetë e gjashtë milionë euro do të investohen në ripërtëritje të 26 akseve rrugore, një pjesë autostrada, ndërsa pjesa më e madhe akse rajonale, në gjatësi të përgjithshme prej 420 kilometrave, paralajmëroi të martën ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. Rikonstruk-

sioni i rrjetit rrugor, siç tha Sugareski, do të zhvillohet në dy vitet e ardhshme. "Pjesën më të madhe të këtyre rrugëve i kemi premtuar në programin tonë, ndërsa një pjesë janë të reja, për të cilat kemi siguruar mjete nga institucione ndërkombëtare financiare", tha Sugareski në konferencën për shtyp

në Qeveri. Me ciklin investues për ripërtëritje të rrugëve, sipas planit, është parashikuar ripërtëritje e akseve të autostradave Milladinovc-Petrovec në gjatësi prej tetë kilometrave, me vlerë të vlerësuar prej 1.5 milionë eurove, Hipodrom-Petrovec dhe Milladinovc-Hipodrom nga të cilat...

Faqe 3

Dorëzohen ankesat e para në KSHZ

# ASH edhe në Qeveri, edhe me BESËN



Aleanca për Shqiptarët ka animuar procesin e zgjedhjeve në dhjetë vendvotime - të gjitha në Komunën e Strugës, komunë kjo ku Ziadin Sela humbi nga kandidati i BDI-së, Ramiz Merko me mbi 700 vota dallim. Lëvizja BESA nga ana tjetër ka dorëzuar ankesa për Komunën e Çairit

FAQE 3

## Çfarë të kursejmë kur s'kemi para!



Shkup, 31 tetor - Të martën është Dita botërore e kursimit. Jo secili është në gjendje të kursejë para. Kjo nuk ka të bëjë me mungesën e dëshirës, por me të ardhurat e ulëta. Përqindja më e buxheteve familjare me një të ardhur neto mujore nën mesataren apo 22.912 denarë nuk është në gjendje të kursejë

për pleqërinë, sepse në fund të muajit - u mungojnë paratë. "Mbasi sot është Dita e Kursimit, ku ngritja e vetëdijes për vlefshmërinë e vlerave financiare është e rëndësishme për planifikimin jetësor, personalisht unë nuk kam një kulturë të kursimit sidomos tek të ardhurat e mija, sepse absolutisht këtë e

shoh si një mangësi, sepse kursimi stimulon organizimin, planifikimin dhe disiplinën jetësore, ku falë kursimeve - realizon një të ardhme më të sigurt, aq më shumë ku ne jemi pjesë e një shoqërie me të ardhura të pakta dhe ku shtresa e mesme është e vdekur. Tashmë kemi dy trajektore...

FAQE 6

RAJON

### Hoyt Brian Yee më tha: "Mos e prekni tërësinë e Kosovës"



"Ai (Hoyt Brian Yee) më tha se nuk mund të prekni tërësinë tokësore të Kosovës, ndërsa unë i thashë, ju keni mundur të prekni tërësinë e Serbisë nëntë vjet më parë. Atëherë vlenin rregulla të tjera. Këtë..."

FAQE 14

RAJON

### Serbia dhe Shqipëria luajnë me kufijtë në Ballkan

FAQE 14

GLOBI

### Madridi me mençuri në vend të dorës së fortë

FAQE 15

SPECIALE

### "Më quajnë Popov, Dushko Popov!"



FAQE 16





Në Maqedoni mund të kesh ndjekur çfarëdolloj shkollimi të mesëm, të kesh dhënë cilëndo lëndë si provim të maturës shtetërore dhe të mos kesh asnjë kufizim apo prioritet për degën në të cilën do të regjistrohesh studimet. Pra, mund të kesh mësuar katër vite në ndonjërin prej shkollave të mesme të mjekësisë, të kesh dhënë provim mature gjuhën angleze dhe mund të pranohesh në fakultetin e arkitekturës, drejtësisë, ekonomisë, arteve e kështu me radhë. Kjo praktikë, për njohësit e arsimuar duhet ndryshuar sa më parë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 31 tetor - Mungesa e një mekanizimi orientues nga njëri nivel në nivelin tjetër të shkollimit, ka bërë që pjesa dërmuese e nxënësve dhe më pas studentëve të mos kenë një kontinuitet të shkollimit, bazuar në një drejtim apo profil të caktuar. Pra, në kuadër të arsimit fillor mungojnë testet e vlerësimit të aftësive dhe dhuntive që posedojnë nxënësit si dhe të mekanizmave të ngjashëm pedagogjik, të cilët do të stimulonin ende më tepër zhvillimin e atyre dhuntive, me qëllim të orientimit të nxënësve drejt shkollave profesionale që do të ishin unison me ato dhunti. Në të njëjtën kohë, është pikërisht mos funksionimi i këtyre mekanizmave që, nga njohës të arsimit, shihen si problem që ë mënyrë jo të drejtpërdrejtë, ndikojnë edhe në

S'ka sistem për orientimin e shkollimit sipas aftësive të nxënësve

# Studimet dhe shkolla e mesme asnjë pikë takimi



NUHI DARDHISHTA

**“Në rast të funksionimit të sistemit, i cili do të orienton nxënësit sipas aftësive dhe dhuntive që ata kanë, jo vetëm që secili do ta gjejë veten në vendin e vet, por do të jenë shumë më të larta edhe rezultatet e mësimeve. Nxënësit, kuptohet që do të ndjehen shumë më kompetent në fushën ku i kanë orientuar mësimit dhe studimet e tyre, pra do të japin maksimumin e tyre. Dhe në instancë të fundit, do të jenë shumë më cilësore edhe rezultatet që ato do të japin gjatë mësimit apo studimit**



rënien e cilësisë në arsim. Kështu, në Maqedoni mund të kesh ndjekur çfarëdolloj shkollimit të mesëm, të kesh dhënë cilëndo lëndë si provim të maturës shtetërore dhe të mos kesh asnjë kufizim apo prioritet për degën në

të cilën do të regjistrohesh studimet. Pra, mund të kesh mësuar katër vite në ndonjërin prej shkollave të mesme të mjekësisë, të kesh dhënë provim mature gjuhën angleze dhe mund të pranohesh në fakultetin e arkitekturës,

dhuntive që ata kanë, jo vetëm që secili do ta gjejë veten në vendin e vet, por do të jenë shumë më të larta edhe rezultatet e mësimeve. Nxënësit, kuptohet që do të ndjehen shumë më kompetent në fushën ku i kanë orientuar mësimit dhe studimet e tyre, pra do të japin maksimumin e tyre. Dhe në instancë të fundit, do të jenë shumë më cilësore edhe rezultatet që ato do të japin gjatë mësimit apo studimit”, vlerëson Dardhishta.

Për Nuhi Dardhishtën, kryetarin e Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” në Shkup është shumë e nevojshme të ndërmerret diçka, me qëllim të përmirësimit të kësaj situatë. “Në rast të funksionimit të sistemit, i cili do të orienton nxënësit sipas aftësive dhe

dhuntive që ata kanë, jo vetëm që secili do ta gjejë veten në vendin e vet, por do të jenë shumë më të larta edhe rezultatet e mësimeve. Nxënësit, kuptohet që do të ndjehen shumë më kompetent në fushën ku i kanë orientuar mësimit dhe studimet e tyre, pra do të japin maksimumin e tyre. Dhe në instancë të fundit, do të jenë shumë më cilësore edhe rezultatet që ato do të japin gjatë mësimit apo studimit”, vlerëson Dardhishta.

Por, realiteti në Maqedoni flet për një situatë krejt ndryshe, dhe për Dardhishtën, problemi nis që nga mungesa e sistemit të klasifikimit dhe orientimit të nxënësve nga shkolla e mesme në universitete, për të përfunduar më pas të mungesa e kufizimeve për regjistrimin e tyre në degë sipas fushave përkatëse.

“Në të gjitha universitetet e Maqedonisë, qofshin publike aspo private, nuk ka kufizime në pranimin e studentëve bazuar në shkollimin paraprak të tyre dhe lëndën e provimit të maturës shtetërore”, plotëson ai. Madje, ka universitete private që nuk e marrin në konsideratë as provimin e maturës shtetërore, ndërsa për notat nga testimi ekstern as që kanë bërë fjalë deri vitin e shkuar. Ky është

edhe shkaku kryesor përse nxënësit nuk tregojnë përkushtim ndaj lëndëve të shkencave ekzakte. “E dinë se mund të regjistrohen në çfarëdo fakulteti dhe për këtë pjesa më e madhe e nxënësve shohin se si të arrijnë më lehtë te nota e lartë dhe jo të zgjedhin lëndën sipas shkencave ku duan të studiojnë. Këtë ua mundësojnë vetë universitetet dhe këtyre të fundit vetë Ministria e Arsimit”, pohon kryetari i LASH-it. Pra, sipas tij, maturantët nuk kanë pse të lodhen të zgjedhin matematikën provim mature, kur dihet se për përvetësimin e kësaj lënde nevojitet shumë më tepër punë se sa për mësimin e gjuhës angleze.

Matematika dhe anglishtja janë dy lëndë mes të cilave maturantët duhet të zgjedhin njërin prej tyre për provim të dytë të maturës shtetërore. Si me njërin, ashtu edhe me tjetrin, nuk mund të regjistrohen në të gjitha fakulteteve pa përzjashtim dhe për këtë shumica dërmuese e nxënësve zgjedhin anglishten, respektivisht mbi 85 për qind e maturantëve. Që gjërat të vinë në vendin e duhur, sipas Dardhishtës, duhet që universitetet, në bashkëpunim me MASH-in, të kufizojnë numrin e lëndëve dhe shkollimin paraprak të nxënësve varësisht drejtimeve të fakulteteve. Vetëm në këtë mënyrë në fakultete e mjekësisë nuk do të regjistrohen ata që katër vjet kanë kryer shkollën e mesme të ekonomisë edhe në të njëjtën kohë ata që kanë mbaruar shkollën e mesmen të mjekësisë nuk do të ndryshojë degën e studimit, por do të vazhdojnë të studiojnë në ndonjë degë të mjekësisë.

Distanca të papërballueshme për filloristët

## Pesë kilometra vajtje-ardhje janë shumë

Fëmijë nga mosha pesë vjet e gjysmë deri në 10 vjet, në zona të caktuara duhet të ecin në këmbë nga dy e më tepër kilometër për të vajtur në shkollë dhe po kaq për tu kthyer në shtëpi. Sipas prindërve, por edhe mësimitdhënësve, fëmijët e kësaj grup-moshe e kanë të vështirë të përballojnë çdo ditë ecje nga pesë kilometra rrugë për vajtje-ardhje në shkollë. Prandaj kërkojnë korrigjimin e distancave ligjore për organizimin e transportit falas në arsimin fillor ose heqjen e komplet kufizimeve

Shkup, 31 tetor - Organizimi i transportit publik, falas për nxënësit, të cilët jetojnë më larg se 2.5 kilometra nga shkolla në të cilën duhet të mësojnë - po kthehet në disfavor për shumë nxënës të cilët

edhe pse nuk e tejkalojnë këtë distancë, llogaritet se jetojnë jo afër shkollës. Problematike është mos sigurimi i transportit falas në shkollimin nëntëvjeçar, sidomos për filloristët e dy cikleve të para të arsimit nëntëvjeçar. Fëmijë nga mosha pesë vjet e gjysmë deri në 10 vjet, në zona të caktuara duhet të ecin në këmbë nga dy e më tepër kilometra për të vajtur në shkollë dhe po kaq për tu kthyer në shtëpi. Sipas prindërve, por edhe mësimitdhënësve, fëmijët e kësaj grup-moshe e kanë të vështirë të përballojnë çdo ditë ecje nga pesë kilometra rrugë për vajtje-ardhje në shkollë. Prandaj, kërkojnë korrigjimin e distancave ligjore për organizimin e transportit falas në arsimin fillor ose heqjen e komplet kufizimeve.

Nga kjo panoramë jo edhe e këndshme, nuk bën përjashtim as kryeqyteti. Në lagje të ndryshme të Shkupit, si Vizbegu, Nerezi apo Lloka,



ose edhe në fshatra si Mojanca, sheh çdo ditë grupe nxënësish që shkojnë në këmbë në shkollë pavarësisht kushteve atmosferike. Të njëjtin problem e ka edhe Tetova dhe komunat tjera rurale të saj. Gjithë kjo sepse komunat ku ata jetojnë, nuk marrin përsipër të organizojnë transport falas për këtë nxënës, ashtu si edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në bllok-dotacionet që Ministria e Ar-

simit u ndan komunave, në grafën e llogaritjes së shpenzimeve për transportin falas hyn vetëm numri i nxënësve vendbanimi i të cilëve gjendet 2.5 kilometra larg shkollës. Në bazë të këtyre shpenzimeve, komunat përgatisin programin për ofertat drejtuar kompanive të licencuara për transport publik, konkretisht për aq sa shkon vlera e shpenzimeve të mbuluara nga

MASH-i përmes bllok-dotacioneve, të cilat përgatiten mbi bazën e të dhënave historike të shkollave, gjegjësisht komunave. Jasin Reka, arsimtar në shkollën fillore “7 Marsi” në Tetovë, thotë se distanca për transportin falas të nxënësve është problem në gjithë vendin. “MASH duhet të ndërmarrë diçka në favor të kësaj kategorie nxënësish të cilët nuk janë pak. Në nivel shteti mund të jenë mbase mijëra nxënës të cilët vërtet që nuk e kanë shkollën më larg se dy kilometra e gjysmë, por përsëri e kanë larg edhe nëse ajo distancë është dy deri dy kilometra e gjysmë”, shprehet Reka. Sidomos, për nxënësit e ciklevet të ulta të arsimit nëntëvjeçar, mosha e të cilëve shkon deri në 10 vjet, është e tepërt po sikur të ecin nga dy kilometra deri në shkollë dhe po aq nga shkolla në shtëpi, plotëson më tej ai. Sipas Rekës, i cili

është anëtarë i Grupit punues për ndryshime në arsimin fillor, zgjidhjet për problemin e transportimit të nxënësve mund të jenë të ndryshme. Por, ka shumë gjasa që në kërkesën e atij grupi të propozohet shkurtimi distancës deri në një kilometër e gjysmë, ose të hiqen fare kufizimet. Kjo, pritet të dihet saktësisht pas tre-katër javësh kur edhe do të jetë takimi i radhës. Në këtë takim, Grupi i punës do të mbajë qëndrimet definitive, si dhe variantet përfundimtare të ndryshimeve që do të propozohen nga ana e tyre jo vetëm për çështjen e transportit, por për të gjitha çështjet e kontestuar. Intenca e MASH-it është të ofrojë zgjidhjet për të gjitha problemet e evidentuara në arsim dhe njëkohësisht të vjen deri tek zgjidhjet më të mira të cilat do të burojnë nga palët e involvuara në arsim. (L.P)





Dorëzohen ankesat e para në KSHZ

# ASH edhe në Qeveri, edhe me BESËN

**Aleanca për Shqiptarët ka animuar procesin e zgjedhjeve në dhjetë vendvotime - të gjitha në Komunën e Strugës, komunë kjo ku Ziadin Sela humbi nga kandidati i BDI-së, Ramiz Merko me mbi 700 vota dallim. Lëvizja BESA nga ana tjetër ka dorëzuar ankesa për Komunën e Çairit**

Koha Fatos RUSHTI

Shkup, 31 tetor - Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA, parti këto që ishin në koalicionin gjatë rrethit të dytë zgjedhor, të martën deri në KSZH kanë dorëzuar ankesa për parregullsi të procesit zgjedhor. E para ka animuar procesin e zgjedhjeve në dhjetë vendvotime - të gjitha në Komunën e Strugës, komunë kjo ku Ziadin Sela humbi nga kandidati i BDI-së, Ramiz Merko me mbi 700 vota dallim. Lëvizja BESA nga ana tjetër ka dorëzuar ankesa për Komunën e Çairit. "Presim që ankesat tona të merren seriozisht nga KSHZ për shkak se bëhet fjalë për parregullsi të shumta që shoqëruan procesin zgjedhor në Komunën e Strugës. Sigurisht se në rast të përgjigjes negative nga KSHZ, do të parashtrijmë padi deri te Gjykata Administrative, ku do të kërkojmë të



përsëriten votimet në disa vendvotime dhe ku shumica janë votues shqiptarë, ndërsa shpresojmë të kthejmë rezultatin në favorin tonë", thotë për gazetën KOHA zëdhënësi i ASH-së, Flakron Bexheti. Ai njëherësh sqaron dilemat rreth pozicionit të partisë së tij në qeverinë e re. Siç thotë Bexheti, ASH

do të mbetet në Qeveri për të ndihmuar procesin e reformuar dhe agjendën politike të shqiptarëve në Maqedoni. Ai paralajmëron se qëndrimet politike të ASH-së do të kristalizohen në mbledhjen e radhë të Kryesisë së partisë, ndërsa për momentin thotë se koalicioni me BESËN nuk do të

dëmtojë pozicionin e partisë në Qeveri. "Ne do të vazhdojmë të jemi në Qeveri për të ndihmuar procesin reformues pavarësisht se u dëmtuam si parti në qytetin e Strugës nga dy partnerët tanë qeveritar. Por ASH mendon dhe punon për të mirën e përgjithshme të shqiptarëve në Maqedoni

dhe do të jetë pjesë e Qeverisë derisa të realizohet agjenda politike e shqiptarëve, duke filluar nga Ligji për gjuhën shqipe, reformimi i sistemit gjyqësor dhe zbardhja e rasteve të montuara politike që vetëm se ka filluar, si dhe barazi buxhetore për qytetarët shqiptarë. Këto qëndrime do të kristalizohen më shumë në mbledhjen e Kryesisë së partisë që do të mbahet shumë shpejtë ku edhe do të analizohet në tërësi procesi zgjedhor. Koalicioni me BESËN është vullnet i dy partive politike dhe nuk mund të dëmtojë pozicionin tonë në Qeveri", thotë Bexheti. Ai konfirmon atë që tha kryetari i ri i Gostivarit, Arben Taravari se Ziadin Sela nuk do të jetë ministër i Shëndetësisë, por dikush tjetër për të cilin do të vendos Kryesia e partisë. Në ndërkohë, në taborin maqedonas - VMRO dhe LSDM vazhdojnë më akuzat ndaj njëra-tjetrës për zgjedhjet lokale

të 15 tetorit. VMRO akuzoi LSDM-në se ka organizuar zgjedhjet më të parregullta dhe më jodemokratike në Maqedoni, ndërsa thanë se LSDM se kanë uzurpuar hapësirën mediatike në Maqedoni. "LSDM, Zaevi dhe Spasovski realizuan zgjedhjet më të parregullta dhe më jo-demokratike në Maqedoni. Gjatë procesit të votimit, gjatë dy rrethëve zgjedhore ishin vërejtur shumë parregullsi, indikacione për blerjen të votave, agjitim partiak, trysni, kërcënime dhe shantazhe nga persona të uniformuar dhe të pa uniformuar, përleshje fizike, organizimin të ashtuquajturit 'treni bullgar'. LSDM dhe Zaevi gjithashtu kanë uzurpuar dhe korruptuar hapësirën mediatike në Maqedoni, ku nuk u plotësuan as minimumin e standardeve për zgjedhje fer dhe pjesëmarrje të barabartë në procesin zgjedhor. Vetëm një gjë është e qartë, këto zgjedhje lanë një pikë të zezë në historinë e Maqedonisë", thuhet në komunikatën për media të VMRO-së. Pas qëndrimit të VMRO-së për mosnjohje të zgjedhjeve në rrethine dytë zgjedhor, sekretari i përgjithshëm i VMRO-së, Hristijan Mickoski, dha dorëheqje nga Këshilli i Qytetit të Shkupit. Paraprakisht, LSDM ka kërkuar nga VMRO të shqyrtojë qëndrimin për mosnjohje të zgjedhjeve për të vendosur në plan të parë interesin e shtetit e jo interesin partiak.

## AMBASADA E SHBA-SË PËRSHËNDET ZGJEDHJET

Ambasada e SHBA-ve i përshëndeti konstatimet e para të OSBE/ODIHR se zgjedhjet lokale ishin kompetitive dhe se respektimi i lirive themelore kontribuoi drejt përmirësimit të procesit demokratik. "Këto konstatime janë në pajtim me atë që ekipet e Ambasadës së SHBA-së e kanë vërejtur në raundin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve", thuhet në kumtesën e djeshme të Ambasadës së SHBA-ve në Shkup. Atje ku ekziston shqetësim për parregullsi dhe keqpërdorime, Ambasada e SHBA-së, siç qëndron, përsëri u rekomandon qytetarëve që ta shfrytëzojnë procedurën përkatëse dhe t'i denoncojnë, ndërsa autoriteteve relevante t'i adresojnë shpejt. "Gjithashtu i rekomandojmë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe trupave të tjerë relevant qeveritar që ta shfrytëzojnë periudhën pas këtij procesi zgjedhor që të fokusohen në rekomandimet e ODIHR që ishin dhënë pas zgjedhjeve në vitin 2016 dhe 2017. Me këtë do të përforcohen proceset e ardhshme zgjedhore", thuhet në kumtesën e Ambasadës së SHBA-së. Pushteti i fuqishëm lokal, theksojnë nga Ambasada, siguron baza për një demokraci dinamike. "I inkurajojmë kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunal të sapozgjedhur të jenë të hapur, në dispozicion dhe përgjegjës për qytetarët në komunat e tyre. Ambasada do ta vazhdojë bashkëpunimin me komunat, organizatat dhe qytetarët që të zhvillohen reformat kyçe në nivel lokal", thuhet në kumtesë. Ambasada e SHBA-ve, gjithashtu, i uroi qytetarët e Maqedonisë të cilët e shfrytëzuan të drejtën e tyre të votës gjatë zgjedhjeve lokale në tetor të vitit 2017.

Investime prej 86 milionë euro për rrugë dhe autostrada

## Rruga Shkup-Bllacë nuk do bëhet autostradë!

**Vetëm 3 milionë euro janë paraparë për rrugën 12.5 kilometërshë Shkup-Bllacë, ndërsa e njëjta as vitin e ardhshëm dhe as në 2019 me gjasë nuk do bëhet autostradë. Ministri Sugarevski këtë rrugë e ka përmendur në grafën e "rindërtimit të rrugëve", ndërsa nga dhjetëra projekte tjera, ka përmendur vetëm rikonstruimin e rrugës Podmolje-Strugë-Qafë Thanë në gjatësi prej 19 kilometrave, gjithashtu me vetëm 3 milionë euro, si dhe 16 kilometra nga aksi Karpallak-Zhelinë (2.5 milionë euro)**

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 31 tetor - Tetëdhjetë e gjashtë milionë euro do të investohen në ripërtëritje të 26 akseve

rrugore, një pjesë autostrada, ndërsa pjesa më e madhe akse rajonale, në gjatësi të përgjithshme prej 420 kilometrave, paralajmëroi të martën ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. Rikonstruksioni i rrjetit rrugor, siç tha Sugareski, do të zhvillohet në dy vitet e ardhshme. "Pjesën më të madhe të këtyre rrugëve i kemi premtuar në programin tonë, ndërsa një pjesë janë të reja, për të cilat kemi siguruar mjete nga institucione ndërkombëtare financiare", tha Sugareski në konferencën për shtyp në Qeveri. Me ciklin investues për ripërtëritje të rrugëve, sipas planit, është parashikuar ripërtëritje e akseve të autostradave Milladinovc-Petrovec në gjatësi prej tetë kilometrave, me vlerë të vlerësuar prej 1.5 milionë eurove, Hipodrom-Petrovec dhe Milladinovc-Hipodrom nga të cilat akse do të ripërtërihen nga 10 kilo-



metra me investim prej nga 4 milionë euro. Megjithatë, rruga Shkup-Bllacë nuk do të shndërrohet në autostradë, pasi siç tha ministri Sugareski, vetëm tre milionë euro do të investohen për "rindërtimin e rrugës" Shkup-Bllacë në gjatësi prej 12.5 kilometrave. Ai nuk për-

mendi se do bëhet fjalë për "autostradë", pasi vetëm 3 milionë euro sigurisht se nuk do mjaftonin për 12.5 kilometra autostradë. Ministri ka informuar se do të zgjerohet edhe korsia e majtë dhe do të riparohen dy korsitë në rrugën Katllanovë-Petrove në gjatësi prej 6.5 kilometra

me vlerë të vlerësuar prej 5 milionë eurove, ndërsa nga 6 milionë euro, do të investohen për ripërtëritje të 18 kilometrave nga rruga Probishtip-Krupishtë dhe në korsinë e tretë në aksin rrugor gryka Faroshka-Prilep në gjatësi prej 23 kilometrave. Katër milionë euro do të arrijë rikonstruksioni i 20 kilometrave nga aksi rrugor hanet e Mavrovës-Zhironovicë, ndërsa 3 milionë euro në rrugën Shtip-Radovish në gjatësi prej 20 kilometrave. Do të ripërtërihen edhe 13 kilometra nga rruga Krivogashan-Krushevë (dy milionë euro), 16 kilometra nga aksi Karpallak-Zhelinë (2.5 milionë euro). Tre milionë, sipas paralajmërimit, do të investohen edhe për rindërtimin e rrugës Kriva Pallankë-Rankovce në gjatësi prej 21 kilometrave dhe Podmolje-Strugë-Qafë Thanë në gjatësi prej 19 kilometrave. Është paralajmëruar edhe rindërtimi i rrugës

Kumanovë-Sveti Nikollë në gjatësi prej 18 kilometrave dhe Krushevë-Demir Hisar, në gjatësi prej 24 kilometrave, në të cilat rrugë do të investohen 3.5 milionë euro për rindërtimin e 20 kilometrave të rrugës Kumanovë-Veles janë parashikuar 3.2 milionë euro. Në planet për riparime janë edhe akset rrugore Veles-Negotinë-Demir Kapi në gjatësi prej 25 kilometrave dhe vlerë e përllogaritur prej 4 milionë eurove, Drugovë - Demir Hisar në gjatësi prej 42 kilometrave dhe në prej vlerë 7.5 milionë euro. Rruga Kërçovë-Makedonski Brod në gjatësi prej 25 kilometrave gjithashtu pjesë e paketës së planifikuar për rindërtim ku do të investohen pesë milionë euro. Siç theksoi Sugareski, përcaktimi programor i Qeverisë është përmirësim cilësor i rrjetit rrugor në Maqedoni dhe ngritje e sigurisë së rrugëve në nivel më të lartë.





Edhe pse ITSHKSH më 22 nëntor do të shënojë dhjetë vjetorin e themelimit, funksionimi i tij gjatë këtyre viteve lëviz brenda një qerthulli problemesh të njëjta, numër i vogël kuadros, pa buxhet vjetor për veprimtarinë shkencore e hulumtuese, pa godinë të vetën... Nga ky institut pohojnë se kanë përpiluar disa programe, miratimi dhe financimi i të cilave është një sfidë për institucionet shtetërore, por edhe për funksionimin e mëtejshëm të ITSHKSH, që gjatë këtyre viteve nuk ka pasur në dispozicion buxhet për të stimuluar dhe realizuar veprimtarinë shkencore dhe hulumtuese

Koha Evis HALILI

Shkup, 31 tetor - Shënimi i dhjetë vjetorit të themelimit ka qenë një prej shkaktarëve që në xhirollogarinë e tij të derdhet shuma e parë për financimin e aktivitetit të tij. Bëhet fjalë për financimin nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të projektit për botimin e një kompleti veprash që lidhen me shënimin e kësaj date. Kjo do të jetë edhe mbështetja e vetme financiare nga

ITSHKSH dhe SIMO e organizojnë bashkë përvjetorin

## Pas 10 vjetësh, Instituti merr sponsorizimin e parë

shteti për këtë përvjetor, shënimi i të cilit do të shtrihet nga datat 20-22 nëntor. Sipas drejtorit Skënder Hasani, Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, do të jetë institucioni që do të marrë përsipër mbështetjen e kësaj date dhe programin e aktiviteteve që do të zhvillohen në Shkup e Manastir.

Por, edhe pse ITSHKSH më 22 nëntor do të shënojë dhjetë vjetorin e themelimit, funksionimi i tij gjatë këtyre viteve lëviz brenda një qerthulli problemesh të njëjta, numër i vogël kuadros, pa buxhet vjetor për veprimtarinë shkencore e hulumtuese, pa godinë të vetën... Janë vetëm 1 milionë e 200 mijë denarë, buxheti që ka në dispozicion ky institucion nacional, ku më shumë se 80 për qind shpenzohet për faturat elektrike, mirëmbajtjen e shërbimet e tjera. Ndërkohë që Ministria e Arsimit dhe Shkencës, asnjëherë nuk ka akorduar fonde vjetore



për realizimin e projekteve dhe veprimtarisë shkencore dhe hulumtuese, duke bërë kështu që drejtimi i këtij institucioni të kalojë nga një drejtor në tjetrin, ndërsa vetë aktiviteti i tij të ketë si ngjarje kryesore nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, promovime librash dhe revistash dhe vitet e fundit i janë shtuar edhe ngjarje të tjera më të rëndë-

sishme, si organizmi i konferencave shkencore ndërkombëtare, e të tjera. "Etablimi i institucionit filloi vonë dhe për punën që kemi bërë vitet e fundit kemi marrë vlerësime të jashtëzakonshme nga jashtë. Por, duhet që të ndihmohemi nga institucionet shtetërore, kemi nevoja si për objektin, strukturimin e brendshëm me punësime e kapacitete të

reja, e të tjera. Përkrahja financiare është më jetike. Për herë të parë kemi hartuar programin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, që përbën një sfidë më vete për institucionet shtetërore që duhet ta mbështesin. Nuk do të kishte më kuptim që ne të vazhdojmë të funksionojmë kështu, pa asnjë lloj financimi nga MASH për projektet dhe programin vjetor. Këtë vit për herë të parë u mbështet financimi i botimeve me rastin e dhjetë vjetorit, por vetëm kaq. Pjesa tjetër e organizimit do të mbështetet nga SIMO", thotë drejtori Hasani.

ITSHKSH u themelua më 22 nëntor, në Ditën e Alfabetit të gjuhës shqipe, datë kjo që u bë pjesë edhe e kalendarit të festave nacionale. Drejtorësia e parë ka qenë Mirusha Hoxha dhe në vitet e para ky institucion nisi funksionimin me vizione dhe koncepte që humbën dhe u transformuan gjatë këtij rrugëtimi dhjetë vjeçar.

## Qeveria të paguajë borxhin e RTVM-së ndaj EBU

Shkup, 31 tetor - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë i bën thirrje Qeverisë sa më shpejt të sigurojë mjete për të paguar borxhin që ka RTVM ndaj Bashkimit të Transmetuesve Evropianë (EBU), i cili është rreth një milion euro. Në këtë mënyrë do të zgjidhet rreziku që Radiotelevizioni i Maqedonisë të "largohet" nga EBU që paraqet hap i madh mbrapa në procesin e euro integritimit të cili gjithashtu shkel edhe imazhin e Republikës së Maqedonisë, thuhet në njoftimin e SHGM-së. "Mospagimi i borxhit do të thotë se RTVM nuk do të jetë në gjendje të transmetojë program nga ndonjë anëtar i EBU-së, si dhe as ndeshjet sportive, filmat, emisionet, filmat e vizatara etj. Për momentin, sipas informacionit që vjen nga EBU, RTM nuk ka qasje në përmbytjet që transmetohen përmes servileve të tyre". Reagimi i EBU-së, sipas SGGM-së, është pasojë e punës së papërgjegjshme të servilit publik për çka do të duhet të përgjigjen. "Përfundimi i RTVM-së nga EBU është rezultat i një modeli jo funksional të financimit të servilit publik dhe menaxhimit të keq. Këshilli Programor i RTM-së në seancën e fundit solli konkluzion duke kërkuar nga Qeveria të paguan borxhin e RTM-së ndaj Bashkimit të Transmetuesve Evropianë", thuhet në njoftim.

## Qytetarët në banka ruajnë 222 miliardë denarë

Shkup, 31 tetor - Depozitat në bankat në Maqedoni janë të sigurta. Bankat janë likuide dhe stabile, ndërsa qytetarët të cilët i ruajnë paratë në shtëpi duhet t'i vendosin si depozita të kursimit sepse kështu do të realizojnë interes të caktuar për vete, ndërsa bankave do t'ju mundësojnë mjetet shtesë t'i plasojnë atje ku janë të nevojshme. Kjo u porositi në shënimin e Ditës Botërore të Kursimit - 31 tetori në Shoqatën e bankave pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë. Qytetarët në bankat në Maqedoni ruajnë 222 mil-



iardë denarë, ndërsa kompanitë 80 miliardë. Pesëdhjetë e një për qind e depozitave janë në denarë. Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Dimitar Bo-

gov, potencoi se kursimi ka rritje prej gjashtë për qind të bazës vjetor dhe se kjo është solide duke e pasur parasysh ambientin në të cilin është realizuar. Ai konsideron se popullata e

Maqedonisë ka potencial për shkallë më të larta të kursimit dhe shpreson se shkalla do të kthehet në atë që ishte para krizës. E theksoi tenderin e kursimit të rritur në denarë dhe tha se pret që kjo të vazhdojë, si dhe besimi në valutën vendore. Sipas ministrit të Financave, Dragan Tevdovski, kursimi është burimi më i lirë për financimin e ekonomisë vendore dhe i inkurajoi bankat t'i mbështesin kompanitë vendore në aktivitetet e tyre investive. "Kapitali nga jashtë vendit është më i shtrenjtë, më pak i qasshëm dhe

shumë shpesh më pak stabil. Është mirë që me përfundimin e krizës ka rritje të depozitave prej rreth gjashtë për qind dhe pres në periudhën e ardhshme të realizohen shkallë më të larta të depozitave", deklaroi Tevdovski. Kosta Mitrovski, kryetar i Shoqatës së bankave theksoi se sistemi bankar realizon nivel më të lartë të stabilitetit dhe se kursimi merr vend qendror në punën e bankave. Sipas tij, tradita e kursimit në Maqedoni ekziston dhe atë bankat duhet ta mbajnë me prodhime konkrete.

"Higjiena Publike" ashpëron dënimet

## Djegia e kontejnerëve, 50 deri 500 euro gjoba për qytetarët!

Shkup, 31 tetor - Ndërmarrja Publike "Higjiena Komunale" - Shkup, do të tentojë të rrit sanksionet ndaj personave juridik dhe fizik të cilët për çdo vit e dëmtojnë këtë ndërmarje me mijëra euro duke djegur kontejnerët e plastikës. Drejtori i ndërmarrjes, Rakip Doçim, për gazetën KOHA ka theksuar se nga 50 deri më 500 euro shkojnë dënimet ndaj personave fizik dhe juridik që djegin kontejnerët e ndërmarrjes, megjithëse deri më tani, asnjë gjobë nuk

është shqiptuar. "Djegia e kontejnerëve ndodh si rezultat i pakujdesisë së personave juridik të cilët përdorin zjarrin në restorantet e tyre dhe kur e largojnë prushin e vendosin në kontejner. Apeloj te kjo kategori e personave të cilët bëjnë djegien e kontejnerëve prej plastike që ta ndërpresin këtë dukuri për arsye se me këtë jo vetëm që i shkaktojnë dëm material ndërmarrjes publike, por edhe qytetarëve sepse qytetarët tani më ju zvogëlohet kapaciteti se ku duhet ta

vendosin mbeturinën komunale", tha Doçi. Nëse kapet një person juridik duke djegur kontejnerët - sanksionohet deri në 500 euro, ndërsa personi fizik deri 50 euro. "Apeloj tek inspektoratet e ndryshme, si ato të qytetit dhe komunave përkatëse, tek policia dhe inspektorët tjerë komunal, që të sanksionojnë kryerësit e këtyre veprave. Nëse është fjala për person juridik për djegie të kontejnerëve dënimi është 500 euro, megjithatë për fat të keq deri tash askush



nuk dënohet. Personat fizik dënohen për 50 euro, ndërsa këto dënime

duhet të rriten do të thotë janë të vogla", njofton Doçi. Në ndërkohë, Doçi

ka informuar se një kontejner kushton mbi 200 euro. "Ende s'kemi bërë për këtë vit analiza se sa është dëmi që i shkaktohet ndërmarrjes me rastin e djegies së kontejnerëve prej plastike, por numri i tyre zakonisht e tejkalon 185 brenda vitit dhe nëse merret parasysh ky numër do me thënë shuma e tyre, për një kontejnerë që kushton minimum 200 euro, mund të llogaritet sa është dëmi që i bëhet ndërmarrjes", theksoi ai. (A.XH)





Harmonizohen qëndrimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe PSP-së

# Ligji për dëshmitarët, i domosdoshëm

Me propozim të Prokurorit Publik, në të gjitha proceset e deritanishme gjyqësore, Këshilli pesë anëtarësh i përbërë nga përfaqësues të më shumë institucioneve, ka vendosur se një person i caktuar do të futet ose jo në programin e dëshmitarëve të mbrojtur. Në këtë drejtim kërkesa e PSP-së, është që kjo e drejtë kur flitet për rastet që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme, t'ju takojë vetëm atyre



me procedimin dhe shqyrtimin e rasteve të tyre.

"Procedura aktuale që një person të vendoset në programin e dëshmitarëve të mbrojtur, ligji aktual e parashihet ta bëjë një Këshill pesë anëtarësh, për të cilën ne nuk kemi asnjë vërejtje. Mirëpo, propozimi ynë në këtë drejtim, është që në vend të Këshillit, i cili duhet ta shqyrtojë mundësinë se një person duhet apo nuk duhet të vendoset në program, ne kërkojmë që në rastet e ndryshme të përgjithshme të ligjit, por vetëm shtimin e paragrafëve", tha prokurorja speciale, Lençe Ristovska, për gazetën KOHA.

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 31 tetor - Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria Speciale Publike, gjatë periudhës së kaluar i kanë harmonizuar qëndrimet e tyre sa i përket plotësim-ndryshimit të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në një njoftim për gazetën KOHA, nga PSP-ja kanë thënë se të gjitha rekomandimet dhe vërejtjet për ligjin në fjalë, nga ana e tyre janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë. Ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, nga prokuroria speciale e Katica Janevës, vazhdimisht i kanë cilësuar si nevojë e domosdoshme për procedimin e mëtutjeshëm të lëndëve, siç janë "Monstra", "Martin Neshkovski" e kështu me radhë. Me këtë rast, ata kanë nënvizuar se dispozitat e ligjit në fjalë në përgjithësi janë qëndrueshme, megjithatë propozimin e ndryshimeve të cilët ata e kanë iniciuar, kryesisht ka të bëjë

Njëkohësisht, nga Ministria e Drejtësisë kanë thënë se propozim - ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, janë vendosur në Regjistrin e vetëm elektronik kombëtar për dispozita (REKD), i cili parashihet inkuadrimit e opinionit në fazën

fillestare të përgatitjes së ligjeve. Përveç publikimit në REKD-ë, nga kjo ministri, për gazetën KOHA, kanë bërë të ditur se Propozim ligji në fjalë u është dorëzuar për shqyrtim dhe vlerësim në më shumë institucione shtetërore dhe se pas kalimit të këtyre filtrave, i njëjti do të futet në procedurë qeveritare. Ndryshe, plotësimi i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili sipas të gjitha paralajmërimeve duhet të ndihmoi palët në zbardhjet e plotë të vrasjes së pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës, pritet të bëhet në dispozitat e neni 6 dhe 10. Me propozim të Prokurorit Publik, në të gjitha proceset e deritanishme gjyqësore, Këshilli pesë anëtarësh i përbërë nga përfaqësues të më shumë institucioneve, ka vendosur se një person i caktuar do të futet ose jo në programin e dëshmitarëve të mbrojtur. Në këtë drejtim, kërkesa e PSP-së, është që kjo e drejtë kur flitet për rastet që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme, t'ju takojë

vetëm atyre. Përfaqësues nga radhët e gjykatësve në Gjykatën Supreme, përfaqësues nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë Publike, drejtori i Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve, përfaqësues i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe përfaqësues nga Sektori për mbrojtje të dëshmitarëve, e përbëjnë Këshillin, i cili, siç thuhet në nenin 10, paragrafi 3, ka të drejtë të miratimit të vendimit për "ndryshimin e identitetit" si masë e sigurisë. Ekspertët juridik, të akuzuarit dhe avokatët e tyre në më shumë proces gjyqësore në vend, të kategorizuar a si "montime politike", kanë akuzuar se Këshilli në fjalë është keqpërdorur në shumë raste për qërimin e hesapeve politike. Krahas rastit "Monstra" ku deklaratat e dëshmitarin të mbrojtur ishin argumente kyçe për aktgjykimin me burg të përjetshëm, proces tjetër ku dëshmitari i mbrojtur ka pasur fjalën përfundimtare ka qenë vrasja e njësitit "Alfa" në vitin 2008 në lagjen Gazi Babë.

## Kronikë

### Grabitje e armatosur në farmacinë në Gjorçe Petrov

Persona të maskuar me kanosje me pistoletë mbrëmë kanë grabitur një farmaci në lagjen Gjorçe Petrov. Siç njoftojnë nga MPB-ja, ngjarja ndodhi rreth orë 19 në një farmaci në rrugën "Gjorçe Petrov", kur një autor i panjohur i maskuar me maskë në kokë, me kanosje me pistoletë ka kryer grabitje ndaj të punësuarve dhe u ka marrë paratë nga qarkullimi ditur. Është kryer ekspertizë dhe po merren masa për gjetjen e autorit.

### Dy aksidente, katër të lënduar

Të martën mbrëmë, rreth orës 22.00, në rrugën regionale Tetovë-Pirok, afër fshatit Pallçisht ka ndodhur një aksident komunikacioni, në të cilin janë aksidentuar dy automjete me targa të Tetovës, një veturë e tipit "Golf", e drejtuar nga 20-vjeçari me iniciale B.I nga Bogovina si dhe një veturë tjetër e tipit "BMW", të cilën e ka drejtuar 24-vjeçari me iniciale E.XH, nga i njëjti fshat. Në këtë aksident që të dy vozitësit si dhe bashkudhëtarit i veturës Golf me iniciale S.M 19-vjeçarë nga Gradeci i Gostivarit, për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe me anë të një veturë tjetër janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Është kryer ekspertizë në vendngjarje dhe sipas të dhënave fillestare, si shkak për këtë aksident është mosmbajtja e anës përderisa dëmi i shkaktuar vlerësohet që të jetë rreth 100 mijë denarë. Në bulevardin e Ilindenit në Tetovë, të martën rreth orës 23.00, një veturë e tipit "BMW", e drejtuar nga 20-vjeçari me iniciale L.S nga Tetova, ka humbur kontrollin mbi automjetin për pasojë ka dalë nga rruga dhe ka goditur një shtyllë metalike të ndriçimit publik. Nga dalja prej rrugës vozitësi ka marrë lëndime trupore dhe me anë të një veturë tjetër është dërguar në spitalin klinik të Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës është lëshuar për mjekim shtëpiak. Si shkak i këtij aksidenti është mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës gjegjësisht vozitja e shpejtë, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet që të jetë rreth 60 mijë denarë.

### Shkup, 15 aksidente me 12 të lënduar

Dymbëdhjetë persona janë lënduar më lehtë në tetë prej gjithsej 15-të aksidenteve të trafikut të regjistruara gjatë ditës së kaluar në territorin e SPB Shkup, ndërsa shtatë pësuan dëme materiale. Siç informon MPB, gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Tre shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, dy shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve në vendkalimet e shënuara për këmbësorë, shtatë shoferë gjatë drejtimit të automjetit e kanë shfrytëzuar telefonin celular, si dhe 17-të shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin pa patentë shoferi, gjegjësisht të paregjistruar. Janë sanksionuar edhe dy këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë vendkalimit të shënuar për këmbësorë, gjegjësisht në dritë të kuqe të semaforit. Janë kapur edhe 57 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special karrotreci janë larguar 42 automjete.

### Padi për dy shkupjan, kontrabanduan marijuanë në vlerë prej 80.000 eurosh

Sektori i Punëve të Brendshme Shkup parashtrori padi penale kundër J.S (48) dhe A.S (43), të dy nga Shkupi, për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepër të kryer penale "prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve". Të denoncuarit drogën e kanë marrë në Kosovën fqinje, pas marrëveshjes paraprake me një person nga Kosova, për transport të marijuanës deri në Shkup, ndërsa për kompensim me para prej 500 euro për kilogram, gjegjësisht 7.500 euro. Vlera e drogës së sekuestruar në tregun e sivjetmë narkotik arrin pothuajse 80.000 euro. (U.H)

### Gjenden dy granata nga viti 2001

Tetovë, 31 tetor - Të martën në mëngjes, rreth orës 8.30 minuta, në afërsi të fshatit Tanushë e Rekës së Epërme, në vendin e ashtuquajtur "Melnik", të punësuarit në parkun kombëtarë "Mavrovë", kanë gjetur dy mjete shpërthyes, gjegjësisht të kalibr 60 milimetër, të cilat me siguri datojnë që nga konflikti i armatosur i vitit 2001. Është kryer hetim në vendngjarje, mjetet shpërthyes janë fotodokumentuar, më pas janë marrë dhe u janë dorëzuar për transport dhe shkatërrim pjesëtarëve të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim.

### Apeli e refuzoi kthimin e pasaportës të Gruevskit



Shkup, 31 tetor - Gjykata e Apelit Shkup e refuzoi kërkesën e avokatëve të liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski t'i kthehet pasaporta. Kryetarja e Gjykatës, Liljana Shopova, e cila ishte gjykatëse kryesore në

këshillin për vendimmarrje, për TV 24 ka konstatuar se kërkesa është refuzuar. Avokatët e Gruevskit në mbledhjen e djeshme publike në Gjykatën e Apelit, arsyetuan se kërkojnë t'i kthehet pasaporta sepse i duhet për udhëtim jashtë Maqedonisë, duke e cekur ftesën që ia ka bërë kryeministri hungarez, Viktor Orban. Prokurorët nga PSP, ndërkaq, kërkuar që pasaporta të mos i kthehet, sepse sipas tyre, mungesa e tij do të çonte drejt shtyrjes së proceseve që po zhvillohen kundër tij. Lideri i VMRO-DPMNE-së dhe ish-kryeministër Nikolla Gruevski është i akuzuar në disa lëndë të Prokurorisë Speciale Publike.





Dita Botërore e Kursimit

# Çfarë të kursejmë kur s'kemi para!

**Besarta Xhoni, magjistre e financave dhe kontabilitetit, mes tjerash thotë se Ballkani në përgjithësi përballet me probleme të tilla, pasi i varfëri gjithmonë paguan më shtrenjtë**



## NJË QYTETAR KURSEN 1804 DENARË NË MUAJ!

Në vendet e Evropës qendrore dhe jugore, sivjet qytetarët kanë arritur të kursejnë në muaj kursejnë 10.4 për qind më shumë se vjet, me çka në Austri - qytetarët në muaj kursejnë nga 239 euro, ndërsa në Serbi - nga 37 euro. Kështu tregojnë të dhënat e hulumtimit të bërë nga grupacioni i Bankave Erste me titull "Paratë në fokus". Sipas kësaj, sllovenët kursejnë nga 106 euro në muaj, rumunët 53 euro, kroatët nga 63 euro në muaj, ndërsa qytetarët e Maqedonisë bazuar në hulumtim - si dhe në të dhënat e Entit Shtetëror për Statistikë, arrijnë të kursejnë vetëm nga 1804 denarë në muaj!

Shkup, 31 tetor - Të martën është Dita botërore e kursimit. Jo secili është në gjendje të kursejë para. Kjo nuk ka të bëjë me mungesën e dëshirës, por me të ardhurat e ulëta. Përqindja më e buxheteve familjare me një të ardhur neto mujore nën mesataren apo 22.912 denarë nuk është në gjendje të kursejë për pleqërinë, sepse në fund të muajit - u mungojnë paratë. "Mbasi sot është Dita e Kursimit, ku ngritja e vetëdijes për vlefshërinë e vlerave financiare është e rëndësishme për planifikimin jetësor, personalisht unë nuk kam një kulturë të kursimit sidomos tek të ardhurat e mija, sepse absolutisht këtë e shoh si një mangësi, sepse kursimi stimulon organizimin, planifikimin dhe disiplinën jetësore, ku falë kursimeve - realizon një të ardhme më të sigurt, aq më shumë ku ne jemi pjesë e një shoqërie me të ardhura të pakta dhe ku shtresa e mesme është e vdekur. Tashmë kemi dy

trajktore - shumë të pasur dhe shumë të varfër, ndërsa uroj që kjo ditë të jetë më e aplikueshme si ndërgjegje", tha Arton Rama, politikolog i diplomuar. "Kursejmë sipas mundësive, por në këto kushte ekonomike, kursimi është thujtë i pamundur. Me pagat tona mundaohemi sadopak të kursejmë diçka për të ardhmen", tha Albana Mustafa Asani, profesore-

shë në shkollën e mesme të muzikës në Shkup. "Me një rrogë që është më pak se mesatarja - diku 21 mijë denarë dhe me katër anëtarë në familje, është shumë rëndë të arrish fundin e muajit e jo më të kursesh", thotë një arsimtar tjetër. "Unë personalisht kam shprehur kursimi, ndoshta nuk janë shumë, por arrij gjatë muajit të kursej diku rreth 2 mijë denarë që për mua - si

studente mendoj se është e mjaftueshme", tha Egzona Ajdari. "Kam shprehur të kursimit, sidomos kohën e fundit monedhat metalike i fus në shishe të plastikës, sepse standardi nuk na lejon më shumë", tha Meral S. studente. "Është e vështirë të kursehet kur për çdo plan për të ardhmen futesh në kredi, si për të paguar për veturë apo për të siguruar kulm mbi kokë. E kam me

rëndësi t'ia dalë muajit në fund mos të futem më shumë në borxhe, për të kursyer e kemi harruar atë ndjenjë", tha Muhamet D. Kushtet dhe standardi i Maqedonisë dhe në përgjithësi i rajonit nuk janë në anën tonë, thonë për gazetën KOHA ekonomistët. Jeton Shaqiri, profesor i ekonomisë në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës thotë se qytetarët nga të hyrat e pakta, e kanë të pamundur të mendojnë për kursim. "Aktualisht kushtet nuk janë në favor të vetëdijesimit të qytetarëve për kursim. Niveli i të hyrave mujore nuk lejon as kushte normale për arsye se të hyrat janë të pakta dhe nuk arrijnë të mbulojnë harxhimet e jo më shumë të lejohet kursimi", tha Shaqiri., Besarta Xhoni, magjistre e financave dhe kontabilitetit, mes tjerash thotë se Ballkani në përgjithësi përballet me probleme të tilla, pasi i varfëri gjithmonë paguan më shtrenjtë.


"Kursimi është tema më e ndjeshme e secilit qytetarë. Teorikisht, të ardhurat minus konsumi nxjerrin kursimin. Por jeta reale flet ndryshe. Praktika e thotë që 1+1 nuk bëjnë dy. Mos llogaritja e shpenzimeve variabile e sjellin njeriun në gjendje që të mos dijë të kursejë konkretisht të menaxhojë me mjetet e veta financiare. Vetëdija njerëzore është shumë e ulët në këtë aspekt në vendin tonë.

Ballkani në përgjithësi përballet me probleme të tilla, pasi i varfëri gjithmonë paguan më shtrenjtë. Afatizimi i mjeteve nëpër institucione financiare detyrimisht të obligon të kursesh, por fatkeqësisht - për shkak të kredibilitetit të ulët nëpër institucione financiare, kjo gjë në vendin tonë nuk praktikohet!", tha Xhoni. Ndryshe, ditë më parë, të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikës për vitin 2016 treguan se në Maqedoni, 21.8 për qind apo 450.000 qytetarë janë të varfër. Nga numri i përgjithshëm i të varfërve, 9 për qind janë të punësuar, ndërsa 7.1 për qind janë pensionistë. Në vitin 2016, shkalla e varfërisë tek burrat ka qenë 22.2 për qind, ndërsa tek gratë 21.5 për qind. Bazë e llogaritjeve të varfërisë janë të ardhurat, ndërsa pragu i varfërisë është definuar në 60 për qind nga të ardhurat ekuivalente mediale. Dita botërore e kursimit, e cila festohet si kujtim i Kongresit të parë ndërkombëtar të kursimoreve të mbajtur në këtë ditë në vitin 1924 në Milano. Pjesëmarrësit në Kongres janë dakorduar se kursimi është shumë i nevojshëm për zhvillimin e njerëzimit, si dhe për ringjalljen e luftës kundër shfrenimit. Ky vendim është miratuar nga ana e 350 delegatëve nga 27 vende, të cilët paraqisnin rreth njëqind milionë kursimorë. (A.Xh)

AKE me anketë të re

# Në celular më shpesh në Viber dhe Fejsbuk

Pjesa më e madhe nga shfrytëzuesit e internetit përmes celularëve, 96.3 për qind, shfrytëzojnë aplikime për komunikime. Më i shfrytëzuar është "Viberi" (92.2 për qind), pas së cilit vijojnë "Fejsbuk Mesenxheri" (84.4 për qind), Skajpi (43.5 për qind) dhe "Uats ap"-i (25.5 për qind). Më shumë se gjysma e të anketuarve i shfrytëzojnë këto aplikacione për komunikim përmes porosive tekstuale (73.1 për qind) dhe përmes bisedave (71.6 për qind) çdo ditë



jekin trendin e rritjes dhe këtë vit e rritën shumicën e tyre me 72.1 për qind, theksohet në rezultatet nga hulumtimi i mendimit publik për tregun e komunikimeve elektronike në Maqedoni dhe Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE). Anketat, e zbatuar në territorin e Maqedonisë në mostër të rastësishme përfaqësues prej 1100 të anketuarve në periudhën prej orës 19 deri më 29 maj të këtij viti, tregojnë se numri i përdorimit të shfrytëzuesve është ulur në 28.8 për

qind, ndërsa shfrytëzuesit e telefonave celular gjithnjë e më shpesh telefonojnë prej celulari në fiks kur kanë nevojë (37 për qind). Numri i shfrytëzuesve të internetit në telefonat celular përmes operatorëve celular është në rritje konstante nga viti i kaluar dhe tani arrin 58.6 për qind. Numri më i madh i shfrytëzuesve janë më të rinj se 40 vjet, por gjithashtu shënohet rritje edhe te personat nën moshën 50 vjeçare. Pjesa më e madhe nga shfrytëzuesit e internetit

## TELEFON FIKS SHFRYTËZOJNË 51.5 PËR QIND TË AMVISËRIE

Është ndalur trendi i rënies së shfrytëzuesve të telefonisë fikse, e cila edhe më tutje mbetet shërbimi më pak i shfrytëzuar komunikativ. Në anketën e Agjencisë për komunikime elektronike (AKE) për tregun e komunikimeve elektronike, zbatuar prej 19 deri më 29 maj të këtij viti në bazë të 1.100 të anketuarve, vërehet stagnim i numrit të amvisërive të cilat posedojnë linjë fikse të telefonisë (51.5 për qind), që do të thotë se është ndalur trendi i rënies, i filluar nga viti 2014. Shumica e shfrytëzuesve të telefonisë fikse, transmeton MIA, janë postpejd (93.6 për qind), që është rritje në krahasim me vitin e kaluar. Telekomit i Maqedonisë edhe më tej e përfaqëson pjesën më të madhe të tregut me 58,5 për qind, edhe pse shënon trend të rënies së vogël për dallim nga viti 2013 deri më tani. Numri më i madh i shfrytëzuesve thanë se asnjëherë (39,4 për qind) apo në raste të veçanta (35 për qind) nuk e shfrytëzojnë telefonin fiks për të telefonuar në telefon celular. Numri i shfrytëzuesve të cilët telefonojnë nga telefoni fiks në telefon fiks është 55,8 për qind, që është stabilizim nga trendi i rënies së filluar prej vitit 2013.

përmes celularëve, 96.3 për qind, shfrytëzojnë aplikime për komunikime. Më i shfrytëzuar është "Viberi" (92.2 për qind), pas së cilit vijojnë "Fejsbuk Mesenxheri" (84.4 për qind), Skajpi (43.5 për qind) dhe "Uats ap"-i (25.5 për qind). Më shumë se gjysma e të anketuarve i shfrytëzojnë këto aplikacione për komunikim përmes porosive tekstuale (73.1 për qind) dhe përmes bisedave (71.6 për qind) çdo ditë. Në anketë, shumica e të anketuarve nuk shfrytë-

zojnë internet përmes telefonave celular (51.7 për qind) kanë theksuar se nuk ka nevojë për internet celular, 37.4 për qind nuk kanë aparat përkatës telefonik, ndërsa 23.8 për qind nuk e di si ta shfrytëzojnë. Nëse paraqitet operator i ri i telefonisë celulare, që t'i tërheqë shfrytëzuesit, fillimisht duhet të ofrohen çmime më të ulëta të bisedave (83.4 për qind), çmime më të ulëta për internet celular (37.6 për qind) dhe cilësi më e mirë e shërbimeve të folurit (31.8

për qind). Interneti më i shpejtë celular do të ishte shkak për zgjedhjen e operatorit të ri celular për 30.6 për qind nga të anketuarit, ndërsa për 25 për qind çmime të volitshme të aparateve celular, ndërsa 10 për qind kërkojnë aparatet më moderne telefonike, ndërsa për 9.6 për qind janë më të rëndësishme çmimet më të ulëta SMS/MMS dhe të dhëna data. Vitin e kaluar 3.5 për qind nga shfrytëzuesit e telefonisë celulare e kanë ndryshuar operatorin.

Koha | Fisnik PASHOLLI

Shkup 31 tetor - Numri i shfrytëzuesve të telefonisë celulare në Maqedoni këtë vit për dallim nga viti i kaluar shënon rritje të vogël dhe arrin 95.2 për qind. Shfrytëzuesit e telefonave të mençur e nd-





Një vit nga mbyllja e Jugohromit

# Pollogu me ajër të pastër

**Vendimi për mbylljen e Kombinatit Jugohrom në Jegunoc, krahas implikimeve tjera, po ashtu sipas raportimeve të atëhershme, kishte shkaktuar edhe mjaft tensione brenda partnerëve të koalicionit mes BDI-së dhe VMRO-DPMNE-së, pasi që ministrat e VMRO-DPMNE-së të udhëhequr nga ish kryeministri teknik, Emil Dimitriev, kishin qenë kategorik kundër mbylljes**



dimrit. Vendimi për mbylljen e Kombinatit Jugohrom në Jegunoc, krahas implikimeve tjera, po ashtu sipas raportimeve të atëhershme, kishte shkaktuar edhe mjaft tensione brenda partnerëve të koalicionit mes BDI-së dhe VMRO-DPMNE-së, pasi që ministrat e VMRO-DPMNE-së të udhëhequr nga ish kryeministri teknik, Emil Dimitriev, kishin qenë kategorik kundër mbylljes me arsyetimet se shumë punëtorë do të ngelin pa punë, ndërsa BDI-ja kishte insistuar që të mbyllet për shkak të implikimeve në shëndetin e 200 mijë banorëve të Pollogut. Në ndërkohë, kryeministri aktual, Zoran Zaev, gjatë një tubimi parazgjedhor në këtë komunë, ka premtuar se në fillim të vitit të ardhshëm fabrika do të rifillojë të punojë, kurse deri atëherë të vendosen filtrat. Nga ana tjetër, menaxhmenti i kësaj fabrike, përveç hedhjes së bazamentit për ndërtimin e stacionit të filtrave, nuk ka lëvizur asnjë milimetër për të ndërtuar të njëjtin. Por, reagimet e fundit të shoqatave ambientaliste janë se nëse rifillon me punë kjo fabrikë pa filtra, kundërpërgjigja do të jetë e madhe me protesta masive.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 31 tetor - Pikërisht një vit më parë, me vendim të inspektoratit të Ambientit Jetësor të Ministrisë së Ekologjisë, është mbyllur Fabrika Jugohrom. Kjo fabrikë ishte cilësuar si ndotësi kryesor në rajonin e Pollogut. Mbylljes i kishin paraprirë shumë protesta masive nga ana e shoqatave joqeveritare, të kryesuara nga Eco Guerilla. Protestat kishin pasur për qëllim që ky kombinat të ndërprejë punën derisa të vendosen filtra, por drej-

toria dhe menaxhmenti kishin hezituuar për shumë vite të fillonin të vendosnin filtrat në këtë fabrikë, që ndodhet në territorin e Komunës së Jegunocit, vetëm rreth 20 kilometra larg nga qyteti i Tetovës.

Pothuajse vite me radhë protestat dhe thirrjet e qytetarëve të Tetovës së bashku edhe me ambientalistët dhe opinionin e gjerë kishin hasur në vesh të shurdhër, si nga ana e Qeverisë po ashtu edhe nga ana e menaxhmentit të fabrikës. Qeveria e kaluar disa herë me radhë

i kishte dhënë afate shtesë këtij kombinati që të vendos filtra, por asnjëherë duke e mbyllur këtë fabrikë që, sipas ambientalistëve, ishte fajtorja kryesorja për ndotjen kancerogjene në Pollog. Më 1 nëntor të vitit të kaluar Inspektorati i Ambientit Jetësor, vendosi që të mbyllë këtë kombinat. "Inspektorati shtetërorë vizitoi kombinatin Jugohrom në bazë të procedurave ligjore për përbushjen e obligimeve ligjore, me ç'rast dorëzoi vendimin për mbylljen e kësaj fabrike, gjegjësisht

ndërprerjen e aktiviteteve që i ndërmer ky kombinat", tha para një viti Isni Taçi, inspektor në Ministrinë e Ekologjisë.

Përderisa ky vendim u mirëprit nga ana e ambientalistëve, të cilët kërkuan që kjo fabrikë të mos punojë derisa të vendos filtra, nga ana tjetër, pikërisht kjo shkaktoi revoltë të të punësuarit, të cilët filluan me kontra protesta, duke i dalë në mbrojtje fabrikës, duke kërkuar matje ku do të saktësohej se prej nga vjen ndotja, duke mohuar kategorikisht se shkak-

tarë i ndotjes është vetëm kjo fabrikë. Madje, punëtorët dhe sindikata u ankuan se mbi 700 punëtorë të kësaj fabrike, kryesisht banorë të Komunës së Jegunocit dhe Tearcës, kanë ngelur pa asnjë të ardhur për të mbajtur familjet. Mirëpo, brenda këtij viti, Tetova, së bashku me vendbanimet e rrethinës, ka ajër më të pastër, kurse Tetova në këtë kohë e humbi primatin si qyteti më i ndotur në Evropë, primat të cilin e kishte mbajtur shumë vite me radhë, sidomos në periudhën e

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore

Maqedonia është nga vendet e rralla në botë që nuk ka regjistrim të popullsisë. Pikërisht për këtë kanë reaguar edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore, prej nga theksojnë se nuk ka asnjë të dhënë që do të mund të shfrytëzonin investitorët potencial që dëshirojnë të investojnë në Maqedoni

Tetovë, 31 tetor - Që nga viti 2002 Maqedonia nuk ka regjistrim të popullsisë. Tentimi për regjistrim në vitin 2011 dështoi dhe tashmë Maqedonia është nga vendet e rralla në botë që nuk ka regjistrim të popullsisë. Pikërisht për këtë kanë reaguar edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore, prej nga theksojnë se nuk ka asnjë të dhënë që do të mund të shfrytëzonin investitorët potencial që dëshirojnë të investojnë në Maqedoni.

"Regjistrimi i popullatës edhe më tej është një nga çështjet më të hidhura. Nebuloze janë arsyet pse nuk është zbatuar. Por, ta lëmë atë anash. Jozyrtarisht, shumë nga kuadrot e reja ikin, e nuk



dimë saktë sa, as nuk dimë sa realisht banorë dhe amvisëri kemi. Regjistrimi do të japë një pasqyrë të qartë për atë se çfarë drejtimi ekonomik do të kapim si shtet, ku më së shumti do të përqendrohemi, në cilat sfera, kush do të jetë targeti kryesor për ne", thonë nga

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore. Akademiku Abdylmenaf Bexheti thotë se në një të ardhme të afërt regjistrimi i popullsisë mund të jetë një nga kushtet kryesore për fillim të negociatave me Bashkimin Evropian. "Në anën tjetër, a do të jetë regjistrimi i popullsisë së

Maqedonisë në çështjet e kritereve të ashtuquajtura kushtëzuese për përafrim apo fillim të negociatave me BE-në, besoj se është diçka për të cilën specifikisht vendi duhet që të përkushtohet jo pse ia imponojnë si kusht dikush tjetër, pra në këtë rast Brukseli, por është një

diçka pa të cilën nuk bëhet për të cilën domosdoshmërisht shteti sa më parë duhet të gjej mënyrë që ta bëjë atë. Prandaj, pa marrë parasysh a do të jetë kusht apo jo regjistrimi i popullsisë, na duhet më shumë se sa një aspekt i të qenit vetëm kusht", thotë akademiku Bexheti.

Ai më tej nënvizon se kjo do të ketë impakt negative edhe në Ekonominë vendore. "Mungesa e regjistrimit dhe mungesa e bazës së të dhënave që dalin nga një regjistrim gjithëpërfshirës i popullsisë, banesave, pasurisë dhe strukturës të popullsisë nënkupton një mungesë të madhe që paraqet hendikep për të gjitha aspektet e planifikimit shoqëror, ekonomik, kulturor, arsimor, shëndetësor, dhe kështu me radhë, pra imagjinoni në bazë të çfarë të dhënash mund të diza-

jnohen politikat e caktuara publike nëse nuk ka një fundament dhe një bazë të caktuar të regjistrimit", theksoi Bexheti, i cili në vitin 2011 dha dorëheqje nga detyra e nënkryetarit të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit. Për nevojën e regjistrimit flasin edhe negociatat e fundit të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri Perëndimore me kompaninë kineze që dëshirojnë të investojnë në Maqedoni, por kanë frikë nëse do të ketë kuadro të mjaftueshme që të punësojë.

Për arsye se nuk ka regjistrim, nuk e dimë se sa fuqi punëtore kemi në dispozicion. Flasin për kuadro të rinj. Mund të themi përafërsisht, por na duhen të dhëna konkrete, numra që do të pasqyrojnë gjendjen faktike", thonë nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore. (U.H.)





**Marshi i Pavarësisë (Istiklal Marshi), i shkruar nga Mehmed Akifi, u lexua në Kuvendin e Madh të Kombit (Parlamenti Turk) më 1 mars 1921, dhe po më 21 mars 1921 u pranua dhe u votua zyrtarisht**

Profile: Mehmet Akif Ersoj

# Shqiptari që krijoi himnin kombëtar turk

Mehmed Akif Ersoj, me prejardhje shqiptare nga Shushica e Pejës, është një figurë e shquar në Turqi, një personalitet i dalluar në shumë fusha: besimtar, dijetar, akademik, poet, shkrimtar, politikan, pedagog dhe deputet. Ai njihet në Turqi si autor i Himnit Shtetëror dhe për këtë admirohet si një shenjtor...

Ndërsa në Shqipëri njihet pak, dhe për këtë arsye Fondacioni Alternativa e së Ardhmes "Alsar" dhe Bashkësia e Sindikatave Arsimore "Egëtim-Bir-Sen", në mars të vitit të kaluar kanë gjetur mënyrën për ta sjellë atë në shqip, me një vepër voluminoze dhe një seminar dy-ditor të organizuar në Tiranë ku referuan profesorë, akademikë, studiues e historianë të mirënjohur nga rajoni i Ballkanit dhe Turqia.

## Historia e himnit turk


Në vitin 1921, me kërkesën e ushtarakëve, Ministria e Kulturës u dha gazetave të datës 7 nëntor një njoftim, ku bëhej e ditur se: "Shpallet konkurs për Marshin e Pavarësisë dhe se për fituesin e tekstit dhe melodisë do të jepej nga një shpërblim prej 500 lirash". Në qendrën e konkursit u paraqitën mbi shtatëqind tekste, por, me gjithë këtë, komisioni vlerësues nuk pranoi asnjë poezi, sepse asnjë prej tyre nuk plotësonte kriteret e kërkuara, që të zgjonte ndikimet e dëshiruara. Atëherë,

Hamidullah Suphiu, që ishte ministër i Kulturës, me gjithë komisionin vlerësues, iu drejtuan Mehmed Akifit, që të shkruajë poezinë. Mehmed Akif Ersoj, iu përgjigj ministrit se poezinë do ta bënte, por se ai nuk shkruante për para. Kur ministri me bashkëpunëtorët i premtoi se "nuk do t'i jepnin shpërblimin edhe nëse do të fitonte, ai me këtë kusht, shkroi tekstin.

Marshi i Pavarësisë (Istiklal Marshi), i shkruar nga Mehmed Akifi, u lexua në Kuvendin e Madh të Kombit (Parlamenti Turk) më 1 mars 1921, dhe po më 21 mars 1921 u pranua dhe u votua zyrtarisht. Kur zyra e llogarisë e Kuvendit të Madh e ftoi të merrte shpërblimin, Mehmed Akifi i mori pesëqind lirë, por menjëherë ua shpërndau fukarenjve e jetimëve përmes Institucionit Bamirës "Daru'l Mesai".

## Krijimtaria letraro-artistike

Mehmed Akif Ersoj, përveç shërbimeve që bëri në Turqi, siç tregohet në jetëshkrimin e tij, është marrë edhe me krijimtari letrare dhe artistike duke lënë si trashëgim një thesar të tërë, një pasuri që mund të ndahet në dy kategori: Veprat e shkruara në vargje ose veprat poetike dhe veprat e shkruara në prozë. Veprat e shkruara në vargje janë të përm-



bledhura me një emërtim të përgjithshëm "Safahat" ose "Fletët". Kjo është një përmbledhje librash poetike në shtatë shtatë libra me emërtime të veçanta: Safahat, përmbledhje me 44 poezi; me 3084 vargje;

Në Katedrën e Sulejmanijës, 1 poezi, me 1002 vargje; Zëri i së Vërtetës, 10 poezi, 482 vargje; Në Katedrën e Fatihut, 1 poezi, 1692 vargje; Kujtimet, 10 poezi, 1314 vargje; Asimi, 1 poezi,

2292 vargje; Hijet, 41 poezi, 1374 vargje etj.

Në këto vepra, thënë me pak fjalë, trajtohen çështje njerëzore, shoqërore dhe shprehjet mahnitja, admirimi, ndaj forcës qetësuese, ngushël-

luese të besimit dhe ndaj të fshehtave të botës hyjnore. Përveç shtatë veprave me poezi, të cilat kanë mbi 10.000 vargje, Mehmed Akifi ka botuar edhe gjashtë vepra në prozë, titujt e të cilave janë: Tefsiret ose Komentet e Kur'anit; Vazët apo predikimet; Artikujt; Përkthimet; Veprat ose shkrimet tjera; Letrat.

Ndonëse i lindur në Stamboll, Turqi, ai ka pohuar me krenari se është shqiptar. Mehmed Akif Ersoj në shumë shkrime përmend Shqipërinë, Kosovën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën.

Është e njohur poezia me titull "A s'e njeh? Kosova"! Ndërsa, në një poezi tjetër, ai shkruan: "E mos u përcani mes vete, / e të dobësoheni e ta humbni fuqinë.../ A ende të përfytemi? / "Kur individët të thonë "unë e "ti", bashkimi prishet / Dhe atëherë për kombet kijameti fillon! / Zbrit në të shkuarën dhe shëtit / Të gjitha kohët e shkatërrimeve / Do të shohësh se ligji i Allahut nuk ndryshon...!

Mehmed Akif Ersoj ishte burrë edhe i idesë, edhe i shoqërisë. Ishte i vendosur, besnik, modest, serioz, i guximshëm, trim e i qëndrueshëm... Thënë shkurt, ai bindjet e tij i kishte ndërtuar mbi një formulë të thjeshtë me një fjali: "Fe, moral, atd-hedashuri, dituri..."

## KUSH ISHTE MEHMET AKIF ERSOJ

Lindi në Stamboll më 20 dhjetor 1873 në një familje besimtare, intelektuale. Babai i tij ishte Tahir Efendi, një myderriz i njohur në Medresesë e njohur "Fatih" të Stambollit. Tahiri kishte lindur në Shushicë të Pejës. Mehmed Akif Ersoj, mësimet fillestare i kreu në "Iptidajin", "Ruzhdien" e "Idadijen". Në vitin 1893 diplomohet në Fakultetin e Veterinarisë, ku ishte shpallur studenti më i mirë. Krahas mësimëve, studimeve, Mehmed Akifi në Medresën "Tabhane" të Stambollit mësonte gjuhën arabe. Mësoi përmendësh Kur'anin e Shenjtë, e mori titullin Hafiz i Kur'anit. Në vitin 1894 filloi punën si inspektor i veterinarisë, ku iu dha rasti të shëtisë e vizitojë shumë qytete e zona të ndryshme të shtetit në Anadoll, Arabi, Rumeli dhe në Shqipëri. Në vitin 1918 u emërua kryesekretar i Këshillit të Lartë Islam (Daru'l Hikmeti'l Islamiyye). Në qershor të vitit 1920 u zgjodh deputet i Burdurit dhe u pranua nga Kuvendi (Mexhlisi). Në shtator të vitit 1922, Mehmed Akifi u zgjodh anëtar i Akademisë së Studimeve Islame. Prej vitit 1925 deri më 1936, Mehmed Akifi ka jetuar e punuar në Kajro, ku shërbeu si profesor i turqishtes në Universitetin e Egjiptit. Ndërroi jetë më 27 dhjetor 1936 në Stamboll, në moshën 63-vjeçare. Mbahet mend se është varrosur me nderime të mëdha ku merrnin pjesë mijëra studentë e besimtarë, të cilët, në shenjë nderimi, e mbajtën për orë të tëra në krah deri sa e çuan në Varrezat e Dëshmorëve në Edirne Kapi.



## Deklarata për Pavarësi e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

# Çfarë shkruante revista britanike e vitit 1880

Revista ndërkom-bëtare britanike, nëpërmjet korrespondentit të saj në Lindje, Pierre Guerraz, - (Correspondance d'Orient - Constantinople, 14 maj 1880) - trajton çështjen shqiptare, më saktësisht dëshirën e bashkombasve tanë për liri. Shkrimi, i publikuar në gjuhën frënge, vë në dukje fillimisht interesat dhe strategjinë italiane - në konkurrencë me Austrinë e cila kishte marrë asokohe Bosnjën dhe Hercegovinën - për të sunduar trojet shqiptare. Pavarësisht qëllimeve italiane, revista shkruan se shpallja përfundimtare e pavarësisë shqiptare nuk mund të shmangej më, sepse dëshira për liri ekzistonte prej kohësh.

A la suite de ces actes d'indépendance, les Albanais avaient publié la proclamation suivante, qui ne laissait planer aucun doute sur leurs intentions ultérieures :  
« Albanais ! l'Europe a créé une principauté pour les Bulgares. La Bosnie et l'Herzégovine ont été livrées à l'Autriche. La Serbie et le Monténégro ont obtenu l'indépendance et une augmentation de territoire, la Roumélie son autonomie; et nous, qu'avons-nous reçu? Nous, les Albanais, nous ne sommes pas des immigrants, mais les habitants primitifs de ce pays; nous avons été libres et indépendants plusieurs siècles auparavant et nous pouvons justement revendiquer le droit de former un Etat. La Thessalie, l'Épire, l'Albanie proprement dite, voilà le patrimoine de la nation albanaise, qui compte trois millions d'âmes. Notre patrie doit être libre et indépendante et gouvernée par un prince de notre choix. C'est là ce que nous voulons, ou sinon la mort. Il faut en finir avec cette honteuse existence. »

Madje, ajo shkruan se Lidhja Shqiptare (Bëhet fjalë për Lidhjen e Prizrenit, megjithëse re-

voftë edhe një pjesë të vogël toke Malit të Zi.

Gjithashtu, Lidhja kishte marrë vendimin të punësonte vetëm shqiptarë në funksionet administrative dhe juridike. Si arsye, ajo kishte pushuar katër funksionarë të lartë turq, të cilët ia dërgoi Muktar Pashës. Ky i fundit nuk guxoi të ndërhyjë në favor të bashkëkombësve të tij dhe si rrjedhim i riadhesoi.

Në vijim të këtyre veprimeve për pavarësi, Shqiptarët publikuan thirrjen patriotike, e cila nuk lë asnjë dyshim mbi qëllimet e mëparshme për liri: "Shqiptarë! Evropa ka krijuar një principatë për Bullgarët. Bosnja dhe Hercegovina i janë dorëzuar Austrisë. Serbia

dhe Mali i Zi kanë fituar pavarësinë dhe disa terri-tore më shumë, ndërsa Rumelia autonominë; po ne, çfarë kemi marrë? Ne, Shqiptarët, ne nuk jemi imigrantë, por banorët e hershëm të këtij vendi; ne kemi qenë të lirë e të pavarur disa shekuj më parë dhe ne mund të pretendojmë me plot fjalën të drejtën për të krijuar një Shtet. Thesalia, Epiri, Shqipëria aktuale, ja pra trashëgimia e kombit shqiptar, i cili numëron tri milion shpirtra. Atd-heu ynë duhet të jetë i lirë, i pavarur dhe i qeverisur nga një princ i zgjedhur nga ne.

Pra, këtë duam ne, ose në të kundërt vdekjen. Duhet të marrë fund kjo ekzistencë e turpshme".





Në librin e saj studimor "Letërsi e hershme shqiptare", studiuesja prof. dr. Fatbardha Hoxha, jep detaje biografike të disa prej figurave shqiptare që kontribuan për Rilindjen Evropiane


# Shqiptarët që bënë bujë gjatë Rilindjes Evropiane

Rilindja Evropiane është një nga periudhat më të rëndësishme të artit, kulturës, shkencës dhe letërsisë botërore. Me fillimin në Itali, ajo u shtri në të gjithë Evropën, ndonëse në periudha të ndryshme historike dhe në kushte të pabarabarta gjeo-politike.

Në këtë periudhë, si kontributorë në Rilindje ishin edhe disa figura të shquara të lindura ose me origjinë nga trojet arbërore. Në librin e saj studimor "Letërsi e hershme shqiptare", studiuesja prof. dr. Fatbardha Hoxha, jep detaje biografike të disa prej këtyre figurave.

I pari në këtë plejadë siç e quan prof. Fatbardha para studentëve të saj në Universitetin "Luigi Gurakuqi" është Gjon Gazulli. Ndonëse ai nuk pati kontribut të drejtpërdrejtë në letërsi, dha një ndihmesë të madhe në fusha të tjera të Rilindjes, jo shumë të rrahura si historia, gjeografia dhe astronomia. Ishte i pari që nxori disa dorëshkrime të Ptolemeut të cilat i deshifroi.

MARTIN SEGONI i njohur në Shqipëri shumë vonë, rreth viteve '70. Ai njihet si i pari shkrimtar i letërsisë tonë dhe pasohet denjësisht nga Beçikemi dhe Barleti. Shumë i njohur nga ky shkrimtar është një ndër tregimet më të hershme të shkruar për Heroin tonë kombëtar: "Tregim mbi Gjergj Kastri-



otin".

NIKOLLË LEONIK TOMELO është bërë i njohur në lëvizjen humaniste të Rilindjes si një nga filozofët dhe dijetarët më të shquar të shekullit XVI. Ai lindi në Venedik, por prindërit ishin të shpërngulur aty jo shumë kohë më parë nga Durrësi. Ai

studioi në Universitetin e Padovas ku më pas u emërua si profesor dhe rektor po aty. Ishte profesor edhe i Nikolla Kopernikut. Ai ishte gjithashtu edhe poet dhe si i tillë, të gjitha poezitë i kishte me baza filozofike. Ai shkruan: "E mrekullitë e keqkuptuara dobësojnë karakterin/ pakë-

sojnë aftësinë hyjnore të shpirtit tonë."

MIKEL MARULI është një ndër figurat më të njohura dhe më tërheqëse në gjithë Panteonin e Rilindjes Evropiane. Ai, mbi të gjitha ishte poet, por si çdo figurë e asaj periudhe nuk mund të shihet i ndarë nga filozofia dhe pedagogjia. Vepra poetike dhe shkencore e Marulit është relativisht e gjerë dhe studimi i saj ka nevojë për konsolidim të disa burimeve, prandaj nuk po merremi me të. Por për të dëshmuar mallin e tij për atdheun, po vendos disa radhë nga epitafi që ai ka gdhendur mbi varrin e të atit, Manilit (të marra nga libri i lartpërmendur):

*E mjerë ka qenë jeta në atdheun tonë të pushtuar*

*Tani po vdes duke qarë për çdo gjë,*

*Po mbetet pikëlluese e mjerë,*

*Ky është fati i gjinisë sonë.*

MARIN BARLETI është arbri më i rëndësishëm mes gjithë arbërve të tjerë që kontribuan në Rilindjen Evropiane. Ai është humanisti më i shquar shqiptar dhe ndër më të shquarit evropian. Ai ishte nga Shkodra dhe në "Histori e Skënderbeut" e pohon qartë këtë kur thotë Shkodra ime. Përkrah kësaj vepre, tjetër vepër me rëndësi shumë të madhe është edhe "Rrethimi i Shkodrës".



## Noli: Pse u largova nga politika?

Më pyesni përse u hoqa nga politika. Çështje e gjatë po me fjalë të shkurtra shkaqet janë këto: mungesa e shokëve, pleqëria, varfëria dhe lodhja. U përpoqa ta ndreq situatën financiare me një fushatë pajtimtarësh për Don Kishotin, por puna mori fund me një deficit prej 800 dollarësh. Mi këtë e sipër u sëmura me dy dollarë në xhep dhe i mbytur në borxhe me të djathtë e me të mëngjër. Aherë i bëra thirrja vatanit për imdat. Më derguan 150 napolona. Bereqat vers. Siç ka thënë Voltaire, Perëndia e ndjeftë: "la fin est triste, la milieu ne vaut pas grande chose e commencement est ridicule!" Kjo qenka jeta e njeriut, edhe e jona ca më keq se e gjithë të tjerëve.

### Citimet e të huajve

# Shqiptarët më të vjetër se sa mendojnë ata!

Maurico Druon, sekretar i Akademisë frënge: "Shqiptarët i përkasin popujve më të vjetër se vet historia. dhe gjyshërit e shqiptarëve merrnin pjesë në luftën e Trojës, të udhëhequr nga Akili (në njërin anë) dhe Hektori (në anën tjetër)".

Nikolla Jorga: "Populli shqiptar së bashku me baskët, janë më të vjetërit në Evropë".

Maximilian Lambert: "Historia e vërtetë e njerëzimit do të jetë e shkruar, vetëm kur ajo do të shkruhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve".

Lamartini: "Ky komb e ky popull nuk merret nëpër këmbë... Kjo është toka e heronjve të të gjithë kohërave... Homeri aty gjeti Akilin, grekët Aleksandrin e Madh, turqit Skënderbeun, njerëz këta të së njëjtës racë, të të njëjtit gjak".

M. Huacunthe Hecquard: "Në asnjë vend të botës femrat nuk janë më të respektuara dhe nuk ushtrojnë një veprimtari më të fuqishme se shqiptaret dhe disa nëna shqiptare kanë përzënë prej shtëpisë bijtë e vet



pasi ata ishin larguar nga fronti i luftës. Ato i kishin kthyer në fushën e betejës".

Lord Bajroni: "Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë një peizazh më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre".

Henry Noel Brailsford: "...Shqiptari 'primitiv', në fakt është 'mbinjeriu' për

të cilin Nietzsche ëndërronte".

Gjusepe Katapangu: "Atlantida e cila është zhdukur para 12.000 vjetësh, ishte tokë e Ilirëve (pellazgëve), të cilët shpëtuuan nga përmbytja e Atlantidës dhe filluan civilizimet e reja në të gjitha kontinentet, sidomos në Evropë, Afrikë dhe Azi të vogël!".

Agostino Ribeco: "Te drejtat mijëvjeçare të

shqiptarëve, etnografike dhe gjeografike, shtrihen prej kohërave të vjetra në Iliri, Maqedoni dhe Thesali".

Braisllav Nusic: "Shqiptarët janë autoktonë, të cilët gjatë të gjitha dyndjeve të popujve, e ruajtën tipin dhe karakterin e vet në mënyrë të theksuar. Ata u bënë ballë sulmeve të romakëve, mësymjeve të dendura të sllavëve, të cilët ua push-

tuan të gjitha fushat, ultësirat, dhe lumenjtë".

Dushko H. Konstantinov: "Shqiptarët janë banorë më të vjetër të Gadishullit Ballkanik dhe pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve të vjetër, të cilët kishin ndërtuar shtetin më të fuqishëm në Ballkan".

Edvin Jasques: "Ilirët ose shqiptarët, këta bijë të paepur, ishin luftëtar të shqipes, trashëgimtarë të denjë të Akilit, Filipit, Aleksandrit të Madh dhe Piros së Epirit...".

Edvin Pears: "Shqiptarët janë pasardhës të racës më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, gjegjësisht të racës ariane, duke e nxjerrë këtë fjalë nga dy rrënjët e fjalëve shqipe: Ar dhe Anë, që d.m.th. Njerëz të arit të pastër".

Maks Myle: "Emrat e mjaft popujve të njohur rrjedhin nga fjala e vjetër shqipe 'Ar'. Kjo vlen edhe për mjaft vende të botës."

Fanulla Papazoglu: "Dardania është njëra nga krahinat antike të Ballkanit ku popullata autoktone është ruajtur më së miri".

Gos Xhen: "Origjina e shqiptarëve ngjitet deri te koha e pellazgëve dhe kanë origjinë parahelene".

Gustav Majer: "Shqiptarët janë Ilir të rinj".

Georg Hahn: "Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve, ndërsa ilirët janë pasardhës të pellazgëve... Shqiptarët janë stërnipërit e Pellazgëve".

-Haki Pasha: "Po doli në shesh historia e shqiptarëve, Perandorinë Osmane e merr lumi".

Harold Whitehal: "Hieroglifët egjiptiane, të krijuara para 4.000 vjetësh kanë domethënie shqipe".

Henri Braisford: "Në Maqedoni, vetëm shqiptarët janë popull autokton".

Johan Georg Fon Han: "Shqipja rrjedh nga ilirishtja dhe ilirishtja nga pellazgjishtja".

Jovan Cvijiq: "Sllavët e jugut, pas ardhjes në Ballkan, aty gjetën shqiptarët, të cilët nën trysinë e tyre (sllavëve) u tërhoqën jugu dhe në vendet më malore, ku i hasim edhe sot".

Konstandin Pagarigopulos: "Vetëm shqiptaret konsiderohen si pasardhës të racës ilire".



## Z(b)or në Facebook

E urreva Facebookun sepse e ka mekanizuar dhe artificializuar dhimbjen me përjetime që fabrikohen sa hap e mbyll sytë me një klik e bëhen dhunshëm edhe personale ndonëse mund të jesh krejt i huaj ndaj ngjarjes



Beti NJUMA

Pas një dite të kaluar në mal, në paqe me veten dhe natyrën, e ku telefonin e kisha hapur veçse për ndonjë mesazh, buzë mbrëmjes hap Facebookun, dhe lexoj atë që mund të cilësohet ngjarja e ditës, vdekjen e parakohshme e të hidhur të Adelajdës. Përveç empatisë së zakonshme për humbjen e një vaje të re, një kolegeje dhe në fund të fundit një qenieje njerëzore, befaz u përballa me një dhimbje që vërshonte nga të katër anët. Mesazhe pa fund trishtimi, brengje, lamtumire e keqardhjeje më rrëmbyen duke më pushtuar me një ndjesi me të cilën s'kisha asnjë lidhje.

Adela nuk ishte as shoqja e as e njohura ime, por ja që uragani Facebook më mbërtheu padashur në një vorbull dhimbjeje ndaj së cilës nuk mund të jesh indiferente e domosdo solidarizohesh. E urreva Facebookun sepse hyri dhunshëm në ditën time, në jetën time e më bëri të ndihem e brishtë dhe e pambrojtur në këtë dhimbje të shumëfishuar. E urreva Facebookun për pushtetin e pakufishëm që ka fituar mbi të gjithë ne duke përhapur të mirën apo të keqen me një lehtësi të papërballueshme edhe kur të dyja këto duhet t'u përkasin veç të zotëve të tyre.

E urreva Facebookun sepse e ka mekanizuar dhe artificializuar dhimbjen me përjetime që fabrikohen sa hap e mbyll sytë me një klik e bëhen dhunshëm edhe personale ndonëse mund të jesh krejt i huaj ndaj ngjarjes.

Dhe si të gjitha gjërat që urrehen, mendova se nuk do të jetë e largët dita kur do ta braktis perandorinë e dhimbjes komunitare. Them se ka ardhur koha që gëzimet të jenë vetëm të miat, dhimbjet gjithashtu, vetëm të miat, jeta vetëm e imja! Siç shkruante para do kohe prof Gilman Bakalli, Facebooku është tundimi permanent i humbjes së kontrollit.

Tinëzisht, por në mënyrë efikase ama! Ndoshta ka ardhur koha të gjejmë kontrollin e humbur. E po qemë të zotët edhe ta rifitojmë atë!

# Shqetësimi amerikan për modelin serb të “dy karrigeve”



Shaban MURATI

SHBA ndërmorën një hap të fortë diplomatik ndaj Beogradit, duke i drejtuar mesazhin diplomatik dhe publik se Serbia nuk mund të vazhdojë më lojën e dyfishtë të dashurisë edhe me BE, edhe me Rusinë. Në datën 23 tetor në Beograd zëvendësndihmës sekretari amerikan i shtetit për çështjet europiane, Hoyt Bryan Yee, në samitin ekonomik serb në mënyrë publike, dhe në datën 24 tetor në bisedimet zyrtare me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, shprehu me forcë qëndrimin e SHBA se “Serbia nuk mund të rrijë me një këmbë në rrugën drejt BE dhe me këmbën tjetër në aleancën me Rusinë. Serbia nuk mund të rrijë në dy karrige”. Është një mesazh i fortë zyrtar, i cili ka rëndësi të veçantë në raportet dhe në politikën e jashtme të Serbisë ndaj BE, ndaj Rusisë dhe ndaj rajonit.

Hapi i fortë amerikan tregon se Serbia e ka mbushur kupën dhe se ka ardhur koha që Perëndimi t'i vendosë asaj piketa të qarta se në cilin drejtim strategjik do të shkojë.

**Në Ballkan Serbia është shndërruar në një instrument kryesor të ndërhyrjes ruse në punët e brendshme të vendeve të rajonit dhe për shtrirjen e influencës ruse**

Vrapi i qeverisë dhe i diplomacisë serbe drejt aleancës dhe lidhjeve të posaçme me Rusinë ka shtyrë diplomacinë amerikane të gjykojë se tani duhet folur prerazi me Serbinë. Alibia e çuditshme e diplomacisë europiane se duke toleruar Serbinë të lidhet ngushtë me Rusinë e mbajmë atë larg nga Rusia, nuk shërbeu për asgjë, veçse për të mbuluar nivelet e rrezikshme të aleancës serbo-ruse. Në mënyrë të veçantë loja bizantine e Serbisë, duke forcuar aleancën me Rusinë dhe duke u shtrirë sikur po shkon në BE, po merr përmasa dëmprurëse për interesat atlantike dhe europiane në Ballkan.

Përfaqësuesi i departamentit të shtetit i paraqiti zyrtarisht presidentit serb shqetësimet amerikane për bazën ushtarake ruse në Nish dhe për projektin qeveritar serb për t'i akorduar imunitet diplomatik personelit ushtarak rus të

kësaj baze. Ai i kërkoi presidentit serb të njohë Kosovën dhe të ndërpresë mbështetjen për udhëheqjen separatiste dhe proruse të të ashtuquajturës “Serpska Republika”, dhe në mënyrë të veçantë i tërhoqi vëmendjen presidentit serb se Serbia po luan për interesat e Rusisë në rajon. Kaq e fortë ishte ndërhyrja amerikane lidhur me këtë situatë, sa që presidenten serbe në komunikatën e saj të datës 25 tetor për bisedimet Hoyt Brian Yee-Vuçiç theksonte se diplomati amerikan “Shprehu, gjithashtu, shqetësimin për influencën ruse në rajon”.

Është e kuptueshme se loja e rrezikshme serbe e “dy karrigeve” i ka shërbyer dhe i shërben strategjisë dhe interesave të ndërhyrjes dhe ndikimit rus në Ballkan dhe jo europianizimit të Serbisë apo përgatitjes së saj për anëtarësim në BE. Serbia po bëhet gjithnjë e më ruse. Ndërhyrja ruse në rajon po forcohet dhe ajo po merr formë gjithnjë e më të sofistikuar. Është një dinamikë negative për të cilën duhet të bëhen të ndërgjegjshme qeveritë dhe diplomacitë e vendeve të rajonit dhe të vendeve të tjera europiane. Në datën 20 tetor ministri i Jashtëm të 8 shteteve europiane, të Kroacisë, të Suedisë, të Polonisë, të Britanisë së Madhe, të Letonisë, të Lituanisë, të Çekisë dhe të Rumanisë, i dërguan një letër të

përbashkët shëfese së politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të BE, Federicca Mogherini, për të ndërmarrë masa të forta në përbalimin e propagandës dezinformuese ruse në drejtim të vendeve të BE. Në Ballkan Serbia është shndërruar në një instrument kryesor të ndërhyrjes ruse në punët e brendshme të vendeve të rajonit dhe për shtrirjen e influencës ruse. Serbia ka zgjedhur të ndjekë dhe të propagandojë modelin e saj të “dy karrigeve” si një rrugë për të realizuar ambicien e saj të hegjemonisë në rajon. Realisht Serbia ka qëndruar në karrigen ruse, ndërsa karrigen europiane e ka përdorur dhe e përdor si mbulesë për rusizimin e saj politik, ushtarak dhe gjenetik. Është e nevojshme të theksohet këtu fakti se një pjesë të fajit për modelin serb të “dy karrigeve” e ka vetë BE. Ne kemi theksuar vazhdimisht ndër vite në analizat tona se BE ka ndjekur një politikë të standardeve të dyfishta për integrimin në Ballkan. Për Serbinë ka bërë lëshime dhe indulgjenca të pajustifikueshme në procesin e integritetit të saj europian. BE i dha Serbisë MSA-në pa plotësuar kriteret, në një kohë që Beogradi ia hodhi poshtë dhe refuzoi ta nënshkruante. BE nuk ka folur asnjë fjalë për ardhjen në pushtet në Beograd të garniturës së Millosheviçit në pesë vitet e fundit. Nuk ka folur për mbrojtjen që Beogradi po i bën



Xheladin MURATI

Dita Botërore e Mësuesit është konceptuar si një ditë për të reflektuar mbi fuqinë e arsimit, të shkollës e të mësuesit dhe zhvillimin e plot të kapaciteteve kreative të nxënësve. Për këtë arsye UNESCO, bën angazhime konkrete për zhvillimin e aktiviteteve arsimore në nivel ndërkombëtar duke afirmuar vlerat që bartë shkolla e mësuesi në shoqërinë bashkëkohore. Data 5 tetor si Ditë Botërore e mësuesit kremtohet në të gjithë botën me aktivitete të larmishme arsimore. Në të njëjtën kohë, Dita e Mësuesit bëhet edhe me qëllimin për t'i kthyer arsimin funksional e pare të saj – zhvillimin. Shekulli 21 ka caktuar misionet dhe funksionet e reja për shkollën dhe mësuesin, imponon gjithnjë e më shumë

**Shekulli 21 ka caktuar misionet dhe funksionet e reja për shkollën dhe mësuesin, imponon gjithnjë e më shumë koncepte bashkëkohore dhe ka ndërmarrë reforma arsimore, me synim që të gjithë të merren me problemet e kësaj fushe gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të paparashikuara**

koncepte bashkëkohore dhe ka ndërmarrë reforma arsimore, me synim që të gjithë të merren

## Mësuesi, cilësitë dhe kompetencat

me problemet e kësaj fushe gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të paparashikuara. Është shumë interesante dhe inkurajuese për mua që mësuesit në punën e tyre me nxënës po përipiqen të eksperimentojnë me të dyja, formën dhe përmbajtjen. Kapaciteti punues i tyre rritet dhe janë në gjendje të ndjekin trendet didaktike-teknologjike dhe ato zhvillime të shndërrojnë në suksese. Kjo varet kryesisht nga cilësitë dhe kompetencat profesionale, sociale dhe individuale të mësuesve.

Mësuesit i duhet të trajtojnë mjaft probleme të etikës në klasë, zgjidhja e të cilave varet

nga mënyra se si ai i transmeton normat dhe vlerat e shoqërisë demokratike, sa i lidh këto dhe i trajton në një kuadër më të gjerë siç janë familja dhe shoqëria e nxënësve. Mosrespektimi i nxënësit dhe trajtimi i tij si një individ me probleme çon jo vetëm në uljen e dashurisë së tij për lëndën dhe mësimin në përgjithësi, por e bën atë të indisponuar për zhvillimin e problemeve të ndryshme psikologjike, sociale dhe ngritjen e diturive të nxënësve. Sipas pedagogut amerikan Xhersaljd cilësitë që e karakterizojnë mësuesin dhe punën e tij në mënyrë të

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi



krimelëve ndërkombëtarë të luftës dhe promovimin e tyre shtetëror e zyrtar, duke i emëruar profesorë në Akademinë Ushtarake serbe, veprim që Hoyt Yee e kritikoi ashpër publikisht në Beograd. BE nuk ka folur për bazën ushtarake ruse në Nish të përruruar në vitin 2011 dhe as për armatosjen e ethshme që Rusia po i bën Serbisë, ku vetëm në muajin tetor erdhën në Serbi gjashtë avionë gjuajtës MIG-29, dhuratë e Moskës.

Nuk ka folur BE as për manovrat e përbashkëta ushtarake ruso-serbe në Serbi dhe përgatitjen e forcave desante ruse për ndërhyrje në Ballkan. Nuk ka folur për blerjet e raketave ruse nga Serbia dhe as për marrjen e statusit të shtetit vëzhgues prej saj në Asambledën Parlamentare të bllokut ushtarak rus CSTO. Nuk ka folur BE për ndërhyrjen e përbashkët dhe organizimin ruso-serb të përpjekjes për grusht shteti në tetor të vitit të kaluar në Mal të Zi dhe as për ndërhyrjen e përbashkët ruso-serbe në krizën politike maqedonase vitin e kaluar. Serbia nuk pati asnjë sanksion nga Brukseli për refuzimin e saj për t'iu bashkuar sanksioneve europiane ndaj Rusisë. Heshitja e BE përballë shndërrimit të një shteti kandidat, Serbisë, në një instrument të strategjisë antieuroatlantike të Rusisë në Ballkan natyrisht është interpretuar nga Beogradi si leje-kalimi dhe kjo e ka inkurajuar Serbinë në shpejtimin e ritmeve të aleancës së saj me Rusinë. Serbia e mbushi kupën e durimit dhe të kortezi diplomatike të SHBA. Mendimi im është se qëndrimi i fortë i qeverisë amerikane i shprehur nga Hoyt Yee në Beograd mund të lexohet edhe si një vërejtje indirekte për diplomacinë e BE, sidomos për disa segmente të saj, të cilat për arsye të ndryshme janë vetë për politika të buta

ndaj Rusisë, pavarësisht nga kriza ukrainase dhe aneksimi i dhunshëm i Krimesë.

Modeli serb i qëndrimit në "dy karrige" është toleruar tej çdo kufiri nga diplomacia e BE. Por ai është një model shqetësues diplomatik, sepse pranimi i sindromës së "dy karrigeve" do të thotë që të krijosh precedentin për përhapjen e kësaj sindrome.

Nuk është rastësi që modelin e "dy karrigeve" e shohim sot të aplikohet në Hungari, në Sllovaki, në Greqi, në Qipro, etj. Lëvizja e diplomacisë amerikane në Beograd është një lëvizje e duhur dhe pozitive për gjithë rajonin tonë. Ajo demonstroi jo thjesht shqetësimin, por edhe angazhimin e qeverisë të presidentit Trump për të mos lejuar fragmentarizimin e interesave euroatlantike në Ballkan. Në këto situata bëhet akoma më e rëndësishme për Shqipërinë që të kuptojë thelbin e zhvillimeve dhe të mos bëhet pre e lojërave të fshehta bizantine të Serbisë. Derisa SHBA vë në dyshim orientimin evropian të Serbisë, Shqipëria duhet ta ketë dy herë më të madh dëshimin. Shqipëria ka një rol të madh për të lozur në mbrojtje të interesave atlantike dhe europiane në rajonin tonë. Ky rol kërkon që alarmi amerikan për modelin serb të "dy karrigeve" të kthjellojë Tiranën për dinamiken reale të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë. Shteti shqiptar nuk është i imunizuar nga përpjekjet ruse për të neutralizuar Shqipërinë si faktor në rajon. Ka një përputhje interesash strategjike të Rusisë me Serbinë për të mos lënë Shqipërinë dhe Kosovën dhe kombin shqiptar të jenë faktor i interesave perëndimore. Diplomacia ruse dhe serbe janë përpjekur t'i këshillojnë Tiranës dobitë e modelit të "dy karrigeve" dhe të krijojë një marrëdhënie specifike me

Moskën.

Në këtë drejtim synon ta drejtojë politikën shqiptare propaganda dhe influenca ideologjike ruse në Shqipëri. Shenjë e hidhur e influencës së lobit rus është fakti që rrjetet mediatike dhe sociale shqiptare e bojkotuan letrën e 8 ministrave të Jashtëm të vendeve të BE për një kundërvënie ndaj dezinformacionit të propagandës ruse. Është identike me çka ndodhi edhe në 23 nëntor 2016 me rezolutën e Parlamentit Europian për masat ndaj depërtimit të propagandës dhe dezinformacionit të propagandës ruse në vendet e Europës dhe të cilën rrjetet mediatike shqiptare e injoruan. Dëshmi e ndikimit dhe e veprimit të lobit rus në Tiranë ishte ai anti-amerikanizëm rural, që u shfaq nga opozita gjatë krizës politike në pranverën e këtij viti dhe ku u arrit deri sa të thirreshin për ndihmë specialistë rusë të trazirave sociale. Këto janë shenja të qarta të sponsorizimit dhe ndikimit të lobit rus, që synon të krijojë klimën e penetrimit rus në Shqipëri. Rusia po tenton të blejë vetë ose përmes një shteti të tretë dy objekte të rëndësishme në Shqipëri, njeri në mes të Tiranës dhe tjetri në mes të detit.

Përkrashtimet e sponsorizuar shqiptarë të modelit serb të "dy karrigeve" vazhdojnë leksionet për dobitë e investimeve dhe të lidhjeve ruse, duke krijuar tym rreth zyrrave shtetërore, të cilat për fat të keq i mbajnë afër sirenat serbe dhe ruse. Shqipëria duhet të përcaktojë qartë me kë po bashkëpunon: me Serbinë e Rusisë apo me Serbinë e BE.

Serbia reale është ajo për të cilën shpreh shqetësim Amerika dhe këtë nuk duhet ta harrojnë për asnjë moment as qeveria, as diplomacia dhe as partitë politike shqiptare. (gsh)

# 50 vjet



Arben I. KASTRATI

Kosova ishte një dashuri imja që s'më solli asgjë përpos shqetësimeve. U desh shumë dashuri për ta urryer kaq shumë. Dhe janë vetë shqiptarët shkaktarët e kësaj gjendjeje të trazuar shpirtërore.

Besova se tetëmbëdhjetë vitet e fundit të pasluftës në Kosovë qe e pamundur të përmbledheshin në një shkrim të vetëm, por kur e mendova që shumë e thjeshtë, madje përmbledheshin në një fjalë të vetme – TURP.

\*\*\*\*

Unë rroj në vendin që ka mungesë të qartësisë. Unë rroj në vendin me aftësi të kufizuara. Njeriu i vendit e kohës sime, lëngon më shumë nga realiteti se sa dhimbjet e shkaktuara nga sëmundjet. Ndonjëherë, nevojitet ajo që të vetmen kemi – kohën, që t'na i shëroj plagët e shkaktuara nga koha.

Kosova, me statusin e saj gjysmak, as-as (as Europë, as Arabi), ka hyrë në shekullin e dytë të robërisë. Pasi pavarësia ishte – Hyrje në injorancë. Këtë shekull e karakterizon pushtimi nga vetvetja. Dhe në këtë shekull, më shumë se për çdo gjë, Kosova ka nevojë për çmitizues. Dhe instalim të ndëshkueshmërisë.

Ka kohë që alfabeti i gjuhës shqipe është reduktuar në tridhjetë shkronja. Ka kohë që fjalori i gjuhës shqipe është reduktuar në dyqind fjalë. Ka kohë që ne jemi shndërruar i tëri në popull intelektual. Ka kohë që jemi shndërruar në popull ekspertësh, pa klase punëtore. Ka kohë që gjenitë janë ndaluar me ligj. Duhet t'i kundërvihemi varfërisë së kulturës sonë. Nuk mund të lejojmë kthimin e edukimit në privilegj.

\*\*\*\*

Ndërkohë që gjysma e shqiptarëve po vdesin nga infarktet, në pritje të rezultateve finale të ndeshjeve futbolistike nëpër bastore, në Kosovë vetëm këndohet në duete dhe bëhen spote, ma ndryshe. Dhe koalicionet, të panatyrshme. Dhe "krijohet Art"?!!!

Me fjalën Art, sot, abuzohet më shumë se me pushtetin. Fjala art dhe artist, sot, shërben për t'u etiketuar njeriu me ves. Unë nuk kam fjalë ta përshkruaj artin. Por, s'kam fjalë as ta përshkruaj artin – sot. Dhe si i pajalë, në të dyja rastet, më mbetet të hesht dhe të shikoj se ç'po ngjet. Paqartësitë i kam me veten. Kam besuar se i takoj një komuniteti të privilegjuar, siç është vetë arti, por paskam qene i gabuar.

Artistët e keqtrajtuat artin

Njeriu i vendit e kohës sime, lëngon më shumë nga realiteti se sa dhimbjet e shkaktuara nga sëmundjet. Ndonjëherë, nevojitet ajo që të vetmen kemi – kohën, që t'na i shëroj plagët e shkaktuara nga koha

më shumë se politikanët. Le të më falin pak, fare pak artistë të dinjitetshëm dhe meritë për punën që bëjnë, por pjesa tjetër shumicë, janë keqbesitë me të mëdhenj të krijimit. Ata abuzuan me artin. E shëmtuan. E sollën në nivele komprometuese. Në të tilla nivele, që të kesh turp të identifikohesh me ata, si ushtrues të të njëjtë profesioni. Krijimi i tyre i vetëm ishte dhe mbetet – Persiflazha.

Fatkeqësisht, shqiptarët asnjëherë nuk kanë pasur nevojë për marri. Është e vetmja gjë që e kanë pasur me tepri.

\*\*\*\*

Philip Roth thoshte: "Diktatura nuk krijon kryevepra, ajo nxit sulme në zemër, pezmatim të lëkurës, astme, krijon alkoolistë, depresion, dëshitim si dhe sëmundje mendore". Aristoteli thoshte se meritore për krijimin e kryeveprave është talenti që nuk mund të shtypet.

Në këtë vend, ku Aristoteli me siguri është emër fellnesh, Artit dhe Kulturës i bëhet trajtim grotesk. Ose thënë më mire, Arti nuk ekziston më si profesion. Është shndërruar në amatorizëm. Është shndërruar në dhimbje. Ekziston vetëm kultura materialiste.

\*\*\*\*

Artistët sa vete e pakësohen. (Edhe pse sa vete e më shumë "shkollohen" dhe shtohen). Por, fatkeqësisht, dallimi qëndron në ambicie. Të paktë janë ata që duan të krijojnë. Shumica dërmuese dëshirojnë të krijojnë famë.

Prandaj, natyrisht më lind pyetja: a duhet të vazhdoj të krijoj? Për kë të krijoj? A ia vlen të krijosh në standardet e vëna?

Vendi ku rroj, atdhe që nuk ka vend për artistë (edhe pse fare të paktë në numër), si politikisht ashtu edhe artistikisht më ngjanë me dëftimin në vazhdim. Një aktor po interpretonte Hamletin e Shekspirin në një skenë teatri. Interpretimi i aktorit ishte shumë i dobët. Publiku po e vërshejllente në vazhdimësi. Kur i erdhi radha monologut të famshëm të Hamletit: "Të rrosh apo të mos rrosh, kjo është pyetja", publiku filloi ta hidhte më gjësede në skenë. Aktorit që iu lëndua sedra, ndaloi. U kthye nga publiku dhe ju tha: ç'faj kam unë që autori s'di të shkruajë...

Më mbetet ti jetoj vitet e mbetura duke vegjetuar (dinjitetshëm), me dëshirën e madhe që t'mos ju takoj, përjetësisht. Urime ditëlindjen e 50-të, Arben I. Kastrati. (Kult-Plus.com)

parafrazuar janë: Cilësitë njerëzore, si: i kujdesshëm, i hareshëm, i shoqërueshëm etj., cilësitë disiplinore: parimor, korrekt, i drejt etj., cilësi të mësimdhënies si: njohja solide e profesionit, gatishmëri për të ndihmuar nxënësit, mbrojtja e interesave të tyre, ligjërimi në mënyrë të qartë e të rrjedhshme, Cilësi fizike: të jetë tërheqës, i përpiktë, pa defekte fizike etj.

Ky punim fokusohet kryesisht për mësuesit të cilët përipiqen ta motivojnë punën e tyre mbitribute të brendshme, mësues të cilët besojnë se me përmirësimin e mësimdhënies mund të bëjnë që nxënësit të arrijnë rezultate më të larta në përvetësimin e lëndës; mësues të cilët besojnë se kanë një detyrim të vazhdojnë ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies së tyre çdo vit që ata japin mësim, mësues që kanë një dëshirë reale të bëhen mësues me karrierë profesionale më të mirë. Mësuesve u kërkohet rritja e besimit, që të punojnë me më shumë përkushtim sepse mësuesit kanë një ndikim real dhe të madh në edukimin e brezave të rinj, nga sa e mendojnë ato. Sipas mendimit tone mësuesit, arsimtarët dhe profesorët duhet të fokusohen në disa qël-

lime konkrete: 1) Ne kreativitetin dhe inovacionin mësimor, 2) Në zbatimin e metodave dhe teknikave për parashtrimin e pyetjeve, 3) Në aplikimin e metodave për të pakësuar stresin të nxënësit dhe 4) Të bëjnë ndryshimin e teknologjive të punës mësimore.

Mësuesit si bartës të mësimdhënies duhet të tregojnë kreativitet në procesin e organizimit të mësimdhënies dhe mësimin cilësor dhe efikas duke zbatuar mësimin përmes projekteve, projekte për zgjidhjen e problemeve mësimore, mësim duke hulumtuar pavarësisht, mësim nëpërmes dizajnit, mësim nëpërmes zgjidhjes së problemeve e të ngjashme. Programet e mësuesisë synojnë të përgatisin mësues me kompetenca profesionale duke i aftësuar ata për të përdorur njohuritë dhe aftësitë e tyre në veprimtarinë e tyre konkrete profesionale në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Aftësia për të edukuar dhe arsimuar nxënësit ka veçantitë dhe stërholitë e saj. Madhështia fisnike e mësuesit qëndron në realizimin e edukimit me përkushtim dhe sfida. Prandaj thuhet "Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kur-

rë" (Kunfuçi). Kompetencat profesionale të mësuesve përfshijnë tre grupe: Kompetencat kyçe, kompetencat themelore dhe kompetencat speciale për programe të veçanta ose të një lënde mësimore.

Përgjithësisht përgatitja e mësuesve nënkupton përvetësimin e një numri të madh të kompetencave, ndër të cilat i veçojmë si më të rëndësishme: kompetencat kognitive, sociale, personale dhe aplikative.

Një mësues kompetent duhet të jetë i aftë që të përçojë dijet dhe aftësitë e tija profesionale te nxënësit, por njëkohësisht edhe të shërbejë si model dhe shembull i mirëfillt për ta. Kompetencat kyçe të mësuesve përfshijnë: kompetenca për komunikim të informacionit; kompetenca të punës shoqërore; kompetenca gjuhësore; vlerat si individ dhe kompetenca kulturore.

Mësuesi në punën e tij është i shkathët dhe metodik, në marrëdhëniet me nxënësit demokrat idealist, por kurrsesi narcisit. Mësuesi i mëson dhe udhëzon nxënësit të jenë këmbëngulës, të durueshëm dhe të punojnë për të arritur qëllimet e tyre. Është nxënësi ai që duhet të punojë për të pasur sukses.





## Ushtria e Kimit "gati" për luftë

Të nxjerrësh pamje nga jeta e përditshme nga Kореja e Veriut është shumë e vështirë, aq më pak kur bëhet fjalë për ushtrinë e këtij vendi. Por fotografi Pierre Depont ia ka arritur këtij qëllimi dhe imazhet që ai sjell pasqyrojnë një realitet krejt ndryshe nga sa jemi mësuar. Të qeshur para kamerës, duke pirë një cigare, duke u çlodhur me miqtë, apo duke u argëtuar në dasma, lufta duket se është gjeja e fundit që u shkon në mendje ushtarëve të Koresë së Veriut.








## Fisi brazilian që lufton kundër minierave të arit

“Ne do të rezistojmë deri kur i fundit prej nesh të vdesë”, kjo është ajo çfarë thonë anëtarët e një fisi që janë në rrezik zhdukje thonë, teksa planifikojnë të luftojnë kundër kompanive që planifikojnë t’u shkatërrojnë banesat për të gërmuar për ar. Waiapi-t, një fis i lashtë në xhunglën e Amazonës në Brazil, jetojnë në një zonë që shtrihet thuajse sa e gjithë Zvicra. Të rrethuar nga lumenjtë dhe pemët gjigante, anëtarët e fisit veprojnë tërësisht në bazë të ligjeve të tyre, të cilat u përshtaten më tepër periudhës së gurit se sa shekullit të 21-të.







## Tahiri thotë se nuk pret drejtësi!

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri thyen sërisht heshtjen për dosjen "Habilaj", për Audin e famshëm, për raportin tashmë të ndryshuar me Edi Ramën, Partinë Socialiste dhe karrierën politike. Tahiri e nisi rrëfimin e tij Në "TOP stORY" me ndjesinë që pati kur në shtëpi hynë për kontroll prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Ai thotë se e parashikonte këtë. "Ndjesi e sikletshme por jo e paparashikuar për mua, pavarësisht se detyra më ka bërë që të shikojta anën e atyre që hynin në shtëpinë e njerëzve. Kuptova që është procedurë goxha e vështirë, veçanërisht për familjarët. Kam kuptuar të gjithë ata që janë ndërë disi të dhunuar nga policia dhe u kam dhënë më shumë të drejtë atyre që në kohën kur më ankoheshin ndoshta i neglizhoja pak", deklaroi Tahiri.

Tahiri thotë se familja e ka pritur me shumë stres. "Askush nga ata nuk e ka menduar që politika në Shqipëri mund të ketë këto kosto. Kjo e ka kthyer politikën deri diku në një instrument që u është neveritur njerëzve. Ka shkuar përtej limiteve, por mua nuk më është neveritur, sepse mendoj që periudha të tilla për mua, ndoshta shërbejnë që të tjerë pas meje mos e kalojnë padrejtësisht", thotë ai. Deputeti thotë se nuk ka imunitet. "Unë nuk kam imunitet dhe jam, të paktën në dijeninë time, deputeti i vetëm që policia e prokuroria i kanë hyrë për kontroll në shtëpi, edhe pse ka patur raste kur akuzat kanë qenë shumë më reale. Nuk jam fshehur kurrë pas imunitetit dhe nuk kam imunitet. Asnjë deputet nuk ka imunitet. E vetmja gjë që po e konsideroj imunitet është kontrolli i banesës dhe arrestimi me burg", thotë ai. Tahiri deklaroi se asnjëherë nuk ka paragykuar një vendim të gjykatës. "Nuk e kam paragykuar vendimin e gjykatës, mirëpres çdo përpjekje për të hedhur dritë, siç do të hedh unë dritë për të vërtetën. Do të përballem me çdo kosto dhe pasojë të veprimeve të mia për të nxjerrë të vërtetën. Ajo që është keqkuptuar është një pyetje idioe e ca njerëzve që prisja të kishin më shumë logjikë në këtë histori", u shpreh ai. Ka edhe një koment lidhur me përjashtimin nga Partia Socialiste. "Nuk e pashë si gjyq politik përjashtimin nga Partia Socialiste. Edhe sikur një deputet apo drejtues i vetëm në PS, e çon nëpër mend që mund të më bëjë gjyqin politik, unë nuk e pranoj në asnjë rast", u shpreh ai. Të njëjtin qëndrim ruan edhe për Parlamentin, për të cilin thotë se është defaktorizuar. "Është komplet jashtë çdo lloji pritshmërie të qytetarëve. Nuk e shihja të arsyeshme të humbisja asnjë minutë kohë në atë Parlament, sepse betejën e kam me drejtësinë. Deri kur të bëhet drejtësi nuk kam se çfarë të pres. Parlamenti është jo përfaqësues dhe shumë larg pritshmërisë së njerëzve dhe i referohem asaj që ndodh atje çdo të enjte dhe realisht është për turp", u shpreh ai. Ish-ministri i Brendshëm nuk beson se është "barrë për Partinë Socialiste", ndërsa përjashtimin e thotë se e mirëkupton dhe se e ka kërkuar edhe vetë.

"Ai (Hoyt Brian Yee) më tha se nuk mund të prekni tërësinë tokësore të Kosovës, ndërsa unë i thashë, ju keni mundur të prekni tërësinë e Serbisë nëntë vjet më parë. Atëherë vlenin rregulla të tjera. Këtë ia thashë në fytyrë. Ai më bëri të ditur se më përcolli mesazhin e Amerikës. Duhet ta respektosh, nëse nuk e bën... dihen pasojat...", tha presidenti serb

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, tha të hënën se perëndimi nuk do të heqë dorë nga Kosova, ndërsa Beogradi duhet të gjejë një zgjidhje për marrëdhëniet me shqiptarët. Ai i bëri këto komente në një intervistë të paralajmëruar me televizionin serb "Pink" në të cilën foli më hollësisht për takimin e një jave më parë me zyrtarin e lartë amerikan Hoyt Brian Yee, i cili nxiti shumë reagime me qëndrimin se Serbia "nuk mund të ulet në dy karrige", duke ju referuar politikës serbe të ecjes në vijën e ngushtë ndërmjet Perëndimit dhe Rusisë. Presidenti serb tha se takimi me zyrtarin amerikan "nuk ishte i këndshëm, por nuk pati fjalë të rënda". Ai tha se temat kryesore ishin Kosova dhe Rusia. "Ai (Hoyt Brian Yee) më tha se nuk mund të prekni tërësinë tokësore të Kosovës, ndërsa unë i thashë, ju keni mundur të prekni tërësinë e Serbisë nëntë vjet më parë. Atëherë vlenin rregulla të

Vuçiçi bardh bisedën nga takimi me zyrtarin e lartë amerikan

## Hoyt më tha: "Mos e prekni tërësinë e Kosovës"



tjera. Këtë ia thashë në fytyrë. Ai më bëri të ditur se më përcolli mesazhin e Amerikës. Duhet ta respektosh, nëse nuk e bën... dihen pasojat...", tha presidenti serb. Ai tha një nga temat ishte edhe Rusia. "Ajo çfarë po ndodh në Amerikë ka sjellë probleme të reja. Pa faj ne mund të pësojmë. Të gjithë ata që kanë çfarëdo marrëdhëniesh me Rusinë do të pësojnë", tha presidenti serb duke nënvizuar se nuk do të jetë e lehtë të "përballen trysnitë". Shtetet e Bashkuara kanë shprehur shqetësim për një qendër të emergjencave që Rusia menaxhon në qytetin

e Nishit në Serbinë jugore. Disa grupe perëndimore dhe analistë ushtarakë e shohin si një bazë ushtarake të kamufluar që Kremlin e ka ngritur për të mbikëqyruar interesat amerikane në Ballkan. Qendra ruse që u hap fillimisht në vitin 2012, gjendet relativisht pranë forcës paqeruajtëse prej 4 mijë trupash në Kosovë. Pjesë e forcave ndërkombëtare në Kosovë janë edhe 600 ushtarë amerikanë. Moska kërkon që personelit të saj t'i jepet imunitet diplomatik, ndërsa mohon çfarëdo veprimtarie të saj përveç trajtimit të emergjencave. Moska vazh-

don të mbështesë pretendimet serbe mbi Kosovën dhe refuzon sikurse edhe Serbia të njohë pavarësinë e saj të shpallur në shkurt të vitit 2008. Ajo i dorëzoi ditë më parë gjashtë avionë ushtarakë MiG-29 Serbisë, ndërsa pritet që të dërgojë në Beograd edhe 30 tanke T-72 dhe 30 automjete të blinduara. Megjithatë Beogradi është përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhëniesh me Kosovën në shkëmbim të afimit me strukturat evropiane. Presidenti serb tha të hënën se Serbia duhet të provojë të gjejë "një marrëveshje historike me shqiptarët për hir të së ardhmes së fëmijëve". Të hënën Serbia edhe zyrtarisht hapi dialogun e brendshëm për çështjen e Kosovës me takimin e parë të grupit punues për këtë çështje që duhet të bashkërendojë debatet. Në fund të muajit korrik, presidenti serb, Aleksandër Vuçiç, paralajmëroi hapjen e një dialogu të brendshëm në Serbi për, siç tha, zgjidhje të qëndrueshme e afatgjatë të çështjes së Kosovës. Gjatë fundjavës, ai tha se Serbia duhet të lirohet nga mitet dhe "gënjeshtrat se gjithçka në Kosovë është serbe, sikurse edhe nga gënjeshtrat se në Kosovë nuk ka më asgjë serbe".

## Llazareviqi në Akademinë Ushtarake serbe është kundër parimeve të BE-së

Kundër emërimit të të dënuarit për krime lufte, Vladimir Lazareviq, në akademinë ushtarake të Serbisë, më në fund ka reaguar edhe Bashkimi Evropian. Ishte vetë presidenti Hashim Thaçi, ai që kishte ngrehur zërin kundërshtues duke thënë se nuk është çudi për askënd në Serbi, por do të duhej të ishte shqetësuese për çdokënd në BE dhe

shtetet anëtare të saj. Duke aluduar te krimineli Vladimir Lazareviq, presidenti Thaçi kishte thënë se ai do t'i mësojë gjeneratat e ardhshme jo vetëm si t'i urrejnë popujt tjerë jo serbë në Ballkan, por si ta urrejnë edhe NATO-n dhe BE-në. "Ligjëruesi do të kujdeset që dijen dhe përvojën e tij kriminale dhe gjenocidiale ta përçojë tek gjenerata e ardhshme.

Tani mbetet të shihet se si do ta përshpejtojë apo ngadalësojë një veprim i tillë anëtarësimin e Serbisë në BE", kishte thënë Thaçi. Por, pa kaluar shumë ditë nga reagimi i Thaçit kundër Lazareviqit, ka reaguar edhe vetë Bashkimi Evropian. Bashkimi Evropian ka paralajmëruar Serbinë se emërimi i një gjenerali, i cili ka qenë i dënuar për

krime lufte, si ligjërues i një akademie ushtarake, është kundër parimeve të BE-së, ku Serbia synon të anëtarësohet. Zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijančiq, ka thënë përmes një deklarate se blloku pret që "udhëheqësit politikë të respektojnë viktimitat e konflikteve të kaluara dhe të promovojnë sinqerisht pajtimin në Ballkanin Perëndimor".

Analizë e gazetës austriake "Der Standard"

## Serbia dhe Shqipëria luajnë me kufijtë në Ballkan

Gazeta më e madhe austriake "Der Standard" ka publikuar një analizë për Shqipërinë dhe Serbinë. Më konkretisht e përditshmja shkruan për lojën mes Kryeministrit Edi Rama dhe Presidentit Aleksandër Vuçiç për të thithur sa më shumë shtetas të Kosovës që të marrin pasaportën shqiptare apo serbe. Analiza e gazetares Adelheid Woelfl, titullohet "Serbia dhe Shqipëria luajnë me kufijtë e Ballkanit". Kjo e fundit thekson se krahas

presidentit serb, politikën e "fqinjësisë" e ka zbuluar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Ai jo vetëm është përzierë në politikën e partive politike shqiptare në Maqedoni, por ka emëruar edhe katër shqiptarë nga Kosova si zëvendësministra. Dhe, ai paralajmëroi që do të lehtësojë qarkullimin në pikën kufitare me Kosovën", shkruan Der Standard për Ramën. Gazeta e njohur shkruan se e gjithë kjo sipas po ndodh në të njëjtën kohë



kur po zhvillohet dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në analizë theksohet

se marrëveshja historike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të çojë te një

njohje indirekte e Kosovës nga Serbia. Por autorja Woelfl, nënvizon se rivendosja e kufijve në vija etnike, jo e bazuar në integritet territorial, është në interes të dy personave. "Kjo i shërben para së gjithash dy politikanëve: presidentit serb, Aleksandër Vuçiç dhe kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, të cilët prej disa kohëve e paraqesin veten si udhëheqës të të gjithë serbëve dhe shqiptarëve, me qëllim për të arritur një 'pajtim historik', siç e

quan Vuçiç", shkruhet në analizë. Ndërkohë, shkrimi mbyllet dhe me një kritikë për Bashkimin Evropian. Sipas gazetës, shumica e përfaqësuesve të BE-së, kanë lavdëruar dy liderët, që kanë vizituar njëri-tjetrin. "Kjo është shumë e çuditshme, sepse marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë nuk kanë qenë asnjëherë ndonjë problem", shton gazetaria austriake që konsiderohet si një njohëse e mirë e aktualitetit në Ballkan.





U zyrtarizua arratia në Belgjikë e kreut të rrëzuar të qeverisë katalane, Carles Puigdemont. Shumë politikanë katalanë janë larguar nga detyra. Shumica e popullit spanjoll vlerëson strategjinë e përmbajtur të Rajoyt

# Madridi me mençuri në vend të dorës së fortë

Megjithë thirrjet e demonstruesve për "futjen në burg të Puigdemont" në një demonstratë kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë, kreu i qeverisë spanjolle, Mariano Rajoy është treguar i përmbajtur. Ai po zgjedh rrugën e drejtësisë. Ajo duhet të vulosë imazhin e Puigdemont, që për Mariano Rajoy është një mashtrues. Santiago Casal nga lëvizja e majtë "Recortes Cero" thotë se Rajoy nuk po zgjedh rrugën e dhunës kundër atyre që rebelohen "në vend të kësaj ai po përpiqet përmes veprimit të shtetit ligjor para zgjedhjeve rajonale parlamentare më 21 dhjetor, të bëjë për vete ata që ngurrojnë. Po luhet me kartën e fundit, nuk ka më alternativë tjetër për zbatimin e nenit 155". Madje edhe kundërshtarët politikë të Mariano Rajoyt e shohin fajin për këto javë dramatike vetëm tek Puigdemont. Shumë simpatizues të pavarësisë i kanë kthyer tani kurrizin Carles Puigdemont.

## PUIGDEMONT NË BELGIKË

Shumica e popullit spanjoll po e vlerëson strategjinë e përmbajtur të Rajoyt në Katalonjë si një strategji të mençur. Qëllimi është të mos krijohet në asnjë mënyrë përshtypja në opinionin botëror, se shteti spanjoll po



shtyp katalanët, ose siç ishte shprehur Puigdemont disa herë -po i trajton në mënyrë totalitare. Për të gjitha hapat që duhen ndërmarrë në institucionat katalane po përdoret "Guardia Civil". Të hënën u bë e ditur, se prokuroria e Madridit akuzon ish-përfaqësuesit e qeverisë katalane dhe përgjegjësve në parlamentin katalan për rebelim, trazira dhe keqpërdorim të posteve. Këtij lajmi iu shtua se Puigdemont bashkë me gjashtë anëtarë të qeverisë së shfuqizuar, ka kaluar fillimisht me automjet në Francë, pastaj me avion në Belgjikë, ku mund të

bëjë kërkesë për azil politik.

"Ajo që kërkon Rajoy është që rebelët të mbyten në supën që gatuan vetë", shprehet profesori i ekonomisë Javier Morillas në Universitetin Katolik të Madridit, San Pablo Ceu. Askush nuk duhet bërë hero, Rajoy nuk do ndonjë tragjedi.

## "PASTRIM" I INSTITUCIONEVE DERI NË ZGJEDHJET E REJA

Tim Wirth, avokat gjerman në Mallorca shprehet se "qeveria e shfuqizuar katalane i ka injoruar kaq shpesh ligjet, sa që mund të

flitet për atë që Katalonja nuk ndodhej më në një gjendje demokratike, por në atë totalitare." Normalizimi i gjendjes mund të arrihet, nëse qeveria e Madridit vepron, por me kujdes. Deri tani strategjia e Mariano Rajoyt ka pasur sukses. Nuk ka pasur trazira në rrugë, çdo gjë është e qetë. Shumë simpatizantë të kulturës katalane dhe autonomisë për shkak të shkeljeve ligjore të qeverisë së Puigdemont kanë kaluar në anën e Rajoyt, thotë Tim Wirth. Edhe Joanen Cunyat nga lëvizja "Recortes Cero", kundërshtarë të Mariano Rajoyt, shprehet, se "ne e kemi kritikuar Rajoyt në të shkuarën shumë herë, por ai nuk ka faj për situatën e krijuar në Katalonjë." Aktualisht separatistët janë në pakicë në Katalonjë. Deri në zgjedhjet e 21 dhjetorit nuk mbetet shumë kohë për rivendosjen e demokracisë dhe pastrimin e institucioneve nga propaganda e separatistëve. "Shtatë javë deri në zgjedhjet e parakohshme për pastrimin e institucioneve janë një kohë e shkurtër për garantimin e zgjedhjeve të lira e normale", thuhet nga qeveria spanjolle. Madridi pret fitoren e forcave prospanjolle në zgjedhjet e 21 dhjetorit.



## Vritet me plumb në kokë gruaja e çëçenit të akuzuar për komplot për vrasjen e Putinit

Gruaja e një çëçenit të akuzuar nga autoritetet ruse për komplot për vrasjen e presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, është vrarë në një pritë pranë Kievit, konfirmuan autoritetet. Adam Osmayev tha se ai dhe gruaja e tij, Amina Okuyeva, kanë qenë duke udhëtuar me makinë në periferi të kryeqytetit të Ukrainës, kur një automjet tjetër ka nisur t'i ndiqte. Makina është qëlluar dhe Okuyeva është goditur në kokë, i tha Osmayev medias ukrainase. Osmayev, i cili u plagos në sulm, e akuzoi Rusinë për orkestrim të tij. Osmayev është ndaluar nga autoritetet e Ukrainës në qytetin Odesa në shkurt të vitit 2012 dhe është akuzuar për posedim të eksplozivëve, dëmtim të pronës private dhe falsifikim. Më kërkesë të autoriteteve ruse, ai më vonë është akuzuar për komplot për të vrarë Putinin. Gjykatat Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka rekomanduar Ukrainës që të mos e ekstradojë Osmayevin në Rusi dhe Kievi ka vendosur të pezullojë procesin e ekstradimit./REL

## Infektoi 30 gra me HIV, dënohet italian

Valentino Talluto, është akuzuar se ka infektuar me HIV përmes seksit të pambrojtur rreth 30 femra. Ai është dënuar në 25 tetor me 24 vite burg. Italiani Talluto, thuhet se ka pasur marrëdhënie seksuale të pambrojtura me të paktën 53 gra pas diagnozës së tij të HIV në

vitin 2006, ku më e reja prej të cilëve ishte një e mitur, raporton BBC. 33-vjeçari me profesionin kontabilist ka përdorur rrjetet sociale për të gjeta femra dhe më pas kryente marrëdhënie seksuale me ato pa përdorur masa mbrojtëse. Avokatët e Tallutos kishin argumentuar se

veprimet e klientit të tyre ishin "të pakujdesshëm, por jo të qëllimshëm". Edhe pse ka pasur nga ato femra që kanë kërkuar që ai të përdorë prezervativ, Tallutos nuk ka pranuar, duke thënë se ishte alergjik ndaj tyre. Sipas mediave lokale, viktimat kanë kur u lexua dënimi.



## Për 40 ditë, 140 tërmete në Alpet franceze

Rajonin e luginës Maurienne në Alpet franceze, gjatë muajit të fundit, e kanë goditur së paku 140 tërmete. Banorët e Maurienne, që i takon krahinës Savoja në lindje të Francës, javën e fundit janë shqetësuar nga tërmetet e shumta, kryesisht në orët e mbrëmjes.

Organizata për vëzhgimin e tërmetëve "Sismalp" gjatë 40 ditëve të fundit regjistroi 140 tërmete. Tërmeti më i fuqishëm ka qenë me magnitudë 3.8 ballë sipas Rihterit. Ndonëse asnjë nga tërmetet nuk ka shkaktoar dëmtime, dridhja e tokës shkaktoi shqetësim mes banorëve lokalë të cilët u lajmëruan se si të veprojnë në rast të dridhjeve të fuqishme. Sizmologët nuk



janë në gjendje të sqarojnë rritjen e numrit të tërmeteve në rajon, por vendosën pesë sensorë në luginë që të kuptojnë më mirë fenomenin.



## Kongo, miliona njerëz rrezikojnë të vdesin urie

Agjencia e ushqimit nga UN, ka bërë thirrje për ndihmë humanitare për provincën Kasai në Kongo, vend ky i shkatërruar nga konflikti. Sipas të parit të kësaj agjencie, David Beasley, më shumë se tre milionë njerëz janë në rrezik të vdesin nga uria. Tutje ai ka paralajmëruar që qindra mijëra fëmijë mund të vdesin gjatë muajve në vijim, në qoftë se nuk u ofrohet ndihmë. Dhuna në këtë vend kulmoi në gusht të 2016-ës pas vdekjes së liderit lokal gjatë përlëshjeve me forcat e sigurisë. Kjo ka shtyrë zhvendosjen e më shumë se 1.5 milionë njerëzve, shumica prej të cilëve janë fëmijë. Beasley e ka përshkruar situatën në këtë vend si katastrofike.

## Zgjatën sërish procedurat, azilkërkuesve u duhet durim

Në fillim të vitit Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, (BAMF) punoi me ritëm të lartë, por tani ndryshime në personel po sjellin vonesa të reja në trajtimin e kërkesave. Siç njofton gazeta "Nürnberger Nachrichten" Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, BAMF ka arritur të

trajtojë në muaj deri në 50.000 kërkesa të azilit në fillim të vitit. Kjo shifër tani ka rënë në 15.000-18.000 raste. Deri në fund të vitit kjo instancë duhet të trajtojë edhe 44.000 kërkesa për azil, por nga shtatori kësaj shifre i shtohen 52.000 kërkesa të mbetura nga e shkuara si edhe

48.000 kërkesa të reja për azil. Fillimisht ishte menduar që kërkesat e majit të vitit 2016 të kishin marrë fund së trajtuari këtë vit. Ngadalësimi në procesin e trajtimit të kërkesave për azil lidhet me uljen e numrit të vendeve të punës aktualisht në BAMF. Probleme shfaqen edhe në

ofrimin e kurseve të integrit. Në shtator arritën të gjenin një vend në kurset e integritit, 28.000 vetë, që përbën vetëm gjysmën e kërkesave aktuale për kurse integriti. Mesatarisht azilantët duhet të presin gjashtë muaj për të gjetur një vend në kursin e integritit.





Kush ka një kafshë shtëpiake ka marrëdhënie shoqërore më solide dhe sjellje më altruiste. Ndërsa fëmijët që rriten pranë një qeni, janë më të mbrojtur ndaj infeksioneve.

Dokument



## U refuzua nga socialistët dhe hyri në Partinë Naziste

Një historian gjerman, Thomas Weber, professor në universitetin e Aberdeen, deklaroi se ka zbuluar një dokument që dëshmon se Adolf Hitler nuk e nisi karrierën politike me Partinë Nacional Socialiste, njohur edhe si Partia Naziste, por me Partinë Socialiste Gjermane. Ai kërkoi të hynte te kjo e fundit dhe të shkruante në gazetën e saj në vitin 1919, por u injorua dhe nuk u afrua. Sipas këtij historiani, shmangia e këtij "lapsus" të socialistëve mundet të kishte sjellë tjetër kurs historik për botën, pasi ndoshta Hitleri i ri do të kishte pranuar një rol më minor.

"Deri një vit më parë ai nuk kishte treguar ndonjë cilësi lidhëse dhe kishte qenë i lumtur të ndiqte urdhrat sesa të jepte urdhra", shprehet Weber.

Në vitin 1921 Hitleri bëhet kryetar i Partisë Naziste dhe socialistët u shkruanë një vit më vonë. Sipas këtij autori është kjo histori që shpjegon obsesionin e Diktatorit gjerman me PS-në. Anëtarë të ndryshëm të NSDAP kërkonin një shkrim me socialistët në fillimin e viteve '20, por ishte kundërshtimi i vendosur i Hitlerit që e shmangu këtë. Nëse një gjë e tillë do të ndodhte NSDAP do të ishte tretur. Hitleri arriti deri aty sa për këtë çështje të jepte edhe dorëheqjen nga partia për një moment, duke lënë bashkëpunëtorët pa asnjë arsye bindëse në këtë refuzim.

Dokumenti i përket fondit të Hans Georg Grassinger, dëshmitë së tij si ish-kryetar i PS-së dhe është gjetur në arkivën e Institutit të Historisë Bashkëkohore në Muni. Dokumenti regjistron si më poshtë:

"Në vjeshtën e vitit 1919, ndoshta në shtator, Hitleri u shfaq në zyrën e shtëpisë botuese të takojë me Grassinger dhe u ofrua të shkruante për gazetën dhe të bashkohej dhe punonte për Partinë Socialiste Gjermane. Ai nuk kishte para në atë kohë dhe ai kërkoi gjithashtu para borxh nga Grassinger. Por ata i thanë atij se nuk kishin vend për të në gazetë dhe se nuk donin ta kishin në parti".

Weber planifikoi të botojë një libër për këtë temë, duke nënvizuar se portretizimi i Hitlerit në mesin e viteve '20 si një person me veprime iracionale të një prima donna, është i gabuar. Dokumenti është një provë më shumë e një tjetër njeriu, e një politikani që nuk harron askënd prej atyre që i kanë kthyer shpinën dhe që kultivon një hakmarrje të përjetshme kundër tyre.

A duhet të ndani shtëpinë me një mace, të qëndroni beqar, të hiqni dorë nga Facebook-u ose të bëheni vegjetarian? Apo jeni më shumë tipi që pëlqen qentë, një vilë në fshat, familje të madhe dhe profil social aktiv? Ja se çfarë thotë shkencën mbi disa vendime (të vogla) të mëdha në jetë.

Qen apo mace?

I pari u urtësua përpara lindjes së agrikulturës: mbijetesë e tij lidhet dhe lidhet ende me prezencën tonë. I dyti është mik i njerëzimit qysh nga shpikja e bujqësisë: mbronte shtëpinë dhe hambarët prej minjve dhe insekteve të tjera dhe për këtë ai është i lidhur me shtëpinë në kuptimin fizik. Të dy kanë aftësi të mahnitshme njohëse dhe aftësi sociale. Sigurisht, prania e të dyve është e dobishme për shëndetin fizik dhe mendor. Kush ka një kafshë shtëpiake ka marrëdhënie shoqërore më solide dhe sjellje më altruiste. Ndërsa fëmijët që rriten pranë një qeni, janë më të mbrojtur ndaj infeksioneve.

Beqar apo në çift?

Shpesh nuk jemi ne që zgjedhim, por për të dyja situatat ekzistojnë pro dhe kundër nga këndvështrimi shkencor. Studime të shumta kanë treguar se të qenët të martuar do të thotë të qenët më pak të rrezikuar nga zhvillimi i sëmundjeve kardiovaskulare, diabeti dhe problemet e frymëmarrjes (kjo vlen sidomos për meshkujt). Një situatë më e mirë ekonomike le të themi prej rrogës së dy partnerëve mund të garantojë një përballim më të kënaqshëm dhe mbështetës për të ardhmen. Në të njëjtën kohë marrëdhëniet stresuese lidhen me një rrezik më të madh të problemeve kardiovaskulare; të qenët çift sjell shëndoshjen sepse gatuhet më shumë dhe bëhen më pak lëvizje; ndërsa kush është beqar, ka një punë të mirë dhe rrethohet nga miq të shumtë i mungon pjesa e jetës private ajo më e sinjerta. Kështu që shkencën në këtë rast nuk bën një diferencim mes njëres apo tjetres situatë.

Çështje të hapura

# Shtatë dilema të mëdha



Po apo jo fëmijë?

Edhe në këtë rast, jo gjithmonë është një vendim të cilin mund ta marrim plotësisht ne. Por nëse do të flisnim në mënyrë shkencore, janë më të lumtur çiftet me apo pa fëmijë? Sipas një studimi nga Universiteti Open (Britani), lidhjet më të lumtura janë çuditërisht ato pa fëmijë. Çiftet pa të vegjlit evitojnë terrenet e tensioneve dhe kanë më shumë kohë për t'iu dedikuar interesave të përbashkëta. Ndërkohë nëse partnerët do të merreshin të shqyrtuar veç e veç për këtë aspekt, shkencën thotë se femrat me fëmijë janë më të lumtura sesa meshkujt me fëmijë. Këta të fundit kërkojnë një jetë më të kënaqshme seksuale.

Vegjetarian apo mishngrënës?

Nuk ka asnjë dyshim se cila është zgjidhja më e mirë nga këndvështrimi mjedisor: të qenët vegjetarian. Për sa i përket shëndetit, studime të shumta e lidhin konsumimin e një sasive të madhe të mishit të kuq me rrezikun nga kanceri. Por e njëjta gjë nuk vlen për mishin e bardhë ose për

peshkun. Një zgjidhje e mesme e mundshme është që të reduktoni konsumimin e mishit të kuq me yndyrë dhe të preferoni atë të bardhin ose peshqit; ose ndoshta të bëheni vegjetarian për të paktën një ditë në javë.

Shpenzimi apo kursimi?

A e bëjnë vërtet paratë lumturin? Një studim i Universitetit Princeton, i kryer nga Daniel Kahneman, thotë se po, niveli i lumturisë rritet prej rritjes së parave. Por pas një limiti prej 60 mijë eurosh në muaj, në vend të lumturisë rritet niveli i stresit dhe i trishtimit. Një studim kanadez ka treguar se shpenzimi për të tjerët garanton një lumturi më të madhe sesa ajo e të shpenzuarit për veten. Gjithsesi ajo çka është e rëndësishme sipas shkencës ka të bëjë me faktin se shpenzimi për kohë dhe eksperiencën të bukura është më i kënaqshëm sesa shpenzimi për objekte materiale.

Qyteti apo fshati?

Si një park qyteti ashtu edhe një fushë me pemë në fshat i bënë shumë mirë

mirëqenies së njerëzve. Shumë studime kanë treguar se në marrëdhënie me natyrën mirëqenia psikike dhe fizike bëhet më e madhe. Kushdo që jeton në qytet është më i prirë drejt ankthit dhe humorit të keq, por ka një tru i cili toleron më mirë stresin. Mund të jetë subjekt ndaj sëmundjeve të mushkërisë, por ka në dispozicion stimuj njohës më të mëdhenj dhe më shumë situata për të paguar jetën e tij sociale. Por nga pikëpamja mjedisore, krahasimi i qytetit dhe i fshatit është më se i qartë!

Me apo pa rrjetet sociale?

Nga një anë, pasja e profileve sociale, ka të mira, duke qenë se qëndrojmë të lidhur në kontakt me miqtë e largët dhe lajmërohemi mbi ngjarjet. Por nga ana tjetër, rrjetet sociale mund t'ju mbyllin në vetvete, mund t'ju bëjnë vetmitar dhe disi pa vetëbesim duke qenë se të tjerët gjithmonë postojnë gjëra pozitive. Për më tepër ato mund të shkaktojnë në pjesa më e madhe e përdoruesve ndjenjën narciste. E mira është që të mos bëheni shumë pjesë e tyre.

Historia e agentit serb që frymëzoi krijimin e James Bond

## "Më quajnë Popov, Dushko Popov!"

Vetë Fleming ishte një agjent spiunazhi dhe ishte i njohur në rrethin e tij për afrimitetin me femrat, shijen për likerin e mirë dhe makinat e shpejta



E keni pyetur ndonjëherë veten nëse shkrimtari Ian Fleming i është referuar një personi real për të krijuar personazhin e famshëm James Bond? Vetë Fleming ishte një agjent spiunazhi dhe ishte i njohur në rrethin e tij për afrimitetin me femrat, shijen për likerin e mirë dhe makinat e shpejta. Por duket se ka patur edhe një person, i cili shërbeu si model për krijimin e personazhit fiktiv, agentit 007. Ajo që duhet të bëni është të zëvendësoni emrin e tij me atë të Dushko Popov në novelën e vitit 1953 të Fleming, "Casino Royale".

Mendonni pak sikur nga goja e Sean Connery, Daniel Craig apo Pierce Brosnan, teksa ecin

të veshur shik në ambjentet e kazinosë, të dalin fjalët: "Më quajnë Popov, Dushko Popov". Natyrisht që një prezantim i tillë nuk ka efektin e "Bond, James Bond", por historia e Dushko Popov, një agjent i dyfishtë jugosllav gjatë Luftës së Dytë Botërore, është aq intriguese sa të sugjerojë një lidhje me figurën e agentit fiktiv.

Gjatë Luftës II Botërore, Ian Fleming ishte zëvendësi i shefit të Shërbimeve të Inteligjencës së Marinës dhe në këtë cilësi ka marrë pjesë në shumë misione

spiunazhi, mes të cilave një në vitin 1941 në Portugali, në "Casino Estoril". Këtu hyn në lojë Popov. Biografia e Popov, e rrëfyer në librin "Goja e Luanit", me autor Larry Loftis, tregon momentin kur Fleming zbuloi prirjet e dyfishta të agentit jugosllav dhe zakonet e tij.

Bashkëpunimi i tyre ndodhi në një tryezë bixhozi, ku Popov kishte vënë një bast kundër një kundërshtari të pasur, që i kishte shpëtuar nazistëve gjermanë. Tryeza ndodhej në "Casino Estoril", të cilën në novelën e

tij Fleming e ndryshoi në "Casino Royale". Në këtë mision, Fleming kishte për detyrë të shoqëronte bashkëpunëtorin e MI6-s, i cili atë natë zotëronte 40 mijë dollarë që i përkisnin qeverisë së Madhërisë së Saj. Popov u përball me kundërshtarin e tij dhe e provokoi menjëherë atë duke vendosur 40 mijë dollarët në tryezë, një shumë rreth 10 herë më e madhe se fitimet vjetore të njerëzve në vitet '40. Të gjithë të pranishmit në kazino ranë në heshtje dhe kundërshtari i Popov u tërhoq nga loja. Prejardhja e Popov duket se shpjegon aftësinë e tij për t'u përballur në të tilla situata. Dushko lindi në Serbi nga një familje e pasur, që asokohe gëzonte shumë privilegje. Pas arsimimit bazë, ai u diplomua në Juridik dhe më vonë hapi firmën e tij ligjore. Ai fliste rrjedhshëm gjermanisht dhe kishte lidhje me personazhe të profilit të lartë në Gjermani, të cilat i ofronin informacione mbi planet e nazistëve.





U plagos në fytyrë nga një predhë dhe u shpëtua nga një nëndetëse. U hapën fjalë se nazistët e gjetën të plagosur dhe e gjymtuan në 309 pjesë për vrasjet që kishte bërë. Një vit më vonë, korrik 1942 u dekorua me titullin Heroina e Bashkimit Sovjetik

Lyudmila Mijailivna Pavlichenko, shfaqet në kronikat e Luftës së Dytë Botërore si snajperja e Ushtrisë së Kuqe dhe Heroina e Bashkimit Sovjetik. Mes viteve 1941-1942 ka vrarë 309 ushtarë nazistë, nga të cilët 36 snajpera. Pothuaj një armik në ditë. Mjaftueshëm armiq që babai i kombit t'i jepte medaljet Lenin dhe Heroina e Atdheut, pavarësisht disa dyshimeve që lindin mbi këtë figurë të luftës. Po kush ishte Lyudmila Pavlichenko? Lindi në korrik të vitit 1916 në një fshat të Ukrainës, në Belaya Tserkov. Pak dihet për të deri në moshën 15 vjeçare, ndoqi mësimet e para në një shkollë lokale, një nxënëse mesatare, por u shqua për karakterin e pavarur dhe këmbëngulës. Sipas biografëve të saj në moshën 15 vjeçare lind një djalë nga lidhja me një student, Alekséi Pavlichenko. Më vonë ajo të do shprehej: "Linda një djalë, Ros-tilav që shkatërroi martesën time me Aleksein." Ishte mjaft e re për të marrë përsipër përgjegjësi të tilla. Për shkak të turp-it, ajo dhe familja e saj u zhvendosën në Keiv. Filloi një punë në një fabrikë metalurgjike, por mësimet nuk i ndau. Punonte si vajojëse, ndërkohë që dikush nga familjarët i rriste të birin. Arrin të shkojë në Universitetin e Kievit dhe në vitin 1937, në moshën 25 vjeçare mbron tezën për studime historike mbi Bohdan Jmelynysky, heroina



kozak që udhëhoqi kryengritjen mes viteve 1648 dhe 1654 kundër pushtetit aristokrat polako-lituanez.

Si arriti t'i bashkohej divizionit të këmbësorisë të Ushtrisë së Kuqe? Si arriti të ishte një nga 2000 snajperat, kur mbijetuan 500 prej tyre? Romanca e parë ndodhi në fabrikë, ku u regjistrua në një klub qitësish që kishte lidhje me gjykatën ushtarake të Osoaviajim-it dhe që shpejt e kuptoi qëllimin e saj. Në vitin 1941 Hitleri vuri në jetë operacionin Barbarosa, një sulm masiv mbi Bashkimin Sovjetik për të dominuar të gjithë frontin lindor. Pavarësisht bombardimeve të qershorit të vitit 1941 Stalini nuk i thirri gratë në front. Ludmilla u prezantua në zyrën e rekrutimeve dhe u shpreh: "Vij për të luftuar kundër pushtuesve gjermanë." Ushtarakët i ofruan një punë të përshtatshme për femra, por nuk pranoi.

"Vij nga një shkollë e Kievit dhe kam përvojë në stërvitje ushtarake." Përsëri iu ofrua një kurs infermieresh që edhe këtë e refuzoi. Atëherë e vunë në provë dhe tregoi se ishte e zonja në atë që dinte të bënte. Arma e saj e parë ishte Mosin-Nagant me një dybl prej 4 thjerrzash, nuk vonoi shumë dhe mori Tokarev SVT-40. U pagëzua me emrin Beteja e Odesës. Luftoi kundër gjermanëve gjatë dy muajve dhe mori titullin Snajper Elit. Sipas një dëshmitari viktimat e saj të para ranë në Belayevka, qytet 50 km larg Odesës, ndërkohë që ruante një kodër.

Biografët e saj shkruanin: "Gjatë 10 javëve pavarësisht dëmtimeve cerebrale dhe një plage të lehtë, vrau 187 armiq." Megjithatë Odesa ra dhe garnizoni ku bënte pjesë Ludmilla u vendos në Sebastopol, në gadishullin e Krimesë. Për tetë muaj ajo ruajti pozicionin e saj me

Në shiritin e kohës

# Ludmilla, snajperja ukrainase që vrau 309 ushtarë nazistë

njesisë së snajperave. Ajo betohej se kishte asgjësuar 309 armiq mes tyre oficerë dhe 36 snajpera, pjesa tjetër ushtarë.

U plagos në fytyrë nga një predhë dhe u shpëtua nga një nëndetëse. U hapën fjalë se nazistët e gjetën të plagosur dhe e gjymtuan në 309 pjesë për vrasjet që kishte bërë. Një vit më vonë, korrik 1942 u dekorua me titullin Heroina e Bashkimit Sovjetik. Pas një muaji udhëtoi drejt SHBA-ve bashkë me snajperin elit, Vladimir Pchelintsev. Shumë i pyetën se pse ata dhe jo dy pilotë apo komandantë të tankeve, por nuk ishte e habitshme për Stalinin, ata ishin yjet e këtij spektakli dhe gjermanët u tuteshin gjer në palcë.

Ajo ishte vetëm 26 vjeç dhe kishte përjetuar shumë për t'iu shmangur pyetjeve të gazetarëve amerikanë si çfarë ngjyre të të brendshmeve preferon apo a i lyejnë buzët snajperet. Në 28 gusht u prit si një princeshë nga Shtëpia e Bardhë, nga presidenti Franklin Delano Roosevelt dhe pak ditë më vonë njohu legendën e kinemasë Charles Chaplin që i tha: Duket e pamundur që këto duar të kenë vrarë kaq shumë nazistë... U tërhoq me gradën komandant dhe që këtej u eklipsua. Nuk punoi as si profesoreshë historie, as si instruktore qitjeje.

Punoi në shtabin e Ar-

matës dhe në Komitetin e Veteranëve të Luftës pa asnjë nder. Vdiq në vitin 1974 në moshën 62 vjeçare. Megjithatë ka disa paqartësi tek kjo figurë. Në kujtimet e saj shkruante se numrin 300 të të vrarëve e kishte realizuar në 12 korrik të 1942 ditën e ditëlindjes, në Sevastopol, por qyteti ra 9 ditë më parë. Tjetër dyshim është edhe goditja që kishte marrë në fytyrë në qershor të 1942, para një muaji. A kanë qenë me të vërtetë 309? Nga e dinin gjermanët numrin 309 që e prenë në të tilla pjesë?

Sipas historianes Lyuba Vinogradova është mjaft e çuditshme që të mos ketë marrë një medalje në Odesa edhe me 187 vrasje. Snajperave u jepeshin një medalje për 10 të rënë ose të plagosur dhe Ylli i Kuq për çdo 20. Përse asaj nuk i dhanë asnjë? Ajo mori vetëm urdhrin Lenin dhe Heroinë, të dyja pasi u plagos gjatë rënies së Sebastopolit. Pse nuk pranoi gjatë qëndrimit të saj në SHBA. Të kryente një provë qitjeje ashtu si shoku i saj Pchelintsev? Cilado të ketë qenë e vërteta ajo u zhdruk me të. Pavarësisht shifrave të të vrarëve, ajo ishte një snajperja që luajti rol kyç në betejat për fatin e Bashkimit Sovjetik. S'ka rëndësi nëse kanë qenë 309, ndoshta numrin e rriti Stalini për arsye politike dhe strategjike, por ajo i dha shumë atij vend

Një shpjegim i besueshëm për këtë zbulim të ri, që ndahet nga shumë kërkues, është se amerikanët janë më të shëndetshëm, sepse optimizmi në Shtetet e Bashkuara konsiderohet një vlerë kulturore. Të gjithë duhet të jenë të lumtur, dhe ata duhet të tregojnë se janë

Oliver BURKEMAN

Për kritikët e të menduarit pozitiv si unë, është e vështirë për të pranuar idenë se një pikëpamje optimiste mbi botën, të bën të jetosh më mirë.

Shkencëtarët, me fiksimin e tyre të bezdisshëm për faktet, kanë botuar studime mbi studime, në të cilat argumentojnë se një sjellje pozitive na mbron nga kanceri, sëmundjet e zemrës dhe ik-tuset. Nga analiza e të dhënave të grumbulluara mbi një mostër të madhe grash në SHBA, në gjashtë vjet, doli se ato që ishin më optimiste kishin 29

## A të jemi të lumtur me çdo kusht!



për ind më pak mundësi për të vdekur; nga një tjetër analizë, e cila përfshinte edhe burra, doli se njerëzit që kishin një pikëpamje pozitive për plakjen, jetonin më gjatë.

Por më në fund, edhe ne pesimistët kemi një armë për të kundërsulmuar: një studim të ri të botuar në revistën Psychological Science, dhe cituar nga blogu Research Digest, që krahason nivelet e optimizmit, kolesterolit

dhe peshës trupore të amerikanëve dhe japonezëve. Duket se amerikanët kanë më pak të ngjarë të kenë kolesterol të lartë dhe të jenë mbipeshë nëse janë të gëzuar, ndërkohë që midis japonezëve ky korrelacion nuk është gjetur. Cilado qoftë arsyeja për jetëgjatësinë më të madhe të japonezëve - i gjithë peshku që hanë apo një traditë e fortë familjare për të ndihmuar të moshuar-

it - e sigurt është, që nuk është hareja.

Atëherë, cila është? Në këtë lloj studimi është shumë e vështirë të përcaktohet se cilat janë shkaqet dhe pasojat (mund të jetë që të qenit të shëndetshëm na bën optimistë, dhe jo anasjelltas). Por një shpjegim i besueshëm për këtë zbulim të ri, që ndahet nga shumë kërkues, është se amerikanët janë më të shëndetshëm, sepse optimizmi në Shtetet e Bashkuara konsiderohet një vlerë kulturore. Të gjithë duhet të jenë të lumtur, dhe ata duhet të tregojnë se janë. Ndërsa në kulturat aziatike, për të përdorur fjalët e studiuesit Jiah Yoo, "shumë mendojnë se emocionet pozitive kanë një anë të errët, ato janë kalimtare dhe mund të tërheqin vëmendjen e të tjerëve, në mënyrë të panevojshme".

Me fjalë të tjera,

ndoshta nuk është optimizmi në vetvete, por fakti që janë në harmoni me kulturën mbizotëruese, që i bën më të shëndetshëm, optimistët amerikanë. Nëse nuk do të ishte presion kulturor për të qenë të lumtur, ndoshta pesimistët do të kishin një nivel më të ulët kolesterolit. Kjo gjithashtu do të shpjegojë zbulimin e bërë në vitin 2015, se lumturia nuk i bën më jetëgjatë, gratë britanike. Ju mund të thoni çfarë të doni për kulturën britanike, por këmbëngulja për të arritur lumturinë me çdo kusht, nuk është një nga gabimet e saj.


Megjithatë, duhet të jem i sinqertë, asgjë nga këto nuk vërteton tezen time, domethënë se pesimizmi ka anë e veta pozitive. Ajo që deduktohet megjithatë, për zhgënjimin tim të madh, është se kemi më shumë gjasa të jemi të shëndetshëm dhe

të lumtur, në qoftë se ndajmë qëndrimin dhe kulturën e njerëzve përreth nesh.

Sigurisht që nuk është rastësi, që popullatat që thuhet se janë më të kënaqura - si danezët që shpikën fjalën hygge (për të treguar një atmosferë shoqërore e cila krijon një ndjenjë rehatie, sigurie, ngrohtësie dhe familjariteti) dhe japonezët - priren të jenë ato më homogjene, dhe jo të larmishme. Ndoshta, pra, ajo që ka rëndësi nuk është qëndrimi i tyre ndaj jetës, por fakti që të gjithë ata që takojnë, e ndajnë atë qëndrim?

Sigurisht që nuk është receta e duhur për t'i bërë shoqëritë shumë-etnike më të shëndetshme dhe më të lumtura. Për të arritur këtë, ne duhet të ndalojmë së menduari se një mentalitet, apo një tjetër, është më i miri i mundshëm. Ndoshta optimizmi, pesimizmi, mbyllja në vetvete, të qenit të hapur, janë të gjitha gjërat që mund të funksionojnë, thjesht mos ngulni këmbë që qëndrimi i duhur është një i vetëm. (The Guardian)





Ana tjetër e medaljes

# SHATË ZAKONET E ÇUDITSHME TË SHKRIMTARËVE

Nga Viktor Hugo te Dan Brown, duke kaluar te Truman Capote: kryevepra dhe best seller janë shpesh kane të bëjnë me zakonet e vetë autoreve.

Edhe shkrimtarët më të mirë dhe më të popullarizuar mund të jenë viktima të sindromës së gjetheve të bardha, të përshkruar fillimisht në vitin 1947 nga psikoanalisti Edmund Bergler: një bllokim psikologjik që pengon dikë të hartojë një tekst, apo të përfundojë një, shkruan bordo.al. Historia e letërsisë është gjithashtu historia e përpjekjeve që janë pak a shumë të suksesshme për të frenuar këtë gjendje, duke përdorur ritualat ekstravagante ... Ja disa:

**KOKËPOSHTË.** Të varesh me kokë poshtë është për shembull kura për bllokimin, e zgjedhur nga Dan Brown, autori i best seller-it më të shitur si Kodi i Da Vinçit dhe Engjëj dhe djaj. Sipas Brown, e ashtuquajtura terapi e anasjellë, duke u varur nga një shirit me kokë poshtë, e ndihmon atë të relaksohet dhe të përqendrohet mbi fjalë. Sa më shumë që e bën, aq më shumë ndihet i lehtësuar dhe i frymëzuar. Një zakon tjetër i pazakonitë i Brownit është që të mbajë një orë me rërë në

tavolinë. Në çdo ritëm, ai e lë mënjane dorëshkrimin e tij për përkuljen dhe gjimnastikën. Nëse kjo e ndihmon për të shkruar, është e vështirë të thuhet, por sigurisht që ndihmon për ta mbajtur atë në formë.

**SKEDAT.** Vladimir Nabokov, autor i "Lolita", preferonte të vendoste veprat e tij në kartela, të cilat i ruante me fanatizëm në disa kuti. Kjo metodë lejoi që ai të shkruante skenat e romaneve të tij në mënyrë jo-sekuenciale dhe t'i rregullonte ato sa herë që donte. Ai ishte gjithashtu kishte të gatshëm edhe nën jastëk, ndoshta kishte ndonjë ide gjatë gjumit.

**NË PROVË.** Aaron Sorkin është skenarist i serisë "The West Wing" dhe "Newsroom", si dhe "Rrjeti social" mbi lindjen e Facebookut. Sorkin, pranoi se kishte thyer hundën etij, ndërsa shkroi një skenar. Si ndodhi kjo? Epo, atij i pëlqen të përsërisë dialogjet e tregimeve të tij para pasqyrës, dhe një herë, ai e lëshoi veten pak si shumë, duke përplasur kokën te kristali. Trauma e dukshme padyshim ... e goditi

atë. Ose ai nuk ishte i kënaqur me shakatë.

**LAKURIQ.** Po Viktor Hugo? Autor i kryeveprave si "Të mjerët" ai u detyrua të shkruante ... pa rroba. Kur u përball me mungesën e shpërndarjes së romanit të Notre-Dame de Paris, ai urdhëroi familjen e tij të konfiskoje të gjitha rrobat, kështu që ai nuk mund të linte shtëpinë. Edhe gjatë ditëve të ftohta, në të cilat për të rezistuar Hygo do të mbështillej vetëm me një batanije, ndërsa vazhdon-teme historinë e gungaçit të të Notre-Dame.

**I RELAKSUAR.** Truman Capote, prej të cilit ndër të tjera, kryevepra të tilla si: "Me gjakftohtësi" dhe "Mëngjesi i Tifanisë", preferonte të punonte shtrirë: tregon që ka shkruar kapitujt e parë të çdo romani, tregime ose artikuj, i shtrirë mbi divan, ndërsa pinte një kafe, çaj apo cocktail (sipas kohës). Përveç se ishte një shkrimtar Capote ishte në fakt një njeri me klas, siç dëshmojnë kronikat e lajmeve botërore të viteve '60 dhe '70 ku ai shfaqet me për-

masa elegante dhe origjinale

**BESËTYTNI.** Dhe sigurisht, është Jack Kerouac. Autori i romanit "Mbi rrugë" ishte një nontambulo (njeri aktiv për të punuar gjatë natës) dhe ishte i përkushtuar për të shkruar nga mesnata deri në agim. Ai pëlqente të shkruante me qirin, para se të vinte pendën në letër ai lutej dhe nga nata në natë zbulonte besëtytni të reja që mund ta ndihmonin atë për kreativitetin. Nga Hëna e plotë në "magjinë" e numrit 9 (përsërishte disa veprime 9 herë): rituali pak fiksuës, që i kishte të nevojshme për të shkruar kryeveprat e tij.

**NË HOTEL.** Poetesha amerikane Maya Angelou për t'u përqendruar kishte nevojë të braktiste rutinën dhe për këtë merrte me qira një dhomë hoteli në të njëjtin qytet, duke i kërkuar personelit të mos ia ndërronte çarçafët dhe të hiqnin të gjitha pikturat nga muret: "Për të shkruar duhet të qëndroj mbi një krevat" ka rrëfyer në një intervistë para se të vdiste në 2014-ën.



## Poe, Korbi dhe përkthimi

Për njohjen e Poes në shqip, një rol të madh si përkthyes luajti Fan Noli në fillim të shekullit XX, kur ndërmori nismën për të sjellë në shqip kryeveprat botërore

Poema "Raven" (Korbi) u botua për herë të parë në gazetën Evening Mirror në Nju Jork më 29 janar 1845 dhe autori Edgar Allan Poe (1809 – 1849) përdori pseudonimin Quarles në këtë botim. Stili i poemës ishte i ri, ashtu edhe emri i rremë i autorit. Më vonë, Poe do të shprehej në esenë e tij "The Poetic Principle" se nuk i pëlqente didaktizmi dhe alegoria, edhe pse besonte se kuptimi në letërsi duhet të jetë nën sipërfaqe. Shkrimet me kuptime të dukshme, shkruante ai, pushojnë së qeni art. Poe besonte se shkrimi i mirë duhet të jetë i shkurtër dhe të përqendrohet në një efekt të veçantë. Ai besonte se shkrimtari duhet të llogarisë me kujdes çdo ndjenje dhe ide. "Këtë mënyrë rigorozë, ndoqa kur shkrova poemën "Korbi", thotë Poe në esenë "The Philosophy of Composition".

Për njohjen e Poes në shqip, një rol të madh si përkthyes luajti Fan Noli në fillim të shekullit XX, kur ndërmori nismën për të sjellë në shqip kryeveprat botërore. Në këtë listë, ai futi edhe poemën Korbi. Noli duket se një tjetër gjë pati parasysh; të jetosh në Amerikë, është e lehtë të harrosh se shumica e botës nuk flet anglisht, dhe se shumica e letërsisë në botë nuk është i shkruar në gjuhën angleze. Për të lexuar më të mirën e asaj që pjesa tjetër e botës shkruan – dhe në mënyrë për pjesën tjetër të botës të përjetojë letërsinë më të mirë – shkrimtarët të aftë duhet të punojnë në artin e përkthimit. Por kjo nuk është thjesht dy ngjyrshme. Përkthimi i mirë është pasqyra ku origjinali sheh veten, por përkthimi gjithashtu duhet e të qëndrojë më vete për një audiencë të re. Më poshtë, e njëjta strofë e Korbit, e shqipëruar nga Noli.

### KORBI

1-  
"Një mes-natë të bezdisur  
Tek këndonja i zalisëur  
Disa pralla dhe magjira  
Të një shkence të harruar,  
Tek dermitnja i kapitur  
Befas vjen një e trokitur,  
Me ngadalë e goditur  
Përmi derë t'odës sime.  
"Dikush është, thashë, jashtë  
Që troket mi derën time –  
Vetëm kjo, dhe asgjë më." (shq. Noli)

Përkthyer nga Arjan A. Bejko, (revista «Mehr Licht» Nr.36) gati një shekull pas Nolit, kjo strofë e Poes vjen kështu:

### KORBI

1-  
"Një mesnatë të zyrtuar, mëndjevrarë, shpirtlënduar  
Përmbi libra plot enigma, të një lënde të harruar,  
Lodhur, gati në dremitje, befas ndjeva një trokitje.  
Mjaft të lehtë, si fanitje, pak të ndrojtur përmdë derë  
Ndonjë mik është, pëshpërita, që vjen e troket në derë -  
Vetëm kjo, dhe tjetër jo."

Siç tregojnë dy variantet e mësipërme të së njëjtës strofë, përkthim të fjalëpërfalshëm nuk ka, dhe se nga natyra e të zgjedhurit të një fjale përballë një tjetre, varet suksesi i përkthimit por edhe i origjinalit. Dhe të mendosh se përzgjedhja e fjalës është vetëm fillimi, sepse të lexuarit, tingulli, ritmi gjithashtu luajnë rol në transmetimin e kuptimit, sidomos kur është fjala për përkthimin e poezisë. Dallimet kohore, rajonale e gjuhësore mund jenë faktorë – dhe arsyeja pse dy përkthyes bëjnë që e njëjta poezi të shijohet ndryshe.

Në teatër për herë të parë si regjisor paraqitet me tragjedinë Shilerit "Intrigë dhe dashuri" në 1957 me shumë sukses në Teatrin Popullor, spektakël që qëndroi në repertor shtatë vjet dhe u luajt më së 300 herë

Është ndarë nga jeta në moshën 88 vjeçare regjisor i njohur shqiptar, Mihal Luarasi. Mihal Luarasi lindi më 16 shtator të vitit 1929 në Korçë. Shkollën e mesme e kreu në liceun artistik "Jordan Misja" në Tiranë, ndërsa studimet e larta në Akademinë e Arteve të Teatrit dhe Filmit në Budapest të Hungarisë. Në teatër për herë të parë si regjisor paraqitet me tragjedinë Shilerit "Intrigë dhe dashuri" në 1957 me shumë sukses në Teatrin Popullor, spektakël që qëndroi në repertor shtatë vjet dhe u luajt më së 300 herë.

Mihal Luarasi është njeri nga tre regjisorët e shquar të periudhës më të ndritur e cilësore të teatrit shqiptar në vitet 1957-1973 : Luarasi – Spahivogli – Mani. Për arsyet që dihen, në Teatrin Kombëtar Luarasi vuri pak pjesë, por ato u dalluan për cilësinë dhe nivelin e lartë artistik,

## Shuhet regjisori Mihal Luarasi



si : "Dragoi i Dragobisë", "Dhelpra dhe rrushtë" (fituese e të gjitha çmimeve të para në Festivalin e II-të kombëtar të teatrove), "Mosha e bardhë", "Banorët e shkallës nr. 6", "Rrugë të tërthorta", "Një dashuri e tulle". Më 1966 ve për herë të parë në skenë në Teatrin Migjeni të Shkodrës dramën "Cuca e maleve". Në 1973 vuri në skenë dramën e Tennessee Ęiliamsit "Orfeu zbret në ferr", dramë që u ndalua në provat e përgjithshme.

Është regjisor i dramës "Njolla te murrme" me trupën e Korçës me të cilën fitoi të gjitha çmimet e para në Festivalin e IV kombëtar të teatrit 1969. Pas tre ditësh spektaklin e pa diktori Enver Hoxha dhe e dënoi si vepër armiqësore.

Në teatrin AZC të Korces punoi pesë vjet dhe realizoi një sere shfaqjesh të paharruara, si "Te pamposhtur", "Pas dy vjetësh", "Flake në shtëpi", etj. Më 1972 në teatrin A. Moisiu të Durrësit vuri në skenë dramën "Çështja e inxhinier Saimirit" të Fadil Pacramit, vepër që u dënua. Me festivalin 11 në RTVSH 1972, Luarasi u ndesh përsëri me Diktatorin i cili kësaj herë nuk ia fali "fajet" e vazhdueshme dhe urdhëroi burgosjen e tij. U dënua me tetë vjet heqje lirije. Pas lirimit punoi si bojaxhi deri në vitin 1990.


Në dhjetor 1990 largohet në Hungari. Më 1991-1992, vë në skenë në Budapest dramën e Rexhep Qosjes "Vdekja e një

mbretëreshë". Më 1995 e fton Teatri Kombëtar në Tiranë dhe vë në skenë dramën "Hekurat" të dramaturgut hungarez Gőncz Arpad. Mihal Luarasi është regjisor i disa spektakleve të mëdha në Teatrin e Operas e dhe Baletit, si "Karmen", "La traviata", "Pranvera", "Opera për tre grosh", etj.

Gjate qëndrimit në Hungari, ka botuar një sere shkrimesh mbi teatrin në shtypin hungarez dhe atë shqiptar. Në vitin 2003 u botua libri i tij "Teatri Kombëtar në udhëkryq" dhe pas dy vjetësh libri i dyte me shkrime mbi teatrin dhe arte të tjera "Kujtesa që nuk flë".

Në vitin 2001 Luarasi shkruan dramën "Gomone" që u vu në skenë në TK, në 2003, nga regjisor Gezim Kame. Në këtë vit ai kthehet përfundimisht nga Hungaria. Vë në skenë në TK dramën e Ruzhdi Pulahes "Streha e të harruarve" në 60 vjetorin e Teatrit Kombëtar. Në 2006 shkruan dhe vë në skenë dramën "Korbi bardhe" që vazhdon të shfaqet me sukses (2007).





Partizani i Beogradit fton tifozët për anim korrekt

# Pa urrejtje dhe shovinizëm ndaj Skënderbeut!

“Kjo ndeshje është me rëndësi për ne, për nga rezultati dhe organizimi. Dëshirojmë fitore sportive dhe të vazhdojmë garën evropiane, por patjetër të tregohemi edhe si organizatorë të mirë të ndeshjes”, – thuhet në komunikatën e klubit serb

Klubi serb i futbollit, Partizani i Beogradit, i ka ftuar tifozët që të anojnë nga “fair-play” dhe të sillen në mënyrë korrekte në ndeshjen kundër Skënderbeut, në Ligën e Evropës, në mënyrë që t’u shmangen incidenteve që mund të sjellin dënime nga UEFA. “Të gjithë po e ndiejmë atmosferën që po krijohet rreth ndeshjes me Skënderbeun, që do të luhet të enjten në stadiumin tonë. Jemi të vetëdijshëm edhe për rreziqet që bart kjo ndeshje, sidomos për shkak të dënimeve me kusht në të cilat ndodhet Partizani.



Kjo ndeshje është me rëndësi për ne, për nga rezultati dhe organizimi. Dëshirojmë fitore sportive dhe të vazhdojmë garën evropiane, por patjetër të tregohemi edhe si organizatorë të mirë të ndeshjes”, – ka njoftuar klubi kryeqytetas serb. “Nuk dëshirojmë dhe nuk lejojmë të na ndodhin

gjëra në ndeshjet e ardhshme. FK Partizani ka marrë masat e sigurimit, konform takimit”, – thuhet në komunikatë. “Dokumentet personale patjetër të tregohen para hyrjes në stadium dhe bileta duhet të ruhet gjatë ndeshjes për shkak të kontrolleve të detajuara. Bëni tifo në mënyrë sportive, pa fy-

erje në baza fashiste, mos i brohoritni kundërshtarit në baza nacionale, mos tregoni urrejtje ndaj lojtarëve kundërshtarë. Çdo situatë e tillë, ose brohoritje, mund të sjellë pasoja nga komisioni disiplinor i UEFA-s”, thuhet në komunikatën e KF Partizan drejtuar tifozëve të saj.



## Katastrofë për Valon Behramin

Fundjava ishte fatale për Valon Behramin. Ylli kosovar ka pësuar një lëndim, i cili pritet ta lë jashtë fushave të blerta për disa javë. Gjatë ndeshjes ndërmjet Udinezes dhe Atalantës (2:1) mesfushori i Zvicrës ka ndje tërheqje muskulore me ç’rast është detyruar ta lë fushën kur po rridhte minuta e 79-të e lojës së kampionatit italian. Derisa, nga Udineze ende nuk ka njoftuar se sa kohë nevojitet për rikuperimin e lëndimit të Behramit, por burimet të afërta me futbollistin kanë paralajmëruar mundësinë e mungesës së tij në aktivitetet futbolistike për tri javë. Ndryshe, lëndimi i Behramit e ka tronditur edhe Përfaqësuesen e Zvicrës, ku futbollisti me prejardhje nga Mitrovica është ndër më të rëndësishmit dhe me përvojën thuajse më të madhe. Kjo pasi Behrami pritet t’i mungojë ekipit helvetik në dy ndeshjet vendimtare të saj për kualifikim në Kampionatin Botëror “Rusia 2018”. Kujtojmë, më 9 nëntor Zvicra do ta zhvillojë ndeshjen e parë të barazhit si mysafire e Irlandës së Veriut, kurse më 12 nëntor do ta zhvillojë takimin kthyes, pas së cilave ndeshje do të mësohet se cila prej këtyre dy skuadrave do të merr pjesë në ngjarjen më të madhe të futbollit. Dhe, burimet me lojtarin e kanë paralajmëruar mungesën e Behramit në të dyja këto takime, gjë që ka shkakuar zhgënjim te vet futbollisti e po ashtu në kampin helvetik. Për këtë çështje ka folur edhe vet Behrami për mediat zvicrane, të cilat janë shokuar me lëndimin e tij. “Kjo është katastrofë, por do të provoj ta bëj më mirë deri në javën e ardhshme”, ka thënë mesfushori defensivë për “Blick”.

## KB Shkupi rikthehet në palestrën “Shaban Tërstena”



Shkup, 31 tetor – Skuadra basketbollistike Shkupi nuk e ka nisur mirë sezonin në Superligë. Në katër ndeshjet e

deritanishme djemtë e trajnerit Enver Miftari kanë pësuar humbje duke mos e shijuar akoma fitoren. Ndryshe, në mungesë të palestrës e cila deri më tani nuk i plotësonte kushtet, Shkupi i ka zhvilluar ndeshjet si mysafir, por në fundjavë ata do të kenë mundësi që për herë të parë të luajnë para shikuesve të saj, si rezultat i rregullimit të disa çështjeve teknike të palestrës “Shaban Tërstena”. Lajmin se ndeshjen e ardhshme kundër Rabotniçkit, KB Shkupi do ta zhvillon para shikuesve të saj e konfirmuan edhe nga klubi bard-

hekaltër. “Të shtunën KB Shkupi do të ketë mundësi të zhvillon ndeshjen e parë para publikut të tyre në Çair. Kjo u mundësua pas rregullimit të disa çështjeve teknike të cilat ishin pengesë deri më tani. Prandaj kjo do të jetë një mundësi e mirë për tu mbushur palestra ‘Shaban Tërstena’. Do të jetë edhe emri i kundërshtarit të ekipit tonë, që është kampion i shtatëfishtë i Maqedonisë, Rabotnički. Të përkrahim Shkupin në Ligën e parë”, shkruan në faqen e klubit shqiptar në rrjetin social “Facebook”.

## Kaçe largohet nga PAOK-u



Ergys Kaçe do të largohet nga PAOK-u dhe nga kampionati i futbollit në Greqi. Numri i vogël i paraqitjeve në ekipin e parë të skuadrës greke, ka sjell pakënaqësi te mesfushori i kombëtares së Shqipërisë dhe se vendimi është marrë në koordinim me agjentin e tij, lajmëron “Newsport”. Emri i skuadrës se ku do të transferohet, ende nuk dihet, mirëpo merret vesh se do të jetë një skuadër evropiane. Ajo që është e sigurt në këtë moment është se Kaçe do largohet në merkaton e janarit dhe se do të transferohet në një skuadër evropiane.

## Strakosha, portieri dytë me më shumë pritje

“Mbërrin në stërvitje para magazinierëve dhe qante kur gabonte, ndërsa sot është një lider”. Kështu do të shprehë Kristian Ferrante, trajneri i parë Tomas Strakoshës te të rinjtë e Lazios. Sa shumë rrugë ka bërë portieri shqiptar që nga ajo kohë, duke fituar madje edhe vendin e titullarit në formacionin e Lacios! Inzagi ka ditur t’i japë besim dhe

vazhdimësi paraqitjeve të tij. 11-metërshi që i priti Paulo Dybalas, për të ruajtur fitoren e Lacios ndaj Juvetunsit, e shndëroi portierin më vendimtar në Serinë A. Tani, një tjetër rekord për portierin e Kombëtares Shqiptare. Vetëm Perin i Xhenoa ka kryer më shumë pritje (47) se Strakosha (46) në 5 kampionatet më të forta në Evropë.



Italiani Vanoli konfirmon

## Gati ta drejtoj Kosovën



Kosova vazhdon kërkimin për trajner dhe duket pranë marrëveshjes me Rodolfo Vanolin (versioni i tij, gjithsesi, ndaj duhet marrë pak me mosbesim), i cili konfirmon kontaktin me njerëz pranë Federatës së Kosovës: “Njerëz pranë Federatës më kanë kontaktuar dhe jam treguar i gatshëm të marr drejtimin. Natyrisht, kam thënë “po”, por me disa kushte, sepse Kosova është një kombëtare e

re, ku duhet rindërtuar gjithçka, ndaj duhen disa kushte për të punuar. Ne italianët çojmë jashtë Italisë filozofinë dhe

mentalitetin tonë. Do të më pëlqente të nisja këtë rrugëtim me një kombëtare të re dhe që synon nivele të rëndësishme”. Vanoli flet edhe për organizimin: “Kosova është kombëtare e re dhe ka nevojë për një qendër teknike si Koverçano, për të zhvilluar grumbullime të rëndësishme. Kam pasur fatin të njihem me Behramin, kam biseduar për të kuptuar shumë gjëra”.





## Zhito Pollog SHA Tetovë publikon SHPALLJE PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME-DYQANE

Përshkrim	Çmimi minimal i shitjes
Dyqan prej 41m2 në Tetovë	7.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 26m2 në Tetovë	4.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 26m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 50m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 63m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 19m2 në Tetovë	2.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 49m2 në Tetovë	4.000€/m2+tvsh

Mundësi për kredi përmes Stopanska Banka sh.a Manastir

Për më tepër informacione kontaktoni personin Dejan Kanaçkoviç në 070 343 522

Ju lutemi ofertat ti dorëzoni në zarf të mbyllur në adresën Zhito Pollog SHA Tetovë, rr.Marshall Tito 134, 1200 Tetovë, Maqedoni



## Jam gati për Haje, do ta mposht edhe në revansh

**"Haje nuk është në gjendje të më përballojë. Madje nuk ka as kuraje që të më shohë në fytyrë. Ai më urren në çdo mënyrë dhe nuk e pranon që unë jam në një nivel më të lartë se ai", u shpreh Toni Bellev**

Boksieri Toni Bellev ka rihapur debatet në prag të revanshit që britaniku do të zhvillojë me patriotin e tij David Haje më 11 nëntor, sfidë që do të organi-

zohet në "O2 Arena" të Londrës. Bellev, që e fitoi edhe përballjen e parë mes tyre, ka thënë se Haje është një "thes rëre, të cilin ai do ta hedhë sërish në tapet, duke e goditur fort në fytyrë". Sfida e parë e zhvilluar 7 muaj më parë (në mars), u fitua nga Bellev me "KO teknik" në raundin e 11-të, me Haje që u dëmtua në "thembrën e Akilit". Pas disa muajsh bisedimesh, palët janë dakord që të zhvillojnë edhe një përballje të dytë mes tyre. "Haje nuk është në gjendje të më përballojë. Madje nuk ka

as kuraje që të më shohë në fytyrë. Ai më urren në çdo mënyrë dhe nuk e pranon që unë jam në një nivel më të lartë se ai", u shpreh Toni Bellev, që vijon përgatitjen për këtë sfidë të peshave të rënda në boks. Më tej, Bellev, ish-kampion bote në peshën super të mesme dhe që më pas vendosi të kalojë në peshën e rëndë, shtoi: "Ai është si një vazo, që do të thohet menjëherë sapo unë ta godas në fytyrë", u shpreh britaniku, që parashikon një tjetër fitore ndaj Haje, ashtu si e para, me "KO"

Publicitet

### MINISTRIA E EKONOMISË

Ministria e ekonomisë, në pajtim me Programin për mbështetje të turizmit vendor për punëtorët me të ardhura të ulëta në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 120 të datës 01.09.2017), publikon:

#### VAZHDIM TË AFATIT TË THIRRJES PUBLIKE Për organizim të pushimit për punëtorët me të ardhura të ulëta

- Në pajtim me Programin për mbështetje të turizmit vendor për punëtorët me të ardhura të ulëta në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120 të datës 01.09.2017), Ministria e ekonomisë ka publikuar Thirrje publike për organizim të pushimit për punëtorët me të ardhura të ulëta.
  - Qëllimi themelor i këtyre projekteve është që të ju mundësohet personave me të ardhura të ulëta të shfrytëzojnë pushim vjetor, dhe në të njëjtën kohë të ju ndihmohet qendrave turistike në rritjen e kapacitetit të punës jashtë sezonit turistik.
  - Ministria e ekonomisë do të japë Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar për punëtorët me të ardhura të ulëta, në shumë të përgjithshme me vlerë prej **15.000 denarë** dhe e njëjta të përdoret në një prej objekteve të kategorizuara hotelerike për akomodim në Republikën e Maqedonisë që do të paraqiten në Ministrinë e ekonomisë.
- Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike** kanë të gjitha subjektet fizike të cilët janë të punësuar dhe të ardhurat e tyre në familje nuk kalojnë në neto të ardhurat në shumë prej **22.000,00 denarë**.
  - Një person mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për shfaqje të interesimit për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar.
  - Për pjesëmarrje sipas Thirrjes publike punëtorët me të ardhura të ulëta – kërkues deri te Ministria e ekonomisë duhet të parashtrijnë:
    - Formular të plotësuar të kërkesës (formular të gatshëm);
    - Vërtetim nga punëdhënësi për shumën e neto pagës së paguar për tre muajt e fundit dhe certifikatë nga banka për tre muajt e fundit për parashtruesin e kërkesës si dhe të anëtarëve të familjes (bashkëshortit, bashkëshortes dhe fëmijëve) të cilët së bashku me atë do të shfrytëzojnë pushimin;
    - Fotokopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit për atë dhe anëtarët e familjes të cilët së bashku do të shfrytëzojnë pushimin dhe
    - Deklaratë se kërkuesi personalisht ose me anëtarët e familjes që janë theksuar në kërkesë do të shfrytëzojnë pushimin (formular i gatshëm).
- Të drejtë për marrje të Vërtetimit për pushim** kanë të gjitha subjektet fizike të cilët janë të punësuar dhe të ardhurat e tyre mujore në familje nuk kalojnë neto të ardhurat në shumë prej **22.000,00 denarë**.
  - Formulari i kërkesës për shfaqje të interesimit për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar mund të merret në arkivin e Ministrisë së ekonomisë ose të sigurojë përmes internet faqes të ministrisë: [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk)
  - Kërkesa mund të parashtrihet deri në arkivin e Ministrisë së ekonomisë personalisht ose përmes postës në adresën (Jurij Gagarin nr. 15 Shkup)
  - Për çdo Vërtetim, Ministria e ekonomisë do të mbajë evidencë për personat të cilët shfrytëzojnë dhe në cilin objekt hotelerik për akomodim të përdoret.
  - Kërkesat për marrje të Vërtetimit do t'i shqyrtojë Komisioni i formuar nga ana e Ministrisë së ekonomisë.
  - Komisioni pas arritjes së të gjitha kërkesave për pushim të organizuar të parashtruara gjatë kohëzgjatjes së Shpalljes publike, me procesverbal do të përcaktojë numrin e saktë të kërkesave të arritura dhe do të përpilojë Listë për kërkuesit që kanë dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar që së bashku me raportin e parashtrorë deri në Ministrinë e ekonomisë.
  - Punëtorët me të ardhurat e ulëta – kërkuesit që nuk kanë parashtruar dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar nuk do të evidentohen në Listën e kërkuesve.
  - Lista e kërkuesve që kanë parashtruar dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar publikohet në ueb faqen e Ministrisë së ekonomisë më së voni shtatë ditë nga dita e përcaktimit të listës.
  - Punëtorëve me të ardhura të ulëta – kërkuesve që janë të evidentuar në Listën e kërkuesve, Ministria e ekonomisë u jep Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar në shumë prej **15.000,00 denarë**.
  - Vërtetim për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar jepet sipas parimit "i pari i paraqitur, i pari i shërbyer".
  - Vërtetimi për shfrytëzim të mjeteve për pushim të organizuar mund të shfrytëzohet vetëm nga punëtori, të cilin i jepet së bashku me anëtarët e tij të familjes (bashkëshorti, bashkëshortja dhe fëmijët), të cilët janë të theksuar në kërkesë.
  - Pushimi do të organizohet në objektet hotelerike për akomodim në qendrat turistike të Republikës së Maqedonisë, jashtë vendbanimit të personit – parashtruesit të kërkesës, në periudhë jo më shumë se pesë ditë.
  - Mbikëqyrjen** mbi realizimin e Projektit do ta realizojë Komisioni i formuar nga Ministria e ekonomisë.
  - Thirrja publike është e publikuar në ueb faqen e ministrisë së ekonomisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk).
  - Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kompletuar parashtrihet në Arkivin e Ministrisë së ekonomisë, rr. "Jurij Gagarin" nr. 15, Shkup deri më **20.11.2017**.





Nuk zbrer historia dhe trofetë në fushë dhe nuk ka fare rëndësi për ne se sa herë e ka fituar Italia botërorin. Kemi respekt, por jo frikë ndaj Italisë. Duhet të tregojmë lojën tonë më të mirë dhe të jemi si gjithmonë, të përqendruar

Luajtur 10. Fituar 9. Barazuar 1. Humbur 0. Diferenca e golave +29. Këto janë statistikat monstruoze të Mançester Sinit, i cili zyrtarisht ka bërë edhe startin më të mirë të gjithë historisë së Premier Ligës pas 10 javëve të para

Skuadra e Pep Guardiols theu rekordin që vendosi Siti i Roberto Mançinit, kur u shpall kampion në sezonin 2011-12. Ajo skuadër, e cila regjistroi edhe suksesin e pavdekshëm 6-1 në derbin kundër Mançester Junajtid në "Old Trafford", kishte një golavarazh +28 pas 10 ndeshjeve, edhe pse rekordi i pikëve ishte identik. Dhe rekordi i tyre është edhe më befasues sesa ai i Çellsit të Zhoze Murinjos vendosur gjatë 2005-06 (edhe këta kampionët e ardhshëm), i cili fitoi 9 nga 10 javët e para, por diferencën e golave e kishte +20.

#### Renditja

Siti i Guardiols po i gris librat e rekordeve çdo javë dhe

Siti i Guardiols po gris librat e rekordeve

## Zyrtarisht më i miri në historinë e Premier Ligës



po vendos standarde të reja në Premier Ligë. Nuk është rastësi që ata kryesojnë me 5 pikë nga vendi i dytë, që mbahet nga Junajtid dhe 8 nga Totenhami, edhe pse jemi ende në fillim të sezonit. Suk-

sesi i fundit 3-2 ndaj Uest Bromuicit, nuk ishte më i bukuri i sezonit, pavarësisht se solli fitoren e tetë radhazi në Premier Ligë. Megjithatë, ai shfaq potencialin e talentit sulmues që skuadra ka në dispozicion,

kur shënoi me Leroi Sanenë, Fernandinjon dhe Rahim Sterling, për t'u nënvizuar se asnjëri nuk është sulmues i deklaruar.

#### Sulmi

Lojtarët e Sinit kanë nisur të dominojnë Premier Ligën, duke kryesuar edhe listën e golshënuesve. Herri Kejn vazhdon të jetë në krye të bomberave me 8 gola, ndërsa Lukaku i Junajtid ka 7. Por, Serxho Aguero dhe Rahim Sterling kanë po aq sa belgu. Sane dhe Gabriel Zhezus kanë secili nga një gol më pak. Po të llogarisim edhe Ligën e Kampioneve dhe Kupën e Ligës, Sterling ka 9 në total, ndërsa Aguero, Zhezus dhe Sane nga 8 secili.

## Na pret një sezon i gjatë dhe i vështirë

Fitorja kundër Verona-s ishte e radhës për zikaltrit. Skuadra e Interit ka arritur një rekord historik të hënën mbrëma. Pas 11 javëve kampionat, Interi ka mbledhur plot 29 pikë, gjë që përbën moment historik për klubin, duke e tejkaluar Interin e Jose Mourinhos të vitit 2010, kur kishte arritur 28 pikë pas 11 ndeshjeve të para. Trajneri Luciano Spalletti tha gjatë konferencës për shtyp pas ndeshjes: "Nuk më jep asnjë ndjesi rekordi i vendosur sot, sepse, ndonëse kemi bërë kaq mirë, jemi ende të dytë



dhe skuadrat pas nesh kanë vetëm 1 pikë më pak. Të gjithë kryesuesit po fitojnë nga java në javë dhe gjithçka bëhet

edhe më e vështirë, kur mendon që edhe skuadra si Milani do ta thonë fjalën e vet në këtë sezon. Na pret një sezon i gjatë dhe i vështirë, një tunel që përfundon në qershor dhe deri atëherë nuk mund të flasin për titullin. Zhvilluam një ndeshje të mirë dhe u përpoqëm të bëjmë gjënë e duhur. Ndonjëherë jemi disi të ngadaltë, por nuk e humbim toruan dhe kjo është shumë pozitive. Icardi nuk ka shënuar, por ka bërë një punë fantastike në ndihmë të ekipit dhe për këtë jam shumë i kënaqur".

## Juventus me ofertë të re për Rafinjan



Ai është një nga lojtarët e Barçës, që jo gjithmonë i ka pasur minutat e dëshirueshme të aktivizimit në dispozicion të tij. Rafinja ka kënaqur teknikët e

Juves, që duket se kthehen në këtë pistë, për të marrë shërbimet e brazilianit. "Sportmediaset" thekson se skuadra italiane i ka bërë një ofertë lojtarit të Barçës, dhe klubit katalanas, për mesfushorin e tij, dhe se qëllimi është që operacioni të mund të vendoset dhe të mbyllet në janarin e vitit të ardhshëm. I pari i interesuar për një transferim të tillë duket të jetë Rafinja, i cili supozim se e ardhmja e tij në "Camp Nou" është më shumë se e komplikuar, ndërsa Juventus i ofron garanci për të qenë një iniciator. Bartomeu është gjithashtu i gatshëm të dëgjojë ofertat dhe për këtë arsye largimi i mesfushorit mund të jetë më shumë se i mundur në merkaton e dimrit. Rafinja do të jetë objektivi kryesor i Juventusit.

Publicitet

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit filozofik në Shkup, publikon

#### KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat mësimore-shkencore (disiplinat):

- metodat e hulumtimeve sociologjike dhe sociometria;
- teoria dhe metodat e statistikës shoqërore;
- sociologjia e përgjithshme;
- sociologjia e strukturave sociale.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënës është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin filozofik në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9A, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup



## Klubi nuk besonte në punën që bëra

Trajneri Karlo Ançeloti foli në mediat italiane për të shpjeguar arsyet pse ai u largua nga Bajerni Munihi. Përveç kësaj, ai analizoi situatën e Milanit të tij dhe theksoi rëndësinë e krijimit të VAR në të gjitha garat e mundshme. "Në futboll nuk ka magjistarë, me një shkop magjik. Kjo lojë kërkon durim, për të gjetur lojtarët që i përshtaten projektit. Milani ka bërë një merkato të bollshme në verë dhe njerëzit thanë se do të ishte skuadër e jashtëzakonshme, por jo në gjashtë muaj. Pasi ke bërë grupin e duhur të lojtarëve për ekipin, kërkohet kohë dhe këmbëngulje në investime, si edhe punë. Vendi i katërt për Milanin është shumë i rëndësishëm, sepse e lejon të luajë në Ligën e Kampioneve dhe të bëjë investime, por është edhe më e rëndësishme të mos bjerë, kur gjërat të shkojnë keq", u shpreh Ançeloti. Duke folur për largimin e tij nga Bajerni, Ançeloti tha: "Ndoshta klubi nuk besonte në punën që bëra. Është mirë që të shikoj përpara dhe të marr kohë për të parë futbollin si spektator, me interes të kërkimit të një mundësie tjetër në të ardhmen. Por, jo tani. Unë do të doja mundësinë për të krijuar një projekt dhe për të punuar me qetësi", nënvizoi më tej Ançeloti. Dy fjalë edhe për "videoarbitrajë": "VAR arriti shumë vonë. Vetëm një budalla mund të mendojë se teknologjia nuk duhet të zgjidhë shumë çështje të diskutueshme. Ai i jep qetësi arbitrimin dhe unë mendoj se të gjithë duhet të pajtohemi me të. Fatmirësisht, do të përdoret në Kupën e Botës së vitit të ardhshëm", përfundoi Karlo Ançeloti.

#### Shkurt

### Simeone vë në shënjestër yllin e Sampdorias

Diego Simeone ka hedhur sytë nga Seria A, për të përfuruar ekipin në merkaton e janarit, teksa ka piketuar yllin e Sampdorias Torreira. Sipas mediave spanjolle, Atletico Madrid ka ofruar plot 40 milionë euro për shërbimet e uruguaiant dhe duket se marrëveshja është pranë konkretizimit. Torreira erdhi nga Peskara në vitin 2015, për 1.5 milionë euro, por edhe në këtë rast te Sampdoria po tregojnë se janë të aftë të rritin vlerat e futbollistëve. Simeone shikon te Torreira, futbollistin ideal për të luajtur në krah të Vitolos dhe Diego Kostës dhe me afrimin e uruguaiant do t'i hapet rrugë edhe largimit të mundshëm të Antonie Griezman.

• • •

### 30 mln euro për Nunez

Krahas objektivit primar, që është Filip Kutinjo, Barcelona është vënë në kërkim të dy qendërmbrojtësve, që do t'i bashkohen Pijes nga sezoni i ardhshëm. Katalanasit dëshirojnë të gjejnë një zëvendësues të denjë për Xheemi Metju këtë verë, ndërsa lajmëruan edhe largimin e Maskeranos në fund të sezonit, duke bërë që në klub të mbeten vetëm Pike edhe Umtiti. Trajneri Valverde ka kërkuar afrimin e mbrojtësit 20 vjeçar Unai Nunez, të cilin e ka stërvitur të Atletit Bilbao. Ky i fundit sapo ka zgjatur kontratën e tij me baskët, deri në verën e vitit 2023, por te Barcelona janë të bindur se përkundrejt një oferte prej 30 milionë eurosh, mund t'i plotësojnë dëshirën Valverdes.

• • •

### Allardajs i vetofrohet Evertonit

Big Sam është gati të rikthehet në stol. Ish-trajneri i kombëtares angleze, Sem Allardajs, ka thënë "ok" për t'u rikthyer në Premier Ligë, në krye të Evertonit, që po kërkon një trajner me eksperiencë. 63-vjeçari vjen pas përvojës së fundit te Kristal Pallas, ku u largua në qershor, pasi siguroi mbijetesën për skuadrën. Allardajs e tha hapur se do ta merrte në konsideratë nëse drejtuesit e Evertonit do ta telefononin për drejtimin e skuadrës, që po lufton këtë vit për të qëndruar në Premier Ligë.

• • •

### Mançesteri e do Meunierin

Trajneri i Mançester Junajedit, Hoze Murinjo, është i vendosur për të transferuar mbrojtësin e PSZH-së, belgun Tomas Meunier, përcjell të hënën "The Sun". Murinjo po kërkon transferimin e 26-vjeçarit gjatë minifitimit të janarit dhe për kartonin e tij është i gatshëm të paguajë dëmshpërblim deri në 20 milionë euro. Meunier që luan në krahun e djathtë të mbrojtjes, shihet si përforsim i duhur tek ekipi anglez. Ai këtë edicion ka humbur vendin e titullarit te PSZH-ja me transferimin e Dani Alvesit, por ka regjistruar shtatë paraqitje dhe ka realizuar tre gola e dy asistime. Meunier ka kontratë me PSZH-në deri në vitin 2020, kurse te ekipi francez është transferuar vitin e shkuar nga Brizh.

• • •

### Largohet Pusiç, vjen Verbeek

Tventë gjen trajnerin e ri për të kaluar krizën që po kalon në "Eredivisie". Me vetëm 3 fitore dhe 7 humbje në 10 javë, drejtuesit i dhanë fund bashkëpunimit me Marino Pusiç, teksa skuadrën ia besuan një trajneri me shumë eksperiencë në Holandë si Gertjan Verbeek. 55-vjeçari ka drejtuar më parë Fejenordin, Az Alkmaar e Heerenveen, ndërsa ka eksperiencë edhe në Gjermani në krye të Bohum dhe Nürnberg.





Nëse e krahasoni atë me marrëdhënien e vjetër, që kishim, ju them se sot ne bashkohemi në shumëçka. Ne e respektojmë njëri-tjetrin, sepse jemi së bashku në kombëtare. Kur je duke u rritur dhe pjekur, ju i linë mënjane gjërat që u kenë dhënë rëndësi, por nuk duhen marrë në konsideratë tani

Liga e kampionëve, Grupi E, F, G dhe H



Vazhdojnë sfidat në Ligën e kampionëve edhe sonte (e mërkurë) ku në program do të jenë ndeshjet e Grupit E, F, G dhe H. Përsëri nuk do të mungojnë përballjet derbi, ndërsa veçohet sfida mes Totenhemit dhe Realit të Madridit, Seviljës me Spartakun e Moskës, Napolit dhe Mançester Sittit si dhe Portos me Laipzigun



**Kaka zbulon 5 ndeshjet e jetës**

Ricardo Izecson dos Santos Leite, për të gjithë Kaka, një kampion i pahar-rueshëm për tifozerinë e Milanit me ngjyrat e të cilit ka fituar gjithçka. Mes 2003 dhe 2007-ës ka fituar titullin, Superkupën e Italisë, një Ligë Kampionesh, dy Superkupa UEFA dhe një Botëror për Klube, pa harruar "Topin e Artë" 2007. Kohët e fundit braziliani ka deklaruar se nuk do të rinovojë kontratën me Orlandon ku luan aktualisht, për "mungesë stimujsh", por kjo nuk do të thotë se do të "var këpucët në gozhdë". Përkundrazi Kaka është në kërkim të një klubi të ri, dhe me shumë gjasa do të rikthehet në Brazil për ta mbyllur me futbollin e luajtur pikërisht aty ku e nisi. Në pritje të gjetjes së një skuadre të re, lojtari i klasit të lartë këto ditë ka zbuluar për "AS" 5 ndeshjet më të rëndësishme të jetës së tij, tre prej të cilave me Milanin, por 2 nuk i ka fituar.

1) 30 QERSHOR 2002: GJERMANI 0 – BRAZIL 2: "Ndihesha si peshku pa ujë, por shumë krenar që isha pjesë e asaj skuadre në finalen e Botërorit. Isha shumë nervoz, Gjermania ishte një rivale shumë e fortë, por kur Ronaldo shënoi e dija që do të fitonim. Pesë minuta nga fundi hyra në fushë, vrapova shumë, dhe me shumë vështirësi arrita ta prekja topin. Ndodheshin afër arbitrit kur bëri vërshtëllim finale, ishte një nga momentet më të mira të karrierës time, kampion me Brazilin vetëm 20 vjeç".

2) 25 MAJ 2005: LIVERPOOL 3 – MILAN 3: "Atë ditë kuptova që, futbollin nuk do të jetë kurrë vetëm një sport. Edhe tani nuk e di se si Liverpooli arriti të na barazojë në gjashtë minuta. Edhe pse humba, mësova shumë nga ajo ndeshje".

3) 1 KORRIK 2006: BRAZIL 0 – FRANCË 1: "Zgjedha dy ndeshje të cilat i kam humbur, për faktin sepse kam mësuar shumë prej tyre. Atë vit Brazili ishte i jashtëzakonshëm, me Kafu, Luisio, Roberto Karlos, Ronaldo, që sapo kishte fituar Kampionesh Ligën me Barcelonan, por nga ana tjetër ishte Zidane në një formë të jashtëzakonshme atë ditë; edhe pse për një marrëzi (incidenti me Materazzin) më pas humbi mundësinë të fitonte Botërorin".

4) 23 MAJ 2007: MILAN 2 – LIVERPOOL 1: "Ishte hakmarrja e 2005-ës. Por kishim motivimin e duhur. Edhe pse e dinim që po fitonim, kur Kajt shënoi në minutën e 89' na zuri paniku se mund të ripërsëritej skena e 2005-ës, por nuk ndodhi. Ishte e mrekullueshme, 2007-a ishte viti më i mirë i karrierës time".

5) 16 DHJETOR 2007: BOCA JUNIORS 2 – MILAN 4: "Edhe pse duket i lehtë, Botërori i Klubeve është i vështirë dhe konkurrues. Shënova një gol në minutën e '61'-të dhe festova me një 'T-shirt' me mbishkrimin "Unë i përkas Jezusit". Atë ndeshje u zgjedha më i miri në fushë".

# Xhiro me shumë derbi

Liga e kampionëve rikthehet edhe për Real Madridin, me atë terapi të veçantë të Cristiano Ronaldos. "Luso", i cili jeton kohën e tij më të keqe që nga bashkimi me klubin e njohur nga "Bernabeu", tetë vjet më parë, përballjet me kompeticionin, në të cilin e harron zhgënjimin e numrave të tij në La Liga. Si me magji, në Ligën e Kampionëve, portugezi rimëkëmbet dhe performon me shkëlqimin e një golashënuesi, më i miri në historinë e klubit "Chamartin". Në këtë fillim të vështirë dhe të pazakontë të sezonit, në të cilin sapo ka shtuar një gol në 540 minuta, Cristiano Ronaldo rizbulon fuqinë e tij shpërthyes, kur muzika tingëlton Champions. Pesë gola në tri ndeshje japin besim të mirë në të. Dopotë kundër APOEL, dy gola në transfertë me Borussia Dortmund, për të lënë shenjë edhe në barazimin kundër Totenhemit, në "Bernabeu". Pikërisht me këtë të fundit do të përballjet sonte "Embley", për të

rikomfirmuar ndoshta se kush do të plasohet në pozitën e parë në Grupin H, duke marr parasysh se të dy skuadrat kanë nga shtatë pikë. Në anën tjetër, sulmuesi më i mirë i Totenhemit, Harri Kin, është në dyshim për ndeshjen e sotme për shkak të problemeve muskulore që po e mundojnë anglezin. Trajneri Mauricio Pochettino, ka deklaruar se do të vendosin me stafin mjekësor, por nuk do të rrezikojnë. "Do të vlerësojmë situatën e tij dhe do të marrim vendimin më të mirë së bashku me doktorët dhe lojtarin. Unë mendoj se ai do të luajë dhe njëjtë mendon edhe vet Kin, por nuk do të rrezikojmë pasi nuk është ndeshje finale", tha Pochettino. Kujtojmë, Kin po kalon formë fantastike, ku deri me tani ka shënuar 13 gola në 12 ndeshje në të gjitha garat. Skuadra e Seviljës dhe Spartakut nga Moskë pritet të zhvillojnë një betejë të madhe për pozitën e dytë. E themi këtë pasi Liverpooli që ka pesë pikë, aq sa

<b>DYSHET:</b>
<b>Grupi E</b>
Liverpul - Maribor
Sevilja - Spartak M.
<b>Grupi F</b>
Napoli - Manchester S.
Shakhtar D. - Fejenord
<b>Grupi G</b>
Beshiktash - Monako
Porto - Laipzig
<b>Grupi H</b>
Borussia D. - APOEL
Totenhem - Real M.

ka edhe Spartaku, do të pret në "Anfield" Mariborin që nuk ka arritur asnjë fitore në tre raundet e para. Me fitore eventuale skuadra angleze do të ketë tetë pikë, andaj "lufta" për pozitën e dytë siç thamë do të zhvillohet mes skuadrës ruse dhe asaj spanjolle.

Napoli do të tentojë ti hakmerret Mançester Sittit për disfatën që ia shkaktoi në përballjen e parë me 2-1. Në stadiumin "San Paolo" futbolistët e Napolit do të kërkojnë

me çdo kusht fitoren nëse dëshirojnë të mbetën në garë për plasman në nokaut raundet. Për djemtë e Pep Guardiols edhe barazimi do të kryente punë duke marr parasysh se kanë nëntë pikë, kurse Napoli tre. Në anën tjetër Shakhtar do të ketë një mundësi të mirë që me fitore eventuale ndaj Fejenordit, të vazhdojë rrugëtimin e saj drejt plasmanit të mëtejsh. Ukrainasit kanë gjashtë pikë dhe shihen si favorit të mëdhenjë ndaj skuadrës holandeze e cila nuk ka grumbullar asnjë pikë. Ndërkohë që në Grupin G befasia më e madhe Beshiktashi që kryeson grupin me pikë maksimale nëntë, do të pret në Stamboll, Monakon të cilën arriti ta mund në shtëpinë e saj me 2-1. Turqve edhe barazimi do tu kryente punë. Në anën tjetër, derbi i këtij grupi do të zhvillohet mes Portos dhe Laipzigut. Skuadra gjermane gjendet në pozitën e dytë me katër pikë, një më shumë se Porto, ndërsa Monako ka vetëm një pikë.

## Nevill: Murinjo është si Mejvederi

Trajneri i Mançester Junajtedit Hoze Murinjo përdor të njëjtën taktikë si legjenda e boksit Flojd Mejveder, sipas Geri Nevill. Portugezi u kritikua pas barazimit 0-0 me Liverpoolin në "Anfield" në mes të tetorit, por fitorja 1-0 ndaj Totenhemit të shtunën i mbajti "Djajtë e Kuq" të dytët në renditjen e Premier Ligës që kryesohet nga Mançester Siti. Nevill, një ikonë e Junajtedit me të cilin nga fituar 8 tituj dhe 2 Liga Kampionesh, mendon se taktikat e portugezit mund të krahasohen me ato të Mejvederit. Ky i fundit edhe pse ka një rekord pathyeshmërie 50-0 shpesh është diskutuar për stilin e tij të mbrojtjes. "Mauricio Pochettino (Totenhem) dhe Jurgen Klopp (Liverpool) kanë reputa-



cionin e trajnerëve të fortë në sulm. Por Murinjo është pak si Mejveder. Boksieri është konsideruar si i mërzitshëm, pasi arma e tij ishte mbrojtja, duke i detyruar kundërshtarët të "trihnin veten" në ring", tha Nevill për "Sky

Sports". "Jurgen Klopp në atë ndeshje pak javë më parë e ndjeu se Mou do ta sfidonte duke përdorur armën e tij, kundërsulmin. Ndërsa Totenhemit i mungoi besimi te fitorja të shtunën. Dhe ky është një trajner i madh, që ka af-

tësinë t'i godasë kundërshtarët duke përdorur taktikat e tyre. Ndaj në njëfarë mënyre mendoj se ai meriton më shumë respekt, rekordi i tij është i pabesueshëm". Aktualisht Junajted ka pesë pikë më pak se Siti (28), që fluturon në krye të Premier Ligës me 9 fitore dhe një barazim në 10 javë, një fluturim që mbart edhe 35 gola të shënuar. Legjenda e Junajted Nevill mendon se forma e skuadrës së Pep Guardiolas dhe futbollit argëtues që ajo ofron, janë rivalët e vërtetë të Murinjos. "Këtu janë dy probleme emocionale: Historia e Mançester Junajtedit dhe futbollit i Pep Guardiolas. Ata po i shkaktojnë Murinjos shumë probleme, gjithsesi kjo është ndjesia ime", përfundoi Nevill.









**KALENDARË HISTORIK I NËNTOR**

996 - Për herë të parë përdoret emri "Austria" për Ostarrichi në dokumente zyrtare.  
1210 - Mbreti Xhoni i Anglisë fillon burgimin e hebrenjve.  
1755 - Tërmet në Lisbonë, vdesin mbi 50,000 persona.  
1814 - Mbahet Kongresi i Vjenës.  
1894 - Shpallet vaksina për difteri nga Dr Roux në Paris.



1894 - Nikolla II shpallet Car i Rusisë.  
1918 - Ania luftarake e Jugosllavisë Viribus Unitis fundoset nga italianët.  
1941 - Çetnikët sulmojnë partizanët e Titos në

Uzhice Jugosllavi.  
1954 - Algjeria fillon rebelimin kundër sundimit francez.  
1968 - Hapet Universiteti i Surinamit.  
1971 - Dollari i Eisenhower futet në qarkullim.  
1974 - OKB konfirmon pavarësinë e Qipros.

**"Mos e pësoni si unë"**

Një grua që e ka pësuar rëndë nga tenxherja me presion u bën thirrje të gjithëve të jenë më të kujdesshëm: "Mos e pësoni si unë". Seminar Erzurum, nënë e dy feminjëve e cila punon në një restorant në Erzurum të Turqisë, i hoqi kapakun tenxheres me presion pa i dalë avulli. Gjithçka ndodhi në përpjekje për të fituar kohë, tha ajo për Anadolu Agency. "Shpërtheu si bombë", tha gruaja e cila ka pësuar djegie të shkallës së parë në shumë pjesë të trupit dhe fytyrës. Gruaja paralajmëroi të mos e mbushin plot tenxheren kur duan të ziejnë diçka,



dhe pasi të ketë përfunduar procesi të presin derisa tenxherja të ftohet dhe të dalë avulli. Një mënyrë e mirë për të përsheptuar procesin është edhe mbajtja nën ujë të ftohtë për disa minuta.



**Macja e veçantë bullgare me ngjyrë smeraldi!**

Përveç se njihet si një vend turistik, Bullgaria tashmë po identifikohet edhe për një mace të veçantë të tyre! Është ajo në ngjyrë smeraldi e cila po i lë të gjithë gojëhapur posa e shikojnë.

E në këto ditë vjeshte ngjyra e saj përkon shumë në ambientet me gjethe të vyshkura! Por gjithçka që mbetet nga tonet e saj të hijshme, është leshi i saj i gjelbër që i jep gjithë nuancë shkëlqimi prej bari.



**Shtatë arra në ditë mbrojnë zemrën**



Shtatë arra në ditë ulin dukshëm shenja e plakjes, mbrojnë njeriun nga sëmundjet e zemrës dhe disa lloje të kancerit, sipas një studimi të ri. Arrat përmbajnë nivel të lartë të vajit, proteina me kualitet të lartë dhe karbohidrate. Po ashtu janë të pasura me kalium, magnez, fosfor, hekur dhe vitaminat B dhe C, transmeton KP. Studimi është publikuar në revistën "American Journal of Clinical Nutrition". Sipas këtij studimi, konsumimi i arrave ul nivelin e kolesterolinës, derisa konsumi i rregullt i tyre zvogëlon gjasat për zhvillimin e diabetit të tipit 2.

**A E DINI SE... ?**

Marrëveshjet e CIA-s me mafiozë, pilula helmuese dhe një regjistrim në një hotel të Las Vegasit, janë pjesë e një dokumenti, mes mijëra të tjerëve në dosje e dala së fundmi për vrasjen e John Fitzgerald Kennedy, ku përshkruhen me detaje përpjekjet për të vrarë liderin kuban, Fidel Castro. Në të paktën dy tentativa për vrasjen e Castros në fillim të vitit 1961, pilulat vdekjeprurëse të CIA-s duhej të mbërrinin në Kubë përmes kriminelëve, dorëzoheshin dikujt që mund t'i hidhte tabletat në pijet e Castros, sipas një memoje të CIA të majit 1962. CIA ofroi 150.000 dollarë për të përfunduar këtë punë, por Mafia tha se do ta bënte falas. Ekziston një shënim i CIA-s që tabletat janë dhënë, por është e paqartë nëse kanë mbërritur në Kubë.



**BARSOLETA**



**TE VETERINARI**  
Po i thotë veterinari zonjës, e cila kishte ardhur tek ai dhe e kishte lutur për kontroll.  
- Zonjë, keni gabuar, unë i shëroj shtazët e ju duhet të shkoni te mjeku.  
- Kam gabuar?! Në mëngjes kur zgjohem jam si pulë e shpupluar, në rrugë deri në punë varem në autobus si majmun në degë, në punë punoj si mushkë, burri në mbrëmje më thotë "eja mace", e në mëngjes "zgjohu lopë". A jeni i sigurt se e kam gabuar mjekun?!

**THËNIA E DITËS**

Pasqyra është shoku im më i mirë, sepse kur unë qaj, ajo nuk qeshë kurrë! (Charlie Chaplin)

